

ÇFARË ËSHTË DEMOKRACIA?

dhe

Alma Xhaferi

Andi Knuti

Blerta Hyskaj

Daniela Nuredini

Edgar Morine

Ghassan Khalil

Klea Gega

Konstantinos Giakoumis

Luljeta Vokshi

Miribana Hoti

Nevila Sokoli Xhindi

Rajmonda Mena

Valbona Nathanaili

Vladimir Myrtezai

ANTOLOGJI

Arsimi i lartë. Seria e botimeve të hapura për shoqërinë



Përpiluar nga

Valbona Nathanaili

Me parathënie nga Konstantinos Giakoumis

ÇFARË ËSHTË DEMOKRACIA?

ANTOLOGJI

Përpiluar nga **VALBONA NATHANAILI**
Kolegji Universitar LOGOS



Tiranë, nëntor 2024

Titulli i librit: Çfarë është demokracia? *Antologji*

Përpiluar nga: Valbona Nathanaili

2024: Me mbështetjen e “Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, Kolegji Universitar “LOGOS”.

Paraqitja grafike: Elvis Bejtja

Ideja e ballinës: Daniela Nuredini

Copyright ©Valbona Nathanaili

Libri është pjesë e serisë: *Botime të hapura për shoqërinë*

Një nismë e marrë nga Kolegji Universitar LOGOS

Ju jeni të lirë:

- ta ndani, kopjoni dhe rishpërndani materialin në çdo medium ose format
- ta përshtatni dhe ta transformoni, si dhe të punoni me materialin për çdo qëllim, qoftë edhe komercial.

Ky botim nuk i revokon këto liri, për sa kohë ndiqni kushtet e mëposhtme:

- të referoni botimin, sipas standardeve ndërkombëtare, dhe të tregoni nëse janë bërë ndryshime.
- ndryshimet duhet të jenë gjithnjë të arsyeshme, por në asnjë mënyrë të sugjeroni se keni miratimin e botuesit të kësaj vepre.
- nëse ri-përziemi, transformoni ose ndërtoni materialin, duhet t’i referoni kontributet nën të njëjtën licencë si origjinali.
- nuk ka kufizime shtesë - Ju nuk mund të aplikoni terma ligjorë ose teknologjikë

Botimi mbrohet nga Ligji i Shtetit Shqiptar

“Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të”.

Botues: Kolegji Universitar “LOGOS” / Shtëpia Botuese Universitare

Adresa: Rr: “Dritan Hoxha”, përballë Pallatit të Sportit “Asllan Rusi”, Tiranë.

valbona.nathanaili@kulogos.edu.al

www.kulogos.edu.al

International Standard Book Number ISBN: 978-9928-482-92-1

Libri është kataloguar në datën e publikimit pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës së Kolegjit Universitar “LOGOS”.

PËRMBAJTJA

VALBONA NATHANAILI NË VEND TË HYRJES	5
Prof. KONSTANTINOS GIAKOUMIS MBI KUFIJTË ‘NATYRORË’ TË DEMOKRACISË	10
KAPITULLI I AUTORITARIZMI DHE DIKTATURA	13
DANIELA NUREDINI, ALMA XHAFERI Udhëhoqi: VALBONA NATHANAILI GJERMANIA PARA-HITLERIT	15
KLEA GEGA, VALBONA NATHANAILI JOSIF STALINI DHE STALINIZMI	22
LULJETA VOKSHI Udhëhoqi: VALBONA NATHANAILI NIKOLAI ÇAUSHESKU DHE NOMENKLATURA	28
KAPITULLI II TË DREJTAT: TË DISH, TË USHTROSH, TË KËRKOSH	33
VALBONA NATHANAILI KONVENTA EVROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT	35
VALBONA NATHANAILI BOJKOTI - RRUGËTIMI I NJË LËVIZJE QË PUSHTOI GJITHË BOTËN	56
NEVILA SOKOLI XHINDI PROTESTA SI SHPREHJE E TË DREJTAVE DHE SOLIDARITETIT	67

MIRIBANA HOTI, RAJMONDA MENA, Udhëhoqi: VALBONA NATHANAILI DHUNA KUNDËR GRAVE DHE QASJA E TEORISË FEMINISTE	69
--	----

VALBONA NATHANAILI NGA SHQIPËRIA NË ITALI: RËNIA DHE NGRITJA E NJË GRUAJE	76
--	----

KAPITULLI III ÇFARË ËSHTË DEMOKRACIA?	87
--	-----------

VALBONA NATHANAILI DEMOKRACIA DHE TRANZICIONI	89
--	----

VLADIMIR MYRTEZAI PUSHTETI I SHUMICËS OSE I POPULLIT OSE DEMOKRACIA	100
--	-----

ANDI KNUTI KËTU, NË SHQIPËRI...	102
------------------------------------	-----

EDGAR MORINE Përktheu nga frëngjishtja: Blerta HYSKA QYTETARËT PRODHOJNË DEMOKRACINË QË PRODHON QYTETARËT	105
---	-----

DR. GHASSAN KHALILI Përktheu nga anglishtja: Valbona NATHANAILI NË VEND TË EPILOGUT: PËR NJË SHOQËRI QË RESPEKTON TË DREJTAT E FËMIJËVE	109
---	-----

NË VEND TË HYRJES

Çfarë është pushteti? Në fjalorin e Gjuhës Shqipe (Thomai *et al*, 2006: 863), pushteti është “e drejta dhe mundësia që ka dikush për të urdhëruar, për të vendosur etj.”. Thënë ndryshe, pushteti është aftësia për të ndikuar sjelljen e tjetrit për të marrë rezultatin e dëshiruar. Sipas Joseph (2010: 306), pushteti mund të ushtrohet me tre rrugë: dhunë, pará dhe duke qenë tërheqës, por gjithmonë në kontekstin e një marrëdhënie. Pa marrëdhënie nuk ka pushtet. Fjalori cituar më sipër sjell shembullin e pushtetit prindëror ose atë familjar.

Në këtë botim, në Kapitullin I “Autoritarizmi dhe Diktatura” analizohet jo vetëm se si një individ arrin të vijë në pushtet, por edhe si mbahet pushteti, në tre raste konkrete: në punimin e Daniela Uruçi dhe Alma Xhaferi me titull “Gjermania para-Hitlerit. *Faktorët ekonomikë, politikë e socialë që mundësojnë ngritjen e Hitlerit*” merret në analizë si mund të fitohet pushteti; në punimin e Klea Gega “Josif Stalini dhe stalinizmi” dhe atë të Luljeta Vokshi “Nikolai Çausheku dhe personalizimi i pushtetit” analiza zgjerohet, duke trajtuar jo vetëm ardhjen në pushtet, por edhe disa nga cilësitë e pushtetit të dy udhëheqësve komunistë në Evropën Lindore, në kohën e kampit socialist. Karakteristika e përbashkët e të tre figurave politike është se kanë ardhur në pushtet (dhe më pas edhe e kanë mbajtur) nëpërmjet dhunës, duke shtypur dhe shpesh zhdukur të gjithë kundërshtarët politikë. Pushteti jo vetëm ushtrohet, por edhe mund të fitohet me të njëjtat mjete: dhunë, pará dhe duke qenë tërheqës.

Sa i takon cilësive të drejtimit të tyre, sipas Javidan (Javidan *et al*, 2010: 371), një udhëheqës duhet të ketë këto pesë karakteristika: integritet, në gjendje të frymëzojë dhe vizionar, si dhe të jetë i orientuar nga performanca dhe puna në grup. Përsëri të tre bashkë kanë një element të përbashkët – ju mungon në mënyrë të qenësishme një nga cilësitë më të rëndësishme, integriteti!

Në Kapitullin II “Të drejtat: të dish, të ushtrosh, të kërkosh”, tema e punimit të Miribana Hotit dhe Rajmonda Mena-s është ajo e dhunës kundër grave, në

shtjellimin e së cilës mbështeten edhe në qasjen e teorisë feministe. Teoria feministe e sheh pabarazinë bazuar në gjini si dominim të burrave ndaj grave, njësoj si një klasë më e privilegjuar ndaj një tjetre më pak të tillë, që fillon në shtëpi dhe mbaron në shoqëri. Në historinë e E.S., synimi është të dëshmohet jeta e vajzave të reja shqiptare, që në ëndrrën për të jetuar në perëndim, nxitur shpesh nga dëshira për t'i shpëtuar konservatorizmit karakteristik të familjes shqiptare apo perspektivës së një jete të ngjashme me atë të prindërve, rrallë mendohen më shumë se dy herë, mbyllin sytë dhe përqafojnë çdo mundësi – kjo e fundit shpesh në formën e një djali që premtan shumë. Në një moshë të re, përgjithësisht sapo mbarojnë shkollën e mesme, që do të thotë edhe pa aftësitë e duhura për të siguruar të ardhura personale, shpesh edhe pa njohuritë më elementare të gjuhës së vendit, jeta dhe familja që shpresojnë të ndërtojnë në emigracion është një lloj lotarie që luajnë me jetën e tyre. Por duket se rrallë fitojnë! Ndërkohë, është e vështirë të pohosh nëse martesat e E.S. në Itali është bërë apo jo për “letrat italiane”, gjithsesi fakti që djali jetonte e punonte në Itali prej më shumë se pesëmbëdhjetë vjetësh mund të ketë qenë një arsye e fortë për një vendimmarrje pozitive, në favor të kandidaturës së tij, nga ana e prindërve.

Në raportin e Grupit të Ekspertëve të Këshillit të Evropës (GREVIO, 2024), për situatën e dhunës kundër grave dhe dhunës së ushtruar në mjedisin familjar në Shqipëri theksohet, se besimet tradicionale dhe rolet e stereotipet strikte gjinore mbeten një sfidë serioze, ndërkohë kur bëhet fjalë për dhunën seksuale dhe përdhunimin, shkalla e raportimit të këtyre krimeve është jashtëzakonisht e ulët. Raporti nënvizon, se në të gjithë vendin ekziston vetëm një qendër e krizës së përdhunimeve dhe ngre alarmin për domosdoshmërinë e krijimit të shërbimeve mbështetëse përkatëse. Sa i takon dhunës në familje, edhe pse numri i rasteve të raportuara është i lartë, në një farë mënyre çështje të tilla humbasin rrugën për në sistemin gjyqësor dhe dhunuesit nuk arrijnë të marrin kurrë dënimin e merituar - një sfidë e rëndësishme kjo për shtetin shqiptar. Raporti kritikon faktin se *vetëm* viktimat që e raportojnë dhunën janë subjekt i ndihmës së specializuar, ndërkohë që ka një hendek të dukshëm ndërmjet ligjit dhe zbatimit të tij, gjë që minon besimin e viktimave tek autoritetet.

Duke vazhduar me të njëjtën tematikë, duhet shtuar se në Shqipëri gratë përjetojnë jo vetëm dhunë, por edhe pengesa, në formën e përvojave dhe pritshmërive që i kanë rrënjët përsëri në traditën e historinë e vendit. Një nga këto përvoja negative në Shqipëri është përjashtimi i grave nga drejtimi, një problem i mprehtë veçanërisht në arsim, shtuar këtu edhe krijimin e një mjedisi toksik në vendin e punës, si prirja për t'i përçmuar, bullizimi, ndëshkimi i padrejtë

dhe mosnjohja e meritave (apo edhe përvetësimi i tyre nga drejtuesit meshkuj). Pikërisht në vendin, ku për shkak të misionit dhe në emër të asaj që kërkon të frymëzojë, faktorët e ndotjes sociale duhet të ishin jo ekzistues, problematikat janë pothuaj të njëjta si në çdo organizatë tjetër! Rrallë gjen ndonjë burrë që nuk është në një post drejtues! Asnjëherë nuk vihen në diskutim aftësitë drejtuese të një burri, por gjithmonë dyshohet tek një grua, së cilës fillon e i shkruhet historia që nga shkolla e mesme: me kë ka qenë dhe çfarë marrëdhëniesh ka pasur. Edhe nëse nuk dëshiron të jesh feministe, shoqëria shqiptare të detyron të bëhesh feministe – ke gjithmonë një arsye apo një shkak me të cilin nuk pajtohesh, një ngjarje me sfond diskriminimi bazuar në gjini për të cilën duhet të ngrësh zërin, të reagosh, ta denoncosh! Por fatkeqësia më e madhe është kur këto beteja janë kundër vetë grave, që shpesh e inicojnë, mbështesin dhe ushqejnë këtë lloj diskriminimi! Sa më e aftë të jetë një grua në një post, aq më shumë gra të të njëjtit profesion do të gjejnë arsye për ta kritikuar, për të venë në dyshim aftësitë e vlerat e saj, për të mos e pëlqyer, për të manifestuar një qëndrim armiqësor. Është e vështirë të eliminosh qindra vjet stereotip! Problemi thellohet edhe më shumë, sepse një qëndrim i tillë mbartet e përçohet edhe në institucion, duke ushtruar trysni në hartimin e politikave që nuk kanë në agjendë përkrahjen e promovimin e grave në drejtim.

Kapitulli pasurohet me dy artikuj që trajtojnë temën e bojkotit dhe atë të protestës.

Kapitulli III i kushtohet demokracisë, nën titullin “Çfarë është demokracia?”. Demokracia si qasja më e mirë e pushtetit ka qenë dhe është një forcë lëvizëse në politikën globale të paktën prej dyqind vjetësh, ndërkohë që sot konsiderohet si mundësia më e mirë për drejtimin e një shoqërie në pjesën më të madhe të vendeve, por demokracia nuk duhet të merret si e mirëqenë. Brezi im ka jetuar në të dy kohët, edhe nën regjimin komunist edhe në demokraci. Në këtë mënyrë, kemi fituar “nuhatjen” për të njohur një udhëheqës autoritar edhe nga larg. Dhe për t’i dhënë përgjigje pyetjes “Çfarë nuk është demokracia?”, që Stenner (2024) i jep këtë përgjigje: “Demokracia nuk është t’i bësh qejfin çdo kulture”.

Demokracia ka nevojë për më shumë njerëz, në gjendje të mendojnë ‘me kokën e tyre’, se sa për njerëz të gatshëm t’i nënshtrohen çdo lloj autoriteti; ka nevojë për më shumë njerëz, në gjendje të arsyetojnë së bashku rreth zgjidhjeve të mundshme, se sa për njerëz që vetëm pretendojnë e kërkojnë. Parimet e demokracisë mësohen që në shkollë, por në vitin 2018, në SHBA, testin kombëtar të lëndës së qytetarisë e kalon vetëm një në katër nxënës të moshës trembëdhjetëvjeçare, një rezultat i ulët, më i ulëti krahasuar me rezultatet që morën fëmijët e kësaj moshe në testet kombëtare të të gjitha lëndëve (Stenner, 2024).

Rabindranath Tagore nënvizon faktin se në shkollë, ne përpiqemi thjesht t'i disiplinojmë fëmijët, duke mos marrë parasysh pothuaj fare individualitetin e tyre, një sipërmarrje e ngritur për të dhënë rezultate uniforme.¹ Për të shmangur këtë, është e rëndësishme të ushqejmë te fëmijët pavarësinë e mendjes dhe t'i inkurajojmë të bëjnë pyetje. R. Tagore u angazhua shumë veçanërisht në edukimin e femrës. Në një leksion mbajtur më 1936 ai u bën apel femrave “të hapin zemrën, të kultivojnë intelektin e të ndjekin me vendosmëri rrugën e dijes, duke pasur në vëmendje që e kundërta e kreativitetit është konservatorizmi i verbër”.² Sen (2011: 268) i referohet Tagore kur kërkon të theksojë se “Nacionalizmi dhe shovinizmi kulturor mund të jenë qasje seriozisht të dëmshme për të jetuar”:

Çfarëdo të kuptojmë dhe gëzojmë nga produktet njerëzore, në moment bëhet jona, kudo që ta kenë origjinën e tyre. Unë jam krenar për humanizmin tim kur më jepet mundësia të njoh personalisht poetë dhe artistë nga vende të tjera. Lermëni të shijoj këtë kënaqësi të paparë, se gjithë lavdia e njerëzimit është e imja (Rabindranath Tagore).

Nga ana tjetër, Dewey (1903: 83) e lidh, në mënyrë krejtësisht të qartë, rëndësinë e të menduarit kritik me demokracinë: “Demokracia është më shumë se formë qeverisjeje; demokracia është, në radhë të parë, mënyrë shoqërizimi të të jetuarit dhe të ndarjes së përvojave të përbashkëta të komunikimit.”

Një shoqëri që përpiqet të tejkalojë barrierat tradicionale të racës, klasës dhe pasurisë duhet “të shohë nëse anëtarët e saj janë edukuar për të marrë iniciativa personale dhe nëse kanë aftësinë për t'u përshtatur” (Dewey, 1903: 85). Për Dewey (1903: 84; 251-2; 264-5), kritika ndaj zakoneve është thembra e demokracisë. Që në kohërat më të lashta ky ka qenë çelësi i formimit të qytetarëve. Në Athinën e lashtë, ku njerëzit ishin skllevër të zakonit dhe të menduarit në mënyrë tradicionale, ata nxiteshin të mendonin në mënyrë sokratike, të përqendroheshin te argumenti në mënyrë racionale, të shihnin sa e papërshtatshme ishte tradita e ngurtë për një jetë demokratike.

Libri lindi si një platformë për t'i dhënë më shumë hapësirë dhe vëmendje diskutimeve dhe debateve me studentët në lidhje me demokracinë, të drejtat dhe detyrimet si qytetarë. Alma Xhaferi, Daniela Nuredini, Klea Gega, Luljeta Vokshi, Miribana Hoti dhe Rajmonda Mena janë studente pranë Kolegjit Universitar

1 “My school” in *Personality* (cituar: Amiya Chakravarty, 1961. “A Tagore reader”, Beacon Press, Boston: f. 218-24).

2 “Nari” (“Women”), extract translated in Sumit Sarkar, “Ghare Baire in its Times,” in *Rabindranath Tagore's The Home and the World: A Critical Companion*, ed. P. K. Datta (New Delhi: Permanent Black, 2003), pp. 143-73, at. 168.

“LOGOS”, bashkëpunimet me të cilat në artikujt ku jemi bashkautor ose kur kam udhëhequr punën e tyre, rezultuan tejet efektive, një nismë që uroj të vazhdoj edhe më tej. Me mirënjohje për Vladimir Myrtezai, Nevila Sokoli Xhindi dhe Andi Knuti, që e zgjerojnë përmbajtjen me analizat e tyre për situatën e demokracisë në Shqipëri. Jam në borxh me Prof. Konstantinos Giakoumis, për mbështetjen e vazhdueshme. Falënderime për Dr. Ghassan Khalil, i pranishëm në “LOGOS” me nismën për krijimin e “Qendrës për të drejtat e fëmijëve”, si dhe në këtë botim me një artikull për rolin e këtyre qendrave pranë universiteteve, si promotore të një shoqërie që respekton të drejtat e fëmijëve.

Valbona Nathanaili

REFERENCA

- Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence (GREVIO) (2024). *Albania: Progress in efforts to stop violence against women*. Council of Europe. <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/-/grevio-publishes-its-first-thematic-report-on-albania>. Gjetur më 16 tetor 2024.
- Javidan, M., Dorfman P. W., Howell, J. P. & Hanges, P. J. (2010). Leadership and cultural context. A theoretical and empirical examination based on Project GLOBE. In Nohria, N. & Khurana, R. (eds). *Handbook of Leadership Theory and Practice. A Harvard Business School Centennial Colloquium*. Boston, Massachusetts: Harvard Business Press, ff. 335-376.
- Joseph, S.N. Jr. (2010). Power and leadership. In Nohria, N. & Khurana, R. (eds). *Handbook of Leadership Theory and Practice. A Harvard Business School Centennial Colloquium*. Boston, Massachusetts: Harvard Business Press, ff. 305-334.
- Stenner, D. (2024). Fjala e mbajtur në ceremoninë e hapjes, në konferencën “Teacher education research in Europe: trends, challenges, practices and perspectives”, ATEE Spring Conference 2024, organizuar nga Dipartimento di Scienze Umane e Sociali, University of Bergamo, CQIA (Centro per la Qualità dell’Insegnamento, dell’Innovazione didattica e dell’Apprendimento), University of Bergamo, ATEE (Association for Teacher Education in Europe).
- Thomai, J., Samara, M., Haxhillazi, P., Shehu, H., Feka, Th., Meminsha V. & Goga, A. (2006). *Fjalor i Gjuhës Shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë.

PARATHENIE MBI KUFIJTË ‘NATYRORË’ TË DEMOKRACISË

Në të famshmen “Teori të Evolucionit”, Charles Darwin-i pohon, se speciet e paafta të përshtaten me mjedisin e tyre natyror janë të dënuara të zhduken dhe se aftësia e përshtatjes është forca e tyre e vërtetë. Megjithatë, Charles Darwin-i nuk morri kurrë parasysh të kundërtën: çfarë ndodh kur specia arrin të ndryshojë pa mëshirë edhe mjedisin natyror të saj, së bashku me veten? Përgjigjen na e jep rasti interesant i Ishullit të Pashkës (në gjuhën vendase “Rapa Nui”).

Ndërkohë që flitet shumë për ndikimin që ka ndotja e mjedisit në rritjen e temperaturës globale, historia ka plotë shembuj të ndërhyrjeve shkatërrimtare të shoqërive. Ishulli i Pashkës, një ishull i vogël i Oqeanit Paqësor, me tokë pjellore dhe i pasur me një bimësi, ku mbizotërojnë palmat, arriti kulmin e shkëlqimit të tij mes shekujve XV – XVI, siç provohet nga disa statuja të mëdha prej guri të ngritura nga banorët. Kur në shekullin XVIII eksploratorët evropianë vunë këmbë në ishull, u habitën si kishin arritur këta banorë “të vegjël, të kërrusur, të turpshëm dhe tepër të vuajtur”¹ (sipas rrëfimeve të Kapitenit Cook) të ndërtonin ato statuja kolosale! Shoqëria e Ishullit ishte shkatërruar, çdo komunikim me botën jashtë ishte ndërprerë, deri sa ishte kthyer në izolim të plotë, popullsia kishte pësuar një rënie 70% të saj, ndërsa ata pak banorë të mbetur vuanin kaq shumë nga mungesa e ushqimit, sa ishin kthyer në kanibalë.

Çfarë lidhje kanë këto statuja kolosale me banorët që përshkruhen në rrëfimet e Kapitenit Cook? Çfarë kishte ndikuar dhe çfarë e kishte çuar shoqërinë e Ishullit

1 Diamond, J. (2005). *Kolaps, shoqëri që zgjedhin të rrënohen ose të kenë sukses*. Tiranë: UFO Press. Përkthyen në shqip Lushaj, B., Verteniku, T. & Luma, A., f. 114.

të Pashkës drejt një shkatërrimi të tillë? Në librin *Kolaps, shoqëri që zgjedhin të rrënohen ose të kenë sukses*, Jared Diamond, profesor i biogeografisë në Universitetin Shtetëror të Kalifornisë shtjellon, se banorët e ishullit zgjedhën ta përdorin vendbanimin e vet natyror sipas një mënyre shkatërruese, siç dhe provohet se ndodhi: keqpërdorën lëndën drusore të pyjeve tropikale dhe tokën pjellore të këtyre pyjeve. Për më tepër, popullsia u rrit së tepërmi, banorët ndanë ndërmjet tyre toka që zotëroheshin nga grupe njerëzish me marrëdhënie rivaliteti apo lufte. Shfrytëzimi i pamasë i vendbanimit natyror të Ishullit të Pashkës minoi mundësitë e vendbanimit për të jetuar gjatë. Megjithatë, historianë të tjerë bëjnë përgjegjëse për shkatërrimin e ishullit minjtë e mbartur nga të ardhurit në Ishullin e Pashkës, të cilët ndërruan në përmasa dramatike ekosistemin e ishullit, pasi përpinë sasi të mëdha farash palme, duke ndaluar, kështu, rigjenerimin pemëve.

Mirëqenia e një shoqërie të organizuar varet gjerësisht tek pasja e kushteve të nevojshme materiale. Për ta thënë më thjeshtë, po nuk patëm tokë të punueshme, do të vuajmë nga uria; po nuk patëm ujë, do të vuajmë nga etja; po të ndotim ajrin, do të vuajmë nga sëmundjet. Natyra biologjike njerëzore ofron mjedisin e nevojshëm për të pasur një jetë shoqërore, por është jeta jonë shoqërore ajo e cila do të përcaktojë se si do t'i përmbushim nevojat tona biologjike. Njeriu shoqëror përcakton kushtet e mbijetesës së njeriut biologjik.

Diamond-i e shpjegon shkatërrimin e një shoqërie duke e lidhur atë me kushtet mjedisore, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, por argumentet e tij nuk janë deterministe. Shkaqet e rënies së Ishullit të Pashkës nuk ishin natyrore, pra, të pamënjanueshme, por kishin prejardhje njerëzore. Zgjedhjet që bëjnë shoqëritë lidhur me mjedisin e vet natyror përcaktojnë mundësitë që kanë këto shoqëri për të mbijetuar. Diamond-i citon një varg arsyes, si pasojë e të cilave shoqëritë mund të gabojnë në zgjedhjet e bëra. Do të përqendrohemi në një nga arsyet, e cila ka interes të madh për ne. Një shoqëri konkrete mund të zotërohet nga një lloj pangopshmerie kolektive, duke u bërë, kështu, e paaftë të përballojë problemet e veta edhe kur është e ndërgjegjshme çfarë duhet bërë dhe si duhet bërë.

Një nga mëdyshjet më kritike të jetës shoqërore është çështja e kënaqjes së interesave afatshkurtra individuale, të vëna, këto, përballë interesave afatgjata kolektive. Duke i vlerësuar sot për sot, nevojat individuale janë shtypëse dhe të drejtpërdrejta; por, duke i vlerësuar ato në planin e së ardhmes, nevojat individuale duhen kënaqur pasi t'u jenë nënshtruar kufizimeve. Kjo për arsye se kënaqja e nevojave të sotpërsotshme individuale është e shëndetshme vetëm kur kryhet brenda kornizës së zgjedhjeve, në bashkëvajtje me kriteret afatgjata dhe në dobi të mbrojtjes së të mirave kolektive. Diamond-i pyet: "Ç'i thoshte mendja banorit të

Ishullit të Pashkës kur preu palmën e fundit?” Kur një shoqëri humbet mundësinë për të kuptuar rëndësinë e të mirave kolektive, arsye e cila është parakusht i kënaqjes së shëndetshme të nevojave individuale, atëherë kjo shoqëri shkatërrohet.

Institucionet publike janë të lidhura me të mirat kolektive. Që në krye të herës, të mirat kolektive caktojnë kornizën brenda së cilës individët mund të zgjedhin sipas nevojave të tyre. Zjarret e verës së kaluar në vend na tregojnë mjaft qartë punën e dobët të institucioneve publike. Për dekada të tëra shërbimet pyjore kanë vuajtur nga pamjaftueshmëria e personelit, mospasja e fondeve, mungesa e veprimeve të koordinuara dhe e planifikimit strategjik. Kjo ishte provë shtesë për të kuptuar se mbrojtja e të mirave kolektive nuk është parësi kryesore për një sistem politik të ngërthyer në interesa mikro-politike.

Mos vallë po e ekzagjeroj? Vendi nuk ka ende një kadastër të plotë dhe transparente kombëtare funksionale, në një kohë kur Osmanët mbanin një kadastër në përputhje me nevojat e kohës deri në çastin e mbramë të rënies së Perandorisë Osmane. Nuk është planifikuar asnjë projekt i ripyllëzimit në shkallë të plotë. Rezervat ujore shpërdorohen pa u kujdesur kurrkush për to, në qytete dhe në rrethe, një kohë kur pakësimi i sasive ujore bëhet gjithnjë e më tepër i dukshëm. Në vend që banesave individuale t’u jepen zgjidhje brenda kornizës së vendosur nga planet urbane të hartuara nga shteti, plane të tilla herë krijohen enkas në shërbim të interesave të mëdha që tjetërsojnë karakterin urban dhe arkitekturor, sidomos të kryeqytetit, ndërkohë shpesh krijohen *a posteriori* për të ligjëruar ndërtesat e ngritura paligjshmërisht. Në bllokun e pallateve ku banoj unë, banorët detyrohen t’i hedhin plehrat afro 300 m nga shtëpitë e tyre, sepse bashkia nuk ka marrë masa për të vendosur kosha plehrash, ndërsa, jo rrallë, hapësirat e përbashkëta lihen pa ndriçim, pasi pjesa më e madhe e banorëve nuk paguajnë shpenzimet e caktuara për mirëmbajtjen e bllokut të banimit. Në rrugët tona automobilat lejohen të qarkullojnë, pavarësisht se nga skapamentot çlirojnë tym mbi nivelet e lejuara. Një ditë, një peshkatar po më tregonte se peshku *sparus aurata*, më i madh dhe më i fortë, i importuar nga Amerika, po vë në rrezik jetën e peshkut vendas. Duket qartë se interesat kolektive janë shndërruar në shumën e interesave individuale, ndërsa mosmarrja e përgjegjësisë individuale justifikohet me indiferencën kolektive apo shtetërore.

Aftësia e shoqërisë për të vepruar sipas një strategjie të caktuar në të mirë të mbijetesës afatgjatë të saj është zvogëluar, sa kohë interesat afatshkurtra dhe objektivat afatgjata janë identike. Koha merret si shuma e shumë çasteve të shkurtra, që nuk kanë lidhje dhe ndryshime cilësore mes tyre, në vend që aftësia për të mbijetuar në të ardhmen të jetë pika kryesore tek e cila duhet të përqendrohen politikanët tanë. Nevojat e së sotmes ngrihen mbi nevojat e së ardhmes!

KAPITULLI I

AUTORITARIZMI DHE DIKTATURA

Gjermania para-Hitlerit

Faktorët ekonomikë, politikë e socialë që mundësojnë ngritjen e Hitlerit

Daniela Nuredini, Alma Xhaferi / Udhëhoqi: Valbona Nathanaili

Abstrakt

Faktorët ekonomikë që ndihmojnë ardhjen në pushtet të Hitlerit

Faktorët politikë që ndihmojnë ardhjen në pushtet të Hitlerit

Roli i institucioneve dhe elitave gjermane

Faktorët shoqërorë dhe kulturorë që ndihmojnë ardhjen në pushtet të Hitlerit

Konkluzione

Referenca

Josif Stalini dhe stalinizmi

Klea Gega, Valbona Nathanaili

Abstrakt

Fëmijëria dhe rinia

Fillimet në politikë

Udhëheqësi Stalin

Stalinizmi si rrymë

Konkluzione: De-Stalinizmi

Referenca

Nikolai Çaushesku dhe nomenklatura

Luljeta Vokshi / Udhëhoqi: Valbona Nathanaili

Abstrakt

Fillimet në politikë

Rumania dhe udhëheqësi Çaushesku

Nomenklatura

Rënia e komunizmit në Evropën Lindore dhe pushkatimi i Çausheskut në

Rumani

Konkluzione

Referenca

DANIELA NUREDINI
Kolegji Universitar LOGOS

ALMA XHAFERI
Kolegji Universitar LOGOS

Udhëhoqi: VALBONA NATHANAILI
Kolegji Universitar LOGOS

GJERMANIA PARA-HITLERIT

***Faktorët ekonomikë, politikë e socialë që mundësojnë
ngritjen e Hitlerit***

Demokracia ka rregulla të shkruara (kushtetuese) dhe arbitra (gjykatat). Por këto funksionojnë më së miri dhe mbijetojnë shumë më gjatë, në ato vende ku përforcohen me rregullat e pashkruara të lojës. Këto rregulla ose norma shërbejnë si rojtarë të butë të demokracisë. Ato parandalojnë, ditë pas dite, konkurrencën politike nga orientimi drejt konflikteve të papërmbajtshme.

Steven Levitsky & Daniel Ziblatt: "Si vdesin demokracitë" (2018)

ABSTRAKT

Ngritja e Adolf Hitlerit në pushtet dhe konsolidimi i regjimit nazist në Gjermani gjatë viteve 1930 është një nga ngjarjet më tragjike të shekullit XX. Ky fenomen nuk ishte rezultat vetëm i ambicieve personale të Hitlerit, por një kombinim kompleks i disa faktorëve - shoqërorë, ekonomikë dhe politikë - dhe përbëjnë një periudhë të errët në historinë e Gjermanisë dhe atë botërore. Pas humbjes së Luftës së Parë Botërore, Gjermania karakterizohet nga një mungesë stabiliteti ekonomik dhe politik. Traktati i Versajës shoqërohet me masa të rënda financiare, si dhe me shkëputje terriore. Nga ana tjetër, Republika e Weimarit tregon dobësi dhe paqëndrueshmëri, duke hapur rrugë lëvizjeve të ndryshme radikale që kishin vetëm një qëllim: si të merrnin pushtetin. Në këtë artikull, merren në analizë faktorët

ekonomikë, politikë dhe sociale në Gjermani, që ndihmojnë ardhjen në pushtet të Adolf Hitlerit. Nga konkluzionet, në kontekstin e një krizë të thellë ekonomike dhe pasigurie shoqërore, si dhe duke bërë me faj hebrenjtë për shumë nga problemet e Gjermanisë, Adolf Hitleri dhe Partia Gjermane Nacional-Socialiste e Punëtorëve arrijnë të shfrytëzojnë zemërimin dhe zhgënjimin e një populli për të promovuar idetë e superioritetit racor dhe zgjerimit territorial, dhe të vinë në pushtet.

Fjalë çelës: Hitleri, manipulim, paqëndrueshmëri, dhunë, terror

FAKTORËT EKONOMIKË QË NDIHMOJNË ARDHJEN NË PUSHTET TË HITLERIT

Një nga faktorët kryesorë që kontribuoi në ngritjen e Hitlerit në pushtet është situata ekonomike e Gjermanisë. Pas Luftës së Parë Botërore, ekonomia gjermane është në kaos. Inflacioni galopant i viteve 1920 janë goditje të mëdha për popullin gjerman: monedha gjermane humb vlerën e saj në mënyrë drastike, duke bërë që çmimet të rriten në mënyrë eksponenciale, ndërsa kursimet dhe të ardhurat e gjermanëve të zakonshëm të zhvleftësohen me të njëjtin ritëm. Në kulmin e krizës ekonomike, papunësia në Gjermani arrin nivele alarmante. Një nga arsytet është modernizimi në shkallë të madhe i industrisë, që prodhon një milion të papunë. Gjërat nuk janë aspak mirë për të gjithë grupet e prodhuesve, në fshat dhe në qytet. Ekonomia tkurret, por problemi është kush do marrë pjesën më të madhe të kekut (Overy, 2003: 8).

Në vitet 1920, industria gjermane ka karakteristikat e një karteli: ndihmon prodhuesit më pak efektivë dhe më të dobët, mban në mënyrë artificiale çmimet e larta dhe kontratat që nënshkruan, si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm, kufizon konkurrencën.

(Overy, 2003: 10)

Në fillimet e viteve 1930, papunësia vazhdon të jetë problem. Kjo situatë e rëndon ndjeshëm jetën sociale dhe ekonomike të vendit, duke ndihmuar në lindjen e një ndjenje të thellë pakënaqësie dhe dëshpërimi në radhët e popullsisë, si dhe duke krijuar një ambient të përshtatshëm për radikalizëm politik. Depresioni i Madh i kësaj periudhe detyron shumë gjermanë t'i drejtohen atyre partive politike që premtojnë një zgjidhje të shpejtë dhe drastike.

ÇFARË ËSHTË DEMOKRACIA?

Paafhtësia e qeverisë për të zgjidhur krizën ekonomike dhe për të ofruar zgjidhje efektive për papunësinë dhe varfërinë shkakton rënien e besimit në institucionet demokratike. Shumë gjermanë kthejnë sytë nga Hitleri dhe Partia Gjermane Nacional-Socialiste e Punëtorëve si shpëtimtarë potencialë. Partia Gjermane Nacional-Socialiste e Punëtorëve premton mirëqenie dhe rend, dy zotime jashtëzakonisht tërheqëse për një popullsi të sflitur nga vështirësitë ekonomike. Por Hitleri dhe partia e tij fitojnë mbështetjen popullore kur angazhohen të anulojnë Traktatin e Versajës dhe të kthejnë lavdinë e humbur të Gjermanisë. Në janar të vitit 1933, kur Hitleri vjen në pushtet, papunësia në Gjermani është 34% (Silver, 1998).

FAKTORËT POLITIKË QË NDIHMOJNË ARDHJEN NË PUSHTET TË HITLERIT

Faktorët politikë në Gjermani luajnë një rol po aq të rëndësishëm në ngritjen e konsolidimin e pushtetit të Hitlerit. Kjo situatë u përkeqësua edhe më shumë nga paafhtësia e qeverisë së Weimarit për të trajtuar krizat ekonomike dhe politike me të cilat përballeshin. Republika e Weimarit, e themeluar pas Luftës së Parë Botërore, ra viktimë e Depresionit të Madh, sepse nuk pati kohë të forconte institucionet demokratike dhe, akoma më shumë, sepse udhëheqësve e mbështetësve të saj u mungoi devotshmëria e pasioni për të luftuar për demokracinë në një kohë krize (Kagan, 1991: 9). Akoma, institucionet e Republikës së Weimarit ishin të dobëta dhe shpesh të korruptuara. Kjo gjendje kontribuoi në humbjen e besimit të publikut në demokraci dhe përgatiti terrenin për ngritjen e një regjimi autoritar. Shumë gjermanë, veçanërisht nga segmentet më konservatore dhe elitare të shoqërisë, nuk e pranonin sistemin demokratik dhe shihnin në të një sistem të dobët dhe të paefektshëm.

Kushtetuta e Gjermanisë e vitit 1919 u hartua nga mendjet më të ndritura të vendit në fushën e së drejtës. *Rechtsstaat* ("sundimi i ligjit") i pranishëm për një kohë të gjatë dhe referuar me konsideratën më të lartë besohej se ishte i mjaftueshëm të parandalonte abuzimet e qeverisë. Por edhe Kushtetuta, edhe *Rechtsstaat* pësuan menjëherë kolaps në përballjen me uzurpimin e pushtetit nga Adolf Hitleri, më vitin 1933.

(Levitsky & Ziblatt, 2018: 98)


Një tjetër faktor që kontribuon në mungesën e stabilitetit politik është ndryshimi i shpeshtë i qeverive. Në periudhën midis viteve 1919 dhe 1933, Gjermania ndryshon disa qeveri. Ky ndryshim i shpeshtë krijon ndjenjën e paqëndrueshmërisë dhe të mungesës së një vizioni të qartë për të ardhmen, duke e bërë të vështirë për qytetarët të kenë besim në zgjidhjen e halleve të tyre. Përplasja e vazhdueshme dhe mungesa e stabilitetit politik i dhanë Hitlerit mundësinë të paraqitej si një figurë që mund të sjellë rend dhe stabilitet.

Nacionalizmi radikal dhe premtimi i rikthimit të nderit dhe madhësisë së Gjermanisë gjejnë terrenin e përshtatshëm në një shoqëri të dëshpëruar. Por pavarësisht ristrukturimit të partisë, riorganizimit të SA dhe zhvillimit të propagandës së tyre nën drejtimin e Goebbels-it, Partia Naziste fiton shumë pak në zgjedhjet e vitit 1928 - vetëm 2.6 % të votave, që përkthehen në 12 vende në Reichstag (The Holocaust Explained). Gjithsesi, vetëm një vit më vonë, paqëndrueshmëria ekonomike dhe politike sjellin në pushtet elitën konservatore, ndërkohë që propaganda Goebbels-it, fillon e bëhet gjithnjë e më shumë tërheqëse, nën moton "Të arrijmë ato pjesë të shoqërisë gjermane që të tjerët deri më sot i kanë lënë në harresë" (Geary, 1993: 29).

Me ndihmën e gazetave të kohës Hitleri është në gjendje, për herë të parë, të arrijë një audiencë mbarëkombëtare. Në vitin 1930, nazistët marrin tetë herë më shumë vota se në vitin 1928: arrijnë të sigurojnë 18,3 % të votave, ose ndryshe 107 vende në Reichstag. Dështimi i vazhdueshëm i qeverisë për të stabilizuar situatën në vend vetëm sa e rrit popullaritetin nazist. Partia naziste bëhet partia e dytë më e madhe në vend. Në 1932 Hitleri kundërshton Hindenburgun në zgjedhjet presidenciale, duke marrë 36,8 % të votave në votimin e dytë. Figura 1 tregon përqindjen e votave të fituara brenda një periudhe katërvjeçare: 1928-1932.

Duke e gjetur veten në një pozicion favorizues, Hitleri fillon intrigat me konservatorë si Franz von Papen, Otto Meissner dhe djalin e Presidentit Hindenburg, Oskar. Frika nga komunizmi dhe refuzimi i socialdemokratëve i lidhin ata së bashku. Aleancat që formon i mundësojnë të kërkojë mbështetje nga shumë prej manjatëve të biznesit dhe industrisë, të cilët kontrollojnë fondet politike dhe kërkonin t'i përdornin për të krijuar një qeveri të fortë të krahut të djathtë, antisocialiste. Por arritja më e rëndësishme e tij është krijimi i një partie vërtet kombëtare, me votues dhe ndjekës të ardhur nga klasa dhe grupe të ndryshme fetare, unike për Gjermaninë e asaj kohe (Hamilton, 1982).

Përdorimi i sofistikuar i propagandës, si dhe manipulimi me frikën dhe dëshirën për stabilitet, duke përdorur një gjuhë intimiduese e bulluese, gërshtuar me një vizion të bukur, në synimin për të marrë tek audienca atë që dëshironin, mund të



Figurë 1: Përqindja e votave të fituara nga Partia Gjermane Nacional-Socialiste e Punëtorëve, në zgjedhjet e përgjithshme, për periudhën 1928-1932.

quhen faktorët kyç që i sigurojnë fitimin e mbështetjes së gjerë publike (në teorinë e leadershipit, njihet si aftësi politike, Joseph, 2010: 323-4), por nuk mbaron këtu. Nazistët eliminuan kundërshtarët politikë dhe konsoliduan pushtetin e tyre përmes dhunës, intimidimit dhe torturave (këto të fundit u perfeksionuan edhe më shumë në vitet e ardhjes në pushtet, nga Gestapo, Moore, J. J., 2017: 52), përfshirë përdorimin e organizatave paramilitare si SA dhe SS – të gjitha këto, nën udhëheqjen e një njeriu që e çoi botën në Luftën e Dytë Botërore, në misionin për ta sunduar dhe për të lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë moderne (Brooks, 2016).

ROLI I INSTITUCIONEVE DHE ELITAVE GJERMANE

Institucionet dhe elitat gjermane, ushtarake dhe industriale, luajnë një rol të rëndësishëm në ngritjen e Hitlerit. Ato shohin tek Hitleri një figurë, në gjendje të stabilizojë vendin, si dhe të mbrojë interesat e tyre. Mbështetja e këtyre grupeve është kyçe në marrjen dhe konsolidimin e pushtetit nga Hitleri:

Sistemi politik i Wiemar-it ishte themeluar që në vitin 1919, nga një koalicion pro-demokratik i katolikëve, liberalëve dhe socialdemokratëve. Por në fillimvitet 1930, ekonomia gjermane pëson lëkundje të fuqishme. Si pasojë, politika e qendrës së djathtë bie pre e luftërave të brendshme, gjë që mundëson rritjen e popullaritetit për ekstremistët - komunistët dhe nazistët. Qeveria e zgjedhur rrëzohet në mars të vitit 1930, duke e bërë dhimbjen e “Depresionit të Madh” edhe më të thellë. Me lëvizjet e qëllimshme të politikës për të bllokuar çdo nismë të qeverisë, presidenti kukull, heroi i Luftës së Parë Botërore, Paul von Hindenburg, shfrytëzon autoritetin që i jepte një nen i kushtetutës - nëse në rrethana të jashtëzakonshme parlamenti dështonte në formimin e shumicës qeverisëse - për t’ia kaluar drejtimin e vendit një kancelari të pazgjedhur, emëruar nga ai, si kryetar shteti. Një intrigë e thurur nga bashkëpunimi i konservatorëve rivalë në janar të vitit 1933, konkludon me gjetjen e zgjidhjes dhe propozimin: qeverisja e vendit i duhet besuar një të jashtmi nga radhët e politikës, një njeriu popullor. Më 30 janar 1933, Adolf Hitleri merr postin e kancelarit të Gjermanisë.

(Levitsky & Ziblatt, 2018: 14)

FAKTORËT SHOQËRORË DHE KULTURORË QË NDIHMojnë ARDHJEN NË PUSHTET TË HITLERIT

Faktorët shoqërorë dhe kulturorë në Gjermani luajnë një rol po aq të rëndësishëm në ngritjen e Hitlerit në pushtet. Pas Luftës së Parë Botërore, Gjermania përjeton një periudhë pasigurie dhe ndryshimesh të mëdha shoqërore dhe kulturore. Marrëveshja e Versajës ishte veçanërisht e vështirë për t’u pranuar për shumë gjermanë, pasi impononte kushte të rënda dhe shkatërruese për vendin: Traktati i dytë i Versajës i vitit 1919 ia kalon Alsasën Francës fituese (Galtung, 2007: 125). Kjo ndjenjë humbjeje dhe turpi u shfrytëzua nga Hitleri për të mobilizuar mbështetësit dhe për të promovuar idetë e tij të superioritetit racor (Moore, 1993) dhe zgjerimit territorial. Nacionalizmi radikal, me premtimin e rikthimit të nderit dhe madhështisë së Gjermanisë gjejnë terren të përshtatshëm në një shoqëri të dëshpëruar dhe të gjitha bashkë krijojnë një mjedis, ku ideologjitë ekstreme mund të përhapen dhe gjejnë mbështetje.

Antisemitizmi (*Ibid*) dhe ideologjitë raciste janë, gjithashtu, faktorë të rëndësishëm që kontribuojnë në ngritjen e Hitlerit. Me ndihmën e mijëra vjet antisemitizëm, 400 vjet përvojë ushtarake prusiane, koston e 150 milionë njerëzve të vrarë dhe zhdukjen e disa racave, Hitleri pothuaj arrin të realizojë synimin e tij: t’i imponojë botës fantazinë e tij të shfrenuar (Moore, J. J., 2017: vi).

KONKLUZIONE

Në kontekstin e një krizë të thellë ekonomike dhe pasigurie shoqërore, si dhe duke bërë me faj hebrenjtë për shumë nga problemet e Gjermanisë, Adolf Hitleri dhe Partia Gjermane Nacional-Socialiste e Punëtorëve arrijnë të shfrytëzojnë zemërimin dhe zhgënjimin e një populli për të promovuar idetë e superioritetit racor dhe zgjerimit territorial, dhe të vinë në pushtet. Puna e parë që bëjnë është të çmontojnë demokracinë.

REFERENCA

- Brooks, A. (2016). *Adolf Hitler. Lessons from Evil: Learn How a Corporal Raised to Full Power and Changed the World*. Create Space Independent Publishing Platform.
- Galtung, J. (2007). *Transendencë dhe transformim. Një hyrje në mënyrën e funksionimit të konfliktit*. Shqip: Nathanaili, V.; Tiranë: UFO Press.
- Geary, D. (1993). *Hitler and Nazism*. London and New York: Routledge.
- Hamilton, R. (1982) *Who Voted for Hitler?* New Jersey: Princeton University Press.
- Joseph, S.N. Jr. (2010). Power and leadership. In Nohria, N. & Khurana, R. (eds). *Handbook of Leadership Theory and Practice. A Harvard Business School Centennial Colloquium*. Boston, Massachusetts: Harvard Business Press, ff. 305-334.
- Kagan, D. (1991). *Pericles of Athens and the birth of Democracy*. New York: The Free Press.
- Levitsky, S. & Ziblatt, D. (2018) *Si vdesin demokracitë*. Përktheu në shqip: Valbona Nathanaili. Prishtinë: Pema.
- Moore, J. J. (2017). *The Nazis: The Hidden History. The catastrophic impact of the Third Reich*. New Holland Publishers.
- Moore, S. (2010). *How Hitler came to Power*. Bloomington, Indiana: AuthorHouse.
- Overy, R. J. (2003). *The Nazi Economic Recovery 1932-1938*. New York: Press Syndicate of the Cambridge University Press.
- Silver, D. P. (1998). *Hitler's Economy: Nazi Work Creation Programs, 1933-1936*. Harvard University Press.
- The Holocaust Explained: The Nazi rise to power. <https://www.theholocaustexplained.org/the-nazi-rise-to-power/the-nazi-rise-to-power/elections/> Gjetur më 11 shtator 2024.

KLEA GEGA
Kolegji Universitar LOGOS

VALBONA NATHANAILI
Kolegji Universitar LOGOS

JOSIF STALINI DHE STALINIZMI

Ideja staliniste për realitetin nuk mund të quhet as edhe një reflektim pasiv. Doktrina staliniste ka pak lidhje me realitetin sovjetik. Synimi i vetëm është ta pasqyrojë në mënyrë të kamufluar. Një pikturë e deformuar e realitetit, me synimin e vetëm për të gabuar njerëzit. Me pak fjalë, është thjesht propagandë, që flet për rendin demokratik, paqen dhe proletariatin.

Erik van Ree: "The Political Thought of Joseph Stalin: A Study in Twentieth Century Revolutionary Patriotism" (2002)

ABSTRAKT

Joseph Stalin ishte udhëheqësi komunist, totalitar i ish-Bashkimit Sovjetik nga 21 janari 1924 deri më 5 mars 1953. Në këtë artikull, synimi kryesor është të jepen disa nga karakteristikat e Stalinit si udhëheqës, si dhe të rrymës që krijoi e frymëzoi në periudhën e pushtetit, stalinizmit. Analiza bazohet në literaturë. Nga konkluzionet, Stalini ka qenë kriminel, ideatori i vrasjeve të miliona njerëzve, njeri pa parime, përfshirë gënjeshtar, oportunist dhe cinik, që luftoi pa mëshirë çdo grup apo individ në gjendje të sfidonte regjimin komunist; stalinizmi, ndryshe doktrina e Stalinit, synonte paraqitjen e një realiteti të ri, që kamuflonte realitetin e vërtetë, atë që ndodhte me jetën e njerëzve dhe ekonominë e politikën e një vendi.

Fjalë çelës: Stalini, Bashkimi Sovjetik, stalinizmi, pushteti, karakteristika

FËMIJËRIA DHE RINIA

Joseph Dzhugashvili, njeriu që do të njihej më vonë në gjithë botën si Joseph Stalini, u lind në Gori, Gjeorgji, më 18 dhjetor 1878 (përshtatur sipas kalendarit perëndimor në Bashkimin Sovjetik më 1918), por datëlindja e tij zyrtare, ajo që do të përdorë përgjatë gjithë jetës si udhëheqës i vendit është 21 dhjetor 1879 (Marples & Hurska, 2022, f. 1). Djali i tretë i Yekaterina (Keke) dhe Vissarion (Beso) Dzhugashvili, e ëma lutej që të rronte – dy djemtë e parë i kishin vdekur foshnja. Yekaterina, duke qenë fetare dhe e pikëlluar nga humbjet e mëparshme, vendos ta quaj djalin sipas Shën Joseph. Por ndonëse Gori ishte shumë i varfër – vdekjet dhe sëmundjet ishin pjesë e pandarë e të përditshmes (Haugen, 2006, f. 15), lutjet e së ëmës plotësohen. Djali rritet i shëndetshëm, por në shtëpi nuk mungojnë të rrahurat. Babai e rrihte shpesh të birin, brutalisht, por kur nuk kursente as të shoqen. Gjithsesi, dashuria e së ëmës është konstante në jetën e djalit dhe njëherazi edhe engjëlli mbrojtës ndaj të atit.

Yekaterina ëndërronte për të birin të bëhej prift, ndërsa i ati, me profesion këpucar, por i dhënë pas pijes, mendonte se jeta e klasës punëtore ishte e duhura për djalin e tyre. Kur djali mbush 5 vjec, Yekaterina nuk e duron më dhunën e të shoqit dhe e përzë nga shtëpia. Jeta bëhet edhe më vështirë, por të paktën nuk ka dhunë. Yekaterina bën dy deri tre punë për të mbajtur familjen me dy veta. Në vitin 1888, djali fillon studimet në shkollën e kishës, në Gori, dhe del me rezultate të mira. Në këtë periudhë krijon disa poezi, që dallohen për nota romantike, por që me kalimin e kohës fillojnë të marrin nuanca të errëta. Në vitin 1894, falë një burse, fillon studimet në Seminarin Teologjik të Tiflis-it, dhe duket se shpresat e së ëmës po plotësohen, por në fakt Josifit nuk i intereson shkolla. Plotëson me rregull detyrat e shtëpisë, por vëmendjen e tij e tërheq një lloj tjetër literature, që mungon në shkollë. Ndërkohë, rregullat e rrepta të seminarit bëjnë që një grup studentësh, ndërmjet të cilëve edhe Josifi, të rebelohen.

Leximet e shumta fillojnë të formojnë tek djali një botëkuptim të ri për shoqërinë dhe qeverisjen. Nacionalizmi duket të jetë faktori më i rëndësishëm që ndikon në zhvillimin e mendimit politik të mëvonshëm (Ree Van, 2002: 58).

FILLIMET NË POLITIKË

Në vitin 1898, Vladimir Lenini formon Partinë Social-Demokratike Ruse të Punës, pjesë e së cilës bëhet edhe Stalini, për sesionin e Tiflis-it. Veprimtaria politike zhvillohet në ilegalitet. Ndonëse nuk dallohet për ndonjë oratori të veçantë,

Stalini e caktojnë të organizojë disa kurse për marksizmin. Për herë të parë Stalini ndihet i plotësuar – po bën atë për të cilën ishte lindur (Haugen, 2006: 23). Për zhgënjimin e së ëmës, nuk i rikthehet më studimeve për prift.

Në janar të vitit 1900 fillon punë në Observatorin Gjeofizik të Tiflis-it, një mundësi që e ndihmon të zhvillojë aktivitetin e tij revolucionar. Fjalimin e parë politik e mban në rrethinat e Tiflisit, në mars të vitit 1900, si pjesë e demonstrimeve të punëtorëve kundër kushteve të këqija të punës, ku bën thirrje për revolucion. Reagimi zyrtar është i menjëhershëm – shumë nga drejtuesit arrestohen, por Stalini e kupton dhe kalon në ilegalitet. Aktiviteti i tij revolucionar merr nota shumë më të ashpra, gjë që pasqyrohet në demonstrimet e majit të vitit 1901, që janë shumë më të dhunshme. Më 18 prill 1902 policia arrin ta arrestojë dhe e fusin në burg. Asnjë gjyq, deri sa regjimi të vendoste se çfarë duhej të bënte me të. Në nëntor të vitit 1903 vjen vendimi – Stalini nisat drejt Siberisë. Dënimi ishte dhënë: 3 vjet! Por më 18 janar 1904 arrin të arratiset dhe kthehet përsëri në Tiflis, ku i bashkohet grupit bolshevik të Partisë Social-Demokratike Ruse të Punës, udhëhequr nga Lenini. Më vitin 1904 është një nga organizatorët për grabitjen e një banke në Baku, përmes së cilës arrin të sigurojë fonde për partinë (Marples & Hurska, 2022: 1).

Në periudhën 1902-1913, Stalini arrestohet dhe dërgohet në ekzil, në Serbi, shtatë herë dhe arratiset gjashtë herë. Vetëm dënimin e fundit, 1913-1917, për herë të parë dhe të fundit, e bën dënimin të plotë. Ndonëse nuk ishte i pranishëm në ngjarjet e tetorit, kishte arritur ta konsolidonte veten si një figurë të rëndësishme të partisë bolshevice.

UDHËHEQËSI STALIN

Pas vdekjes së Leninit, më janar të vitit 1924, Stalinit iu deshën pesë vjet të shndërrohej në liderin e padiskutueshëm të Bashkimit Sovjetik (Ree, 2002: 84-85). Dhuna dhe torturat janë të zakonshme ndaj kujtdo që ka potencialin të sfidojë vizionin e tij, kryesisht të ashtuquajturit kulakë, udhëheqësit e besimit fetar, armiq të politikë, si dhe të gjithë atyre që kishin lidhje me regjimin e vjetër - vetëm hekuri i nxehtë është në gjendje të nxjerrë të vërtetën (Ree Van, 2002: 6). Stalini miraton një sërë spastrimesh përgjatë viteve 1930, që kulmojnë me Terrorin e Madh të viteve 1937-1938. Vetëm gjatë kësaj periudhe besohen të jenë vrarë afro një milion njerëz, me akuzën e spiunazhit, sabotazhit dhe terrorit. Por vrasjet nuk kufizohen vetëm në kufijtë e vendit. Një nga udhëheqësit më të famshëm të Bashkimit Sovjetik dhe ish-rivali politik i tij, Leon Trocky, u gjet dhe u vra nga agentët sovjetikë në anën tjetër

të botës, në Meksikë, që në propagandën sovjetike të Moskës paraqitet si fundi i një vrasësi, tradhtari dhe spiuni ndërkombëtar (Rubenstein, 2011: 204).

Në përpjekje për të shpjeguar sjelljen e Stalinit, qëndrimet që mbajnë autorë të ndryshëm mund të klasifikohen në tre grupe. Grupi i parë ka arritur në përfundimin se veprimet represive të Stalinit ishin të llogaritura dhe se ai ishte mendërisht normal në ekzekutimin e këtyre masave (Ree Van, 2002). Një grup i dytë arsyeton se veprimet politike represive të Stalinit ishin rezultat i sëmundjes mendore: Stalini me gjasë ka pasur çrregullime mendore psikopatike. Paranoja dhe sjellja manipuluese ndikonin vendimet e tij politike (Robins & Post, 1997: 24). Udhëheqës të tillë lulëzojnë në regjime autoritare. Ata shohin armiq, realë dhe imagjinarë, nga të katër anët. Një perspektivë e tretë pretendon se veprimet represive të Stalinit ishin vazhdim i kulturës mbizotëruese politike, autoritare dhe shtypëse që i ka rrënjët në Rusinë cariste.

STALINIZMI SI RRYMË

Në këtë artikull, karakteristikat e stalinizmit bazohen në ato të identifikuara nga Wood (2004: 58). Fillimisht, duhet theksuar se vendi ishte ekonomikisht i prapambetur në krahasim me vendet e tjera. Por në Bashkimin Sovjetik, nën drejtimin e Stalinit, çdo aspekt i ekonomisë kontrollohej nga shteti (Rigby, 1999: 53). Shteti ishte përgjegjës për buxhetin, investimet në industri, çmimet, qiratë, transportin, pensionet, pagesën për kopshtet dhe deri varrimin e njerëzve. Nuk kishte banka private, aksione, bursë, reklama apo treg të lirë. Lejohej një segment i vogël i tregut, si për shembull shitja e prodhimeve nga fshatarët e vegjël, por gjithnjë nën mbikëqyrjen e autoriteteve shtetërore, ndërkohë që lulëzonte tregu i zi. Duke vazhduar me karakteristikat, ekonomia ishte tërësisht e “komanduar”, ku rolin kryesor e kishte industria e rëndë, si hekuri, çeliku dhe nafta. Industrializimi i shpejtë u shoqërua me kolektivizimin masiv të bujqësisë dhe të urbanizimit po aq të shpejtë – ky i fundit shndërroi shumë fshatra të vegjël në qytete industriale. Ekonomia ecte me plane pesë-vjeçare.

Karakteristika e dytë – dhe në një perspektivë edhe më e dukshme - ka lidhje me kultin e individit të Stalinit, që merr përmasat e një “mbinjeriu”, një projekt që fillon të marrë jetë në vitet 1930. Fitorja në Luftën e Dytë Botërore e ngre autoritetin e Stalinit në lartësi të paprecedentë, duke e bërë njeriun më popullor në gjithë Bashkimin Sovjetik. Stalini vishet me aureolën e lavidisë, ku spikasin përkushtimi ndaj revolucionit, aftësitë e mrekullueshme intelektuale, mençuria e pakufishme,

cilësitë e një prijësi ushtarak, si dhe arritjet ekonomike të vendit nën udhëheqjen e tij. Një numër i madh objektesh e veprash marrin emrin e tij, përfshirë fabrika, qendra kulturore, vendbanime dhe një qytet, Stalingradi. Epitetet që e shoqërojnë janë nga më të pabesueshmit: “Babai i kombit”, “Kapiteni i industrisë”, “Miku më i ngushtë i armëve i Leninit”, “Mësuesi i Madh”, “Dielli që shkëlqen”... Por jo vetëm në Bashkimin Sovjetik! Kulti i individit shtrihet edhe në ish-Republikat Sovjetike dhe vendet satelite të kohës të Bashkimit Sovjetik dhe ideologjisë së tij.

Në Shqipëri, sheshi “Mustafa Kemal Atatürk”, aty ku pritet unaza e vogël me rrugën e Kavajës, në kohën e komunizmit - dhe shpesh edhe sot – njihet si sheshi “21 dhjetori”, sepse të çonte tek ndërmarrja e ndërtimit “21 dhjetori”, sipas datëlindjes së ish-udhëheqësit të Bashkimit Sovjetik, J. Stalin (Nathanaili, 2013: 115), ndërkohë që parulla që zbatohej në Shqipëri, e njëjtë me atë që zbatohej në Bashkimin Sovjetik ishte: “Mbështetje te fshatari i varfër, aleancë me fshatarin e mesëm, luftë kundër kulakut (Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste të PPSH-së, 1981: 243).

KONKLUZIONE: DE-STALINIZMI

Pyetja që shtrohet më shpesh është nëse stalinizmi ishte vazhdimi i leninizmit. Duke filluar nga mesi i viteve 1920, në doktrinën komuniste bëhet e qartë se e vetmja izëm- që mund të shtohet prapa një lëvizje në radhët e saj dhe krejtësisht e ligjshme është leninizmi (ose marksizëm-leninizmi):

Stalinizmi është një fenomen specifik, i veçuar historikisht, që ndonëse e ka origjinën tek leninizmi dhe në karakteristikat e vendit, pati vulën e personalitetit dhe mendimit të Stalinit.

(Tucker, 1999: 77)

Stalini ka qenë kriminel, ideatori i vrasjeve të miliona njerëzve, njeri pa parime, përfshirë gënjeshtar, oportunisist dhe cinik, që luftoi pa mëshirë çdo grup apo individ në gjendje të sfidonte regjimin komunist; stalinizmi, ndryshe doktrina e Stalinit, synonte paraqitjen e një realiteti të ri, që kamuflonte realitetin e vërtetë, atë që ndodhte me jetën e njerëzve dhe ekonominë e politikën e një vendi. Si krijuesi i një prej pushteteve më brutale në histori, Stalini është përgjegjës për vdekjen e miliona njerëzve: shifra besohet të luhatet në kufijtë nga 24 milionë në 40 milionë qytetarë të Bashkimit Sovjetik (Robins & Post, 1997: 24).

Josif Stalin ka qenë Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste Sovjetike për tridhjetë e një vjet (1922-1953). Pas vdekjes së tij, për një periudhë pothuaj të njëjtë, partia është udhëhequr nga gjashtë personazhe të tjerë, Malenkovi, Hrushovi, Brezhnjevi, Andropovi, Chernenko dhe Gorbaçovi, përgjatë së cilës kanë ndodhur shumë ndryshime, ekonomike, sociale, administrative, teknologjike, kulturore dhe ushtarake, të cilat në përgjithësi referohen me një emër, de-stalinizmi (Wood, 2004: 59).

Hapi i parë ishte publikimi i mizorive të Stalinit! Më pas, pranimi i gabimeve të bëra nën udhëheqjen e tij dhe identifikimi i të gjithë të vrarëve, në mënyrë të fshehtë dhe të hapur.

Aktualisht, “stalinizmi” referohet me konotacion negativ, për shkak të veprimeve jashtëzakonisht represive politike të ndërmarra nga Stalini.

REFERENCA

- Haugen, B. (2006) *Joseph Stalin: Dictator of the Soviet Union*. Compass Point Books.
- Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste të PPSH-së (1981). *Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë*. Tiranë: 8 nëntori, botimi i dytë.
- Marples, D. R. & Hurska, A. (2022). *Joseph Stalin: A Reference Guide to His Life and Works*. Rowman & Littlefield.
- Nathanaili, V. (2013). *Arsim dhe pabarazi. Sfida e perceptimit ndryshe*. Tiranë: UET Press.
- Ree Van, E. (2002). *The Political Thought of Joseph Stalin: A Study in Twentieth Century Revolutionary Patriotism*. Routledge.
- Rigby, T. H. (1999). Stalinism and Mono-Organizational Society. In American Council of Learned Societies. Planning Group on Comparative Communist Studies (Eds.). *Stalinism: Essays in Historical Interpretation*. New Jersey: Transactions Publishers (ff.53-76)
- Robins, R.S., Post, J.M. (1997). *Political Paranoia: The Psychopolitics of Hatred*. New Haven and London: Yale University Press.
- Rubenstein, J. (2011). *Leon Trotsky: A Revolutionary's Life*. New Haven and London: Yale University Press.
- Tucker, R. C. (1999). Stalinism as revolution from above. In American Council of Learned Societies. Planning Group on Comparative Communist Studies (Eds.). *Stalinism: Essays in Historical Interpretation*. New Jersey: Transactions Publishers (ff. 77-110).
- Wood, A. (2004). *Stalin and Stalinism*. Routledge.

LULJETA VOKSHI
Kolegji Universitar LOGOS

Udhëhoqi: VALBONA NATHANAILI
Kolegji Universitar LOGOS

NIKOLAI ÇAUSHESKU DHE NOMENKLATURA

Nën qeverisjen diktatoriale njerëzit nuk kanë nevojë të mendojnë, nuk kanë nevojë të zgjedhin, nuk kanë nevojë të diskutojnë ose të japin pëlqimin e tyre. Gjithçka që duhet të bëjnë është të binden. Ky është leksioni i hidhur që kam nxjerrë nga përvoja politike në Filipine jo shumë kohë më parë. Në kontrast, një demokraci nuk mund të mbijetojë pa virtytet civile ... Sfida politike sot, për njerëzit në të gjithë botën, nuk është thjesht zëvendësimi i regjimeve totalitare me ato demokratike. Përtej kësaj, ajo që duhet të bëjmë është që demokracia të funksionojë edhe për njerëzit e thjeshtë.

Fidel Valdez Ramos, ish-President i Filipineve: "Pjesë nga fjalimi mbajtur në Universitetin Kombëtar Australian" (nëntor, 1998)

ABSTRAKT

Në këtë artikull, synimi i parë është të jepet një përshkrim i shkurtër i fillimeve në politikë të Nikolai Çausheikut, si dhe i marrëdhënieve që vendos me perëndimin. Një synim i dytë është paraqitja e disa prej karakteristikave të klasës së re që krijohet në Rumani, në kohën që vendi udhëhiqet nga Çausheiku, Nomenklatura. Qasja e përdorur është cilësore dhe bazohet në studim literature. Nga konkluzionet, për të mbajtur pushtetin, Çausheiku krijoi një klasë të re, Nomenklaturën, përgjegjëse për gjenocidin komunist në Rumani: vendimet që e shtynë vendin drejt një katastrofe ekonomike, politike, demografike, kulturore, morale dhe ekologjike janë marrë nga drejtuesit kryesorë të kësaj nomenklature.

Fjalë çelës: Çausheiku, Rumani, komunizmi, pushteti, nomenklatura.

FILLIMET NË POLITIKË

Nikolai Çaushesku, lideri komunist i Rumanisë për periudhën 1967-1989 dhe njeriu më i pushtetshëm që ka qenë ndonjëherë në krye të vendit, u lind më 26 janar 1918 në Skorniçesti, një qytezë e vogël në jug-perëndim të Oltenias. Fëmija i tretë në një familje të varfër fshatare me dhjetë fëmijë, në moshën njëmbëdhjetë vjeçare largohet drejt Bukureshtit në kërkim të punës.

Shumë shpejt bëhet anëtar i Partisë Komuniste. Në periudhën 1933-1938 burgoset dhe lirohet katër herë; më 1936 është Sekretar i Komitetit Rajonal të Bashkimit të Komunistëve të Rinj; vetëm dy vjet më vonë, më 1938, merr postin e Sekretarit të përgjithshëm.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, deri në gusht 1944, me përmbyshjen e Antoneskut, Çausheskun e çojnë sa në një burg në tjetrin. Vitin e fundit të dënimit e vuan në kampin e përqendrimit në Tîrgu Jiu, ku njihet me pjesën më të madhe të drejtuesve të partisë komuniste rumune, ku mund të veçohet Gheorghiu-Dej, personi që do të drejtojë partinë dhe vendin për një kohë të gjatë në periudhën e pasçlirimit, dhe njeriu që ndihmon në ngritjen në pushtet të Çausheskut.

Deri në vitin 1952, kur Gheorghiu-Dej vendos të spastrojë radhët e pushtetarëve që njihen si mbështetës të sovjetikëve, detyra më e rëndësishme e Çausheskut ka qenë ajo e zëvendës ministrit të forcave të armatosura, me përgjegjësinë e veçantë të përfaqësuesit të lartë politik në ushtri, pozicion që e ndihmon të vendosë kontrollin e plotë mbi ushtrinë me të ardhur në pushtet.

RUMANIA DHE UDHËHEQËSI ÇAUSHESKU

Në Luftën e Parë Botërore, Bukureshti kishte fituar territore, falë shpërbërjes së Perandorisë Austro-Hungareze dhe asaj Ruse, por me afrimin e Luftës së Dytë Botërore i humbet sërish. Fillimisht aleat me nazistët, Bukureshti ndërron anë më 1944, por ende dominohet nga Bashkimi Sovjetik, i cili krijon, mbështet dhe ndihmon të qëndrojnë në fuqi një qeveri komuniste. Pushteti dhe gjithë sa lidhen me të, në Rumaninë e pas Luftës së Dytë Botërore janë një imitim i përkryer i organizimit politik të Bashkimit Sovjetik, ndërsa normat dhe praktikat që zbatohen e vendosen janë ato staliniste. Më 2 mars 1949 në vend nuk ka më asnjë pronar tokash, gjë që çon në zhdukjen e kësaj klase – e cila fillon të referohet me një emër të ri, kulakët - ndërkohë që reformimi i pronësisë së bankave, objekteve industriale, sigurimeve, minierave dhe transportit, që i shndërron të gjitha në pronë

shtetërore shkatërron plotësisht bazën ekonomike të të ashtuquajturve “armiq të klasës punëtore” (Deletant, 1995: 8).

Me vdekjen e Dej (19 mars 1965), brenda javës, më 22 mars 1965 Çaushesku merr postin e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Komuniste të Rumanisë; vetëm dy vjet më vonë, më 1967, atë të Presidentit.

Dekada e parë e pushtetit të tij, në ndryshim nga pjesa më e madhe e udhëheqësve të vendeve të tjera të Traktatit të Varshavës, karakterizohet nga një politikë e hapur ndaj Evropës Perëndimore dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, falë së cilës fillon të njihet si liberal. Më 1967, Rumania është vendi i parë i Bllokut të Lindjes që vendos marrëdhënie diplomatike me Gjermaninë Perëndimore. Nga viti 1968, Çaushesku ka mbështetjen e pothuaj të gjitha demokracive perëndimore (me përjashtim të dy-tre viteve të fundit të regjimit të tij), të bindur se është i vetmi udhëheqës që lufton bllokun monolit të udhëheqësve të tjerë të vendeve të lindjes (Boldur-Lătescu, 2005: 61). Më 1969, Çaushesku mirëpret presidentin e sapo zgjedhur të SHBA-së, Richard Nikson. Akoma, denoncimi që Çaushesku i bën pushtimit të Çekosllovakisë nga sovjetikët i shërbejnë konsolidimit të figurës së tij në radhët e popullit si njeri i guximshëm, si personi që kërkon t'i shmangët diktatit sovjetik: më 20 gusht të vitit 1968, tanket sovjetike hyjnë në Çekosllovakinë komuniste për të shtypur lëvizjen demokratike të njohur si “Pranvera e Pragës” (Vatikan News), dhe Çaushesku është personaliteti i vetëm komunist që guxon të kritikojë pushtimin e Çekosllovakisë nga Bashkimi Sovjetik.

Por shumë shpejt gjithçka shndërrohet në një iluzion. Viti 1971 shënjon kthimin prapa dhe zhbërjen e shumë politikave, që duket se fillojnë të formatohen me ato të komunistëve kinezë.

NOMENKLATURA

Forcimi i pushtetit të Çausheskut shoqërohet me krijimin e një klase të re, me të cilën udhëheq së bashku, e quajtur “nomenklatura”. Analiza e nomenklaturës bazohet në veprën e Boldur-Lătescu (2005).

Nomenklatura është e përbërë nga tre shtresa: nomenklatura e lartë; nomenklatura lokale dhe grupe të tjera të privileguara. Në nomenklaturën e lartë bëjnë pjesë zyrtarë të aparatit qendror të partisë dhe shtetit, drejtues të sigurimit, ushtrisë dhe sistemit gjyqësor, si dhe drejtues të institucioneve të rëndësishme të vendit. Nomenklatura lokale është një pasqyrë e nomenklaturës së lartë dhe numëron disa qindra mijëra individë të privilegjuar. Shtresa e tretë

mund të thuhet se është më heterogjene, sepse përfshin një segment më të gjerë të punësuarish, si zyrtarë dhe oficerë të lartë të policisë, ushtrisë e sigurimit, drejtorë të ndërmarrjeve të mëdha, aktivistë, profesorë universitetesh, doktorë, shkrimtarë, gazetarë, agronomë dhe presidentë kooperativash.

Karakteristika kryesore që i bashkon të treja këto shtresa është se gëzojnë një sërë privilegjesh, jo domosdoshmërisht të lidhura me ndonjë meritë individuale të veçantë, por thjesht sepse janë pjesë e një klase të re. Por edhe privilegjet që gëzojnë janë përsëri të shtresëzuara. Anëtarët e nomenklaturës së lartë kanë të ardhura që shkojnë 5 deri në 6 herë më shumë se rroga e zyrtarëve të zakonshëm, jetojnë në banesa luksoze, si dhe kanë mundësi të blejnë në tregje ku nuk hyjnë njerëzit e zakonshëm, dhe ku mallrat shiten me çmime shumë të ulëta. Edhe shtresat e tjera të nomenklaturës gëzojnë privilegje të kësaj natyre, por në një shkallë më të vogël.

Nomenklatura është përgjegjëse për gjenocidin komunist në Rumani: vendimet që e shtynë vendin drejt një katastrofe ekonomike, politike, demografike, kulturore, morale dhe ekologjike janë marrë nga drejtuesit kryesorë të kësaj nomenklature.

(Boldur-Lătescu, 2005: 55)

RËNIA E KOMUNIZMIT NË EVROPËN LINDORE DHE PUSHKATIMI I ÇAUSHESKUT NË RUMANI

Viti 1989 është viti i kryengritjeve të jashtëzakonshme popullore në të gjithë botën. Demonstratat e studentëve dhe punëtorëve në sheshin Tienanmen të Pekinit, që kërkonin vendosjen e demokracisë, por që shumë shpejt përfunduan me gjakderdhje (Zëri i Amerikës), rënia e Murit të Berlinit dhe Revolucioni i Kadifenjtë në Çekosllovakia (Association for diplomatic studies and training), shërbejnë si një masë kritike për iniciimin e lëvizjeve të ngjashme, veçanërisht në Evropën Lindore.

Të gjitha vendet satelite të Bashkimit Sovjetik, arrijnë t'i përmbysin regjimet komuniste në mënyrë paqësore. Faktori më kritik që i dha fund komunizmit si sistem qeverisjeje ishte vendimi i Gorbaçovit për të mbajtur Ushtrinë e Kuqe në kazerma. Me përjashtim të Rumanisë! Nikolai Çausheku ishte i vendosur të ruante kontrollin, pavarësisht kostos njerëzore.

Revolta kundër regjimit të Çaushekut fillon në mes të dhjetorit në qytetin perëndimor të Timisoarës, por u shua me dhunë me urdhër të Çaushekut. Pavarësisht terrorit, revolta përhapet shpejt në të gjithë vendin. Qindra mijëra protestues mblidhen në Bukuresht, pas një fjalimi të menaxhuar me kujdes, por përfundimisht të dështuar nga Çausheku më 21 dhjetor 1989 (McGrath, S., 2019).

KONKLUZIONE

Ekzekutimi i Çausheskut dhe bashkëshortes së tij, Elenës, i dha fund një sundimi çerek shekullor me grusht të hekurt, që u përkthye në shtypje dhe mjerim për shumicën e rumunëve (Butnariu, 2017). Mbretërimi i tmerrshëm njëzet e katërvjeçar kishte përfunduar në mënyrë të turpshme!

Për të mbajtur pushtetin, Çaushesku krijoi një klasë të re, Nomenklaturën. Për Boldur-Lătescu, Nomenklatura është përgjegjëse për gjenocidin komunist në Rumani: vendimet që e shtynë vendin drejt një katastrofe ekonomike, politike, demografike, kulturore, morale dhe ekologjike janë marrë nga drejtuesit kryesorë të kësaj nomenklature.

REFERENCA

- Association for diplomatic studies and training. *The 1989 Romanian Revolution and the Fall of Ceausescu*. <https://adst.org/2015/10/the-1989-romanian-revolution-and-the-fall-of-ceausescu/> Gjetur më 15 qershor 2024
- Boldur-Lătescu, G. (2005) *The Communist Genocide in Romania*. New York: Nova Science Publishers, Inc.
- Butnariu, Cristian (2017). *Nicolae Ceausescu: The Profile of a Tyrant and Dictator*. Createspace Independent Pub.
- Deletant, D. (1995). *Ceaușescu and the Securitate: Coercion and Dissent in Romania, 1965-1989*. C. Hurst & Co. (Publishers).
- Fidel Valdez Ramos. (1998). Fjalimi mbajtur në Universitetin Kombëtar Australian. <https://asiasociety.org/keynote-address-asia-foreign-policy-update-luncheon-fidel-valdez-ramos>
- McGrath, S. (2019). *Executing a dictator: Open wounds of Romania's Christmas revolution*. BBC, on-line. <https://www.bbc.com/news/world-europe-50821546> Gjetur më 3 tetor 2024.
- Medium. *The Rise and Fall of the Tyrant Nicolae Ceaușescu*. <https://mcgarmott.medium.com/how-citizens-get-rid-of-their-tyrants-i-nicolae-ceau%C8%99escu-fa500e5a9fd0> Gjetur më 15 qershor 2024.
- Vatikan News. 51 vjet më parë përfundonte Pranvera e Pragës. Ar' Glaser: "Nuk duhet harruar". <https://www.vaticannews.va/sq/bota/news/2019-08/51-vjet-me-pare-perfundonte-pranvera-prages-ate-glaser.html> Gjetur më 15 qershor 2024.
- Zëri i Amerikës. *Masakra e Sheshit Tienanmen në regjistrimet e Zërit të Amerikës*. <https://www.zeriamerikes.com/a/7643965.html>. Gjetur më 15 qershor 2024.

KAPITULLI II

TË DREJTAT: TË DISH, TË USHTROSH, TË KËRKOSH

Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. ***Arsimi dhe e drejta për t'u arsimuar nën lupën e Gjykatës së Strasburgut***

Valbona Nathanaili

Të Drejtat e Njeriut. Koncepte

Klasifikimi sipas dokumenteve

Klasifikimi bazuar në zhvillimet historike: Tre gjeneratat e të drejtave

Klasifikime të tjera

Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut

E Drejta për Arsim dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

1976: Kjeldsen, Busk Madsen dhe Pedersen vs shtetit të Danimarkës

1982: Campbell dhe Cosans v. Mbretërisë së Bashkuar (European Court of Human Rights, 1982)

2016: Qeveria daneze dhe projektligji për mishin e derrit

2017: Forumi i të Rinjve Europianë dhe shfrytëzimi i stazhierëve në tregun e punës

2022: Çështja X dhe të tjerët kundër Shqipërisë

Referenca

Bojkoti - Rrugëtimi i një lëvizje që pushtoi gjithë botën

Valbona Nathanaili

Abstrakt

1880 Termi bojkot dhe lindja e një forme të re proteste

Çfarë është bojkoti?

1955: Bojkoti i shërbimit urban në Montgomery, Albama, SHBA

1980: Bojkoti i Lojërave Olimpikë Verore, organizuar në Moskë

1990: Puna e fëmijëve në prodhimin e qilimave në Indi dhe bojkoti ndaj prodhimeve të tyre

Kultura e bojkotit në Shqipëri

1990 Bojkoti i studentëve të Universitetit të Tiranës

1991 Bojkoti i grupit parlamentar të Partisë Demokratike të seancës së parë të Kuvendit Popullor shumë partiak

2023 Bojkoti i studentëve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë

Referenca

Protesta si shprehje e të drejtave dhe solidaritetit

Një reflektim mbi nevojën për aktivizëm në Shqipëri

Nevila Sokoli Xhindi

Dhuna kundër grave dhe qasja e teorisë feministe

Miribana Hoti, Rajmonda Mena / Udhëhoqi: Valbona Nathanaili

Abstrakt

Hyrje

Dhuna kundër grave: statistika dhe pasoja

Teoria feministe

Konkluzione

Referenca

Nga Shqipëria në Itali: rënia dhe ngritja e një gruaje

Valbona Nathanaili

Abstrakt

Hyrje

Nga Shqipëria në Itali: Historia e E.S., e mbijetuar e dhunës familjare

Përshkrimi i rastit

Metodologjia

Intervista e M. R. me E.S.

Situata e dhunës në familje në shtetin italian

Konkluzione

Referenca

ÇFARË ËSHTË DEMOKRACIA?

KONVENTA EVROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

*Arsimi dhe e drejta për t'u arsimuar nën lupën e Gjykatës së
Strasburgut*

Edhe pse flasim për të drejtat e njeriut, sillemi me to si me një produkt, të cilin e konsumojmë në mënyrë pasive, pa marrë pjesë në prodhimin e tij. Në rrjedhojë, krijojmë varësi ndaj atyre që e prodhojnë dhe atyre që e na e shesin, dhe jemi krejtësisht të paditur në mënyrën se si funksionon; pranojmë të udhëhiqemi nga të drejtat e njeriut, por nuk kërkojmë prova nga ata që u kemi dhënë autoritetin t'i zbatojnë...

Klaus Günther: "From a gubernative to a deliberative human rights policy definition, and further development of human rights as an act of collective self-determination" (2011)

TË DREJTAT E NJERIUT – KONCEPTE

Në SHBA, racizmi ka stigmatizuar, në mënyrë të jashtëzakonshme, aftësitë dhe mundësitë e të zinjve. Pesë shekuj skllavëri dhe shtypje për komunitetin e të zinjve në SHBA, të drejta të tilla, si e drejta e jetës, si një e drejtë e pandashme nga njeriu, mos ushtrimi i torturës ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor dhe degradues, askush nuk mund të mbahet në skllavëri, asnjëri nuk mund të detyrohet të bëjë një punë të imponuar (me përjashtim të dënimeve të dhëna nga gjykata), e drejta e lirisë dhe e sigurisë kanë qenë të panjohura.

Më 1946, Presidenti i SHBA, Harry Truman, krijon "Komitetin për të Drejtat Civile". Komiteti kishte detyrë të merrte në analizë të drejtat civile në SHBA. Një vit më vonë, në një nga raportet e komitetit, konstatohet se vetëm për periudhën

1943-1944, 81% e padive në gjykata kishin si objekt diskriminimin në vendin e punës bazuar në racë, nga të cilët 97 % e paditësve ishin afro-amerikanë. Akoma, raporti tregonte se shkalla e papunësisë për të zinjët, pothuaj në çdo qytet të madh të SHBA, ishte dy herë më e madhe krahasuar me të bardhët (Deibel, 2019: f. 44). Më shumë se 60 vjet më vonë, në Tunizi, pothuaj në anën tjetër të botës, më 17 dhjetor 2010, Muhamed Bouasisi, një i ri tunizian i papunë, i vë flakën vetes, në shenjë proteste ndaj situatës dëshpëruese të të drejtave të njeriut, ndërkohë që regjimi promovonte imazhin e një vendi të lumtur, dhe ku shqetësimi i fundit për njerëzit ishin ekonomia dhe mirëqenia (Marzouki, 2015).

Të drejtat e njeriut janë ato të drejta që i takojnë një njeriu, pikërisht për faktin që ai është njeri, dhe si i tillë ka nevoja. Të drejtat e kanë pikënisjen në nevojat tona të natyrshme për të jetuar si qenie njerëzore dhe me dinjitet, për t'u zhvilluar dhe për të mbrojtur çdo arritje të shënuar më parë. Hapi i parë në përcaktimin e të drejtave është identifikimi i situatës reale të përmbushjes së nevojave të njeriut, dhe vazhdon me përcaktimin e standardeve të të drejtave; procesi mbyllet me hartimin dhe dekretimin e akteve me fuqi juridike dhe administrative në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Me hartimin e dokumenteve ligjore dhe nënligjore, nevojat institucionalizohen si të drejta të njeriut, në kuptimin që për plotësimin e këtyre nevojave shoqëria merr përgjegjësitë e veta, së bashku me vetë njerëzit që marrin përgjegjësitë e tyre ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe shtetit.

Për të konkretizuar raportin ndërmjet nevojave, situatës, standardeve dhe të drejtave, mund t'i referohemi një shembulli.

Shembull

Nevoja: Fëmija ka të drejtën për të mbijetuar. Për këtë, duhet të mbrohet jeta e fëmijëve dhe ata duhet të kenë ushqim të mjaftueshëm, veshje, banesë dhe përkujdesjen e nevojshme mjekësore.

Situata: Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë¹, në shkallë globale, në vitin 2020, vdekshmëria tek fëmijët, nën moshën 5 vjeç, ka qenë rreth 5 milionë, kryesisht nga shkaqe të parandalueshme dhe të trajtueshme. Përafërsisht gjysma e këtyre vdekjeve, 2.4 milionë, ndodhën tek të sapolindurit (në 28 ditët e para të jetës). Sëmundjet infektive, përfshirë pneumoninë, diarrenë dhe malarien mbeten shkaku kryesor i vdekjeve nën moshën pesë vjeç, së bashku me lindjen e parakohshme dhe komplikimet e lidhura me shtatzëninë.

1 Për më shumë: <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/levels-and-trends-in-child-under-5-mortality-in-2020>

Ndërsa shkalla globale e vdekshmërisë nën 5 vjeç ka rënë në 37 vdekje/1000 lindje të gjalla në vitin 2020, fëmijët në zonën e Saharës vazhduan të kenë shkallën më të lartë të vdekshmërisë në botë me 74 vdekje /1000 lindje të gjalla - 14 herë më e lartë se rreziku për fëmijët në Evropë dhe në Amerikën e Veriut.

Në vitin 2021 në Shqipëri shifrat varionin nga 8.7-10.2 vdekje /1000 lindje të gjalla.

Standardi: Asnjë fëmijë nuk duhet të vdesë.²

Të drejtat: Në Konventën e të Drejtave të Fëmijës është shpallur e drejta e fëmijës për mbijetesë, për përkujdesje shëndetësore, për trajtim jo mizor, për përkujdesjen dhe për përgjegjësinë e prindërve, për mos-trafikimin e fëmijëve, për mos përfshirjen e tyre në konfliktet e armatosura etj. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është vendosur e drejta e fëmijës për përkujdesje të veçantë nga shteti.

Sa më të ndërgjegjshëm të jemi për të drejtat e njeriut, aq më të thjeshtë e kemi të përballemi me problematikat sociale dhe politike. Të drejtat e njeriut janë të drejtat e individit dhe janë po aq të larmishme sa edhe nevojat e tij. Nga ana tjetër, plotësimi i nevojave të njeriut nuk është përgjegjësi vetëm e individit, por edhe e shoqërisë në të cilën ai/ajo jeton. Individit ka të drejtë të kërkojë nga shteti përmbushjen e atyre nevojave që i klasifikon si më prioritare, që do të thotë se klasifikimi i nevojave dhe klasifikimi i të drejtave duhet të jenë në koherencë me njëra-tjetrën: nevojat më prioritare janë edhe të drejtat më prioritare. Nëse një njeri nuk ka ushqim, veshje dhe banesë, shteti ka për detyrë t'i krijojë mundësinë që t'i përmbushë këto nevoja në mënyrën më urgjente dhe përbëjnë në të njëjtën kohë edhe të drejtat themelore të tij.

Gjashtë kategoritë e të drejtave, të pranura në shkallë ndërkombëtare janë:

1. të drejtat civile (qytetare)
2. të drejtat politike
3. të drejtat ekonomike
4. të drejtat sociale
5. të drejtat kulturore
6. të drejtat e solidaritetit.

2 *Shënim:* Standardi është një model, sistem referimi ose marrëveshje e përgjithshme, për të cilën kemi rënë dakord të gjithë.

Ndërsa terminologjia e kategorive është zyrtare dhe ndërkombëtare, grupimi e të drejtave në kategori nuk është zyrtar, por është një instrument i mirë për ta bërë analizën më gjithëpërfshirëse. Nga ana tjetër, duhet theksuar se këto të drejta, si dhe nën-ndarjet për secilën prej tyre, nuk kanë kufij statistikë.

KLASIFIKIMI SIPAS DOKUMENTEVE

Të drejtat mund të grupohen sipas dokumenteve, domethënë si një bashkësi të drejtash që përmbahen në një dokument të dhënë. Grupimi më i gjerë i të drejtave të njeriut është Karta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut. Kjo Kartë është bashkësia e dokumenteve të mëposhtme:

1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e shpallur nga Kombet e Bashkuara në vitin 1948.
2. Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, shpallur në vitin 1966, hyrë në fuqi në vitin 1976, si dhe protokollet fakultative të këtij Pakti.
3. Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike, shpallur në vitin 1966, hyrë në fuqi në vitin 1976, si dhe protokollet fakultative të këtij Pakti.

Ekzistojnë edhe shumë dokumente të tjerë ndërkombëtarë që emërtohen si Deklarata ose Konventa, domethënë marrëveshje (anglisht dhe frëngjisht: Convention), si edhe dokumente me shtrirje rajonale (për shembull vetëm në Europë, Afrikë apo Amerikë) që grupojnë të drejta të ndryshme, si ato për të drejtat politike të gruas, të drejtat e fëmijës, ato për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial, për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit, për mos diskriminimin e grave, për minoritetet, për refugjatët, dokumente për ndalimin e torturave etj.

Nga tipat e ndryshme të instrumenteve ndërkombëtare vetëm Konventat, Paktet dhe Protokollet Shtesë të tyre kanë forcë detyruese për shtetet, në kuptimin që shtetet ratifikuese duhet të nxjerrin ligjet e brendshme për zbatim, ndërsa të tjerat, ndonëse nuk kanë forcë detyruese ligjore, ndikojnë në formësimin e opinionit publik në rrafsh parimor.

KLASIFIKIMI BAZUAR NË ZHVILLIMET HISTORIKE: TRE GJENERATAT E TË DREJTAVE

Një tjetër klasifikim i të drejtave është ai bazuar në zhvillimet historike të luftës dhe përpjekjeve për të drejtat e njeriut. Sipas këtij klasifikimi të ri, kemi tre gjenerata të të drejtave të njeriut (Compas, 2024):

- Gjenerata e parë: Të drejtat civile dhe politike
- Gjenerata e dytë: Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore
- Gjenerata e tretë: Të drejtat e solidaritetit

Gjenerata e parë e të drejtave të njeriut pasqyron traditën e lirisë (*liberté*), gjenerata e dytë e të drejtat të njeriut, të drejtat ekonomike sociale dhe kulturore përputhen me traditën e barazisë (*égalité*), ndërsa të drejtat e gjeneratës së tretë kanë të bëjnë me vëllazërinë (*fraternité*) pararendës i solidaritetit. Të drejtat e solidaritetit u zhvilluan në rrjedhojë të faktit se gjeneratat e mëparshme të të drejtave të njeriut u konsideruan jo sa duhet dinamike dhe fleksibël për t'iu përgjigjur sfidave aktuale që kalon bota dhe shoqëria.³

Megjithatë, sikundër e kemi theksuar, të flasësh për kategori të të drejtave të njeriut është thjesht për efekt studimi, sepse në fakt këto të drejta, pavarësisht emërimit apo gjeneratës ku klasifikohen, janë zhvilluar njëkohësisht. Nga pikëpamja konceptuale është e dobishme të kategorizohen të drejtat e njeriut sipas shtyllave themelore të filozofisë politike – liria, barazia dhe solidariteti.

Sipas Jauslin (2024), marrëdhënia ndërmjet solidaritetit dhe të drejtave të njeriut mund të përshkruhet si një martesë e vështirë, por me një potencial të madh:

Të dy konceptet rrjedhin nga tradita të ndryshme filozofike dhe kanë struktura të ndryshme normative. Megjithatë, pavarësisht kontradiktave dhe tensioneve të caktuara, ekziston një potencial i madh për të gjetur pajtimin e dy koncepteve. Nga njëra anë, të drejtat e njeriut bazuar në solidaritet parandalojnë një qasje joliberales dhe totalitare të tyre, në gjendje të rrezikojnë legjitimitetin e pothuaj çdo gjëje në emër të interesave të komunitetit; nga ana tjetër, konceptimi i të drejtave të njeriut që është i informuar nga parimi i solidaritetit i merr seriozisht pengesat strukturore dhe institucionale.

3 Për më shumë shih: *ESIL Reflection – Solidarity and Human Rights – A difficult marriage with great potential* <https://esil-sedi.eu/esil-reflection-solidarity-and-human-rights-a-difficult-marriage-with-great-potential/> Gjetur më 1 nëntor 2024.

Po sipas Jauslin (2024), të drejtat e solidaritetit të gjeneratës së tretë kanë këto karakteristika:

1. komponenten kolektive, pavarësisht nëse kjo i referohet të drejtave kolektive, ose kërkesës që shtetet e ndryshme të bashkëpunojnë për të arritur një të drejtë.
2. dimensionin institucional, domethënë nuk kanë të bëjnë me garantimin e lirive, mbrojtjen apo një shërbim specifik, por kërkojnë një natyrë të caktuar nga rendi ndërkombëtar; kanë të bëjnë me kuadrin institucional të sistemit politik ndërkombëtar.
3. marrin formën e të drejtave realizuese: janë të drejta që kërkojnë arritjen praktike të të drejtave të njeriut dhe nuk kënaqen me garanci të thjeshta formale.

KLASIFIKIME TË TJERA

Të drejta:

- Individuale ose kolektive
- Të personit
- Të formuluar në mënyrë pozitive ose negative
- Me shkallë të ndryshme prioriteti
- Kategori

Të drejta individuale janë, për shembull, e drejta e jetës, e lirisë, e sigurisë, e lëvizjes, e mendimit, e shprehjes së opinionëve, e shtetësisë, e ndërgjegjes, e fesë, e mos-skllavërisë, e zgjedhjes së punës, e strehimit, e mbrojtjes së shëndetit, e mjedisit të përshtatshëm, e votës, e zgjedhësit dhe e të zgjedhurit etj.

Të drejta kolektive janë ato të drejta të njeriut që ai i përfton nëpërmjet grupimeve sociale ku bën pjesë me vullnetin e tij të lirë, si për shembull, e drejta e pronës kolektive, të drejtat e shoqatës, të drejtat e familjes, të drejtat e minoritetit etj.

Një klasë tjetër të drejtash përbëjnë të ashtuquajturat të drejta të personit, që i përftojnë në mënyrë të posaçme disa njerëz, për shkak të një ose disa veçorive në krahasim me të tjerët, si për shembull të drejtat e fëmijës, të refugjatëve politikë, të burgosurve, të arrestuarve, të nxënësve të arsimit para-universitar, të studentëve, të minatorëve etj. Sigurisht që këta persona përftojnë edhe të gjitha të drejtat që u takojnë si qenie njerëzore. Duhet theksuar se Konventa për të Drejtat e Fëmijës

është i vetmi dokument në të cilin nuk janë përfshirë vetëm të drejtat e veçanta të personit (në rastin tonë, të fëmijës), por edhe të drejtat e tij si qenie njerëzore.

Sipas një klasifikimi tjetër, të drejtat për nga mënyra e formulimit mund të jenë pozitive ose negative. Të drejtat pozitive janë ato që shprehen në mënyrë pohuese, pra që përshkruajnë të drejtat të cilat njeriu jo vetëm që i përfiton për veten e tij, por që është i detyruar t'ua respektojë edhe të tjerëve. Si shembull për këtë, mund të marrim nenin 3 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut: “Çdo individ ka të drejtën e jetës, të lirisë dhe të sigurisë së personit të vet”.

Në mënyrë të shkurtër, të drejtat pozitive shprehen si “PO” për vete dhe “PO” për të tjerët.

Të drejtat negative tregojnë se çfarë nuk kanë të drejtë të bëjnë të tjerët mbi një njeri, e cila është po ajo gjë, që asnjë njeri nuk ka të drejtë ta ushtrojë mbi të tjerët. Kur formulohen, këto të drejta fillojnë me fjalët: askush nuk..., ose askujt nuk..., ose asnjëri nuk..., si për shembull:

- Askush nuk mund të mbahet në skllavëri, as në robëri (pika 1, Neni 4, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut)⁴
- Askush nuk mund të shtrëngohet për të kryer një punë të detyruar ose të detyrueshme (pika 2, Neni 4, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut)
- Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, veprimi ose dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues (Neni 5, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut)⁵
- Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet arbitrarisht arrestimit, ndalimit ose dëbimit (Neni 9, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut)

Ka raste që për të njëjtin objekt të formulohen në të njëjtin nen edhe të drejta pozitive edhe negative, si për shembull:

- Gjithkush ka të drejtën të ketë pasuri, si vetëm ashtu edhe në bashkëpronësi me të tjerët. Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij (Pikat 1 dhe 2 të Neni 17, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut).

Një klasifikim tjetër u bëhet të drejtave sipas prioriteteve të nevojave dhe dëshirave që ka çdo njeri në jetën e tij. Ky lloj klasifikimi përdoret shumë në veprimtaritë e ndryshme për formimin e njerëzve në fushën e të drejtave. Rënditja

4 Këshilli i Evropës dhe Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (2014). *Udhëzues rreth nenit 4 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut*. https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks/guide_art_4_alb Gjetur më 3 nëntor 2024.

5 Përmbledhëse ligjore e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale (2013). https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/permbledhese_ligjore_e_perditesuar_2013_563_1.pdf Gjetur më 3 nëntor 2024.

e prioriteteve është shumë relative, çka është në logjikën e doktrinës së të drejtave. Zakonisht njerëzit shënojnë si më të kërkuarat ato të drejta që u mungojnë.

KONVENTA EVROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut u përfundua në Romë, më 4 nëntor 1950 dhe u nënshkrua nga dhjetë qeveritë pjesëmarrëse. Bazë ligjore e krijimit ka qenë Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1948.

Konventa ka hyrë në fuqi më 3 shtator 1953 dhe që nga ai vit është kthyer në një nga traktatet më të forta dhe më efektive në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Konventa ka 14 protokolle. Nëpërmjet kësaj Konvente, shtetet anëtare të Këshillit të Evropës angazhohen të garantojnë disa të drejta themelore njerëzore për të gjithë personat që janë nën juridiksionin e tyre. Konventa garanton disa nga të drejtat themelore të njeriut, si e drejta për jetë, e drejta e lirisë dhe e sigurisë individuale, të gjithë janë të mbrojtur nga tortura, është e ndaluar skllavëria dhe askush nuk mund të kryejë punë skllavërie, çdo njeri ka të drejtën e një procesi gjyqësor të drejtë dhe publik, çdo njeri ka të drejtë për respektimin e jetës së tij private dhe familjare, e drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, e drejta e lirisë së shprehjes, e drejta e lirisë së tubimit paqësor dhe bashkimit, e drejta e martesës dhe krijimit të familjes.

Rëndësia e Konventës qëndron edhe në faktin se shoqërohet me një mekanizëm mbrojtës, ngritur në Strasburg, me synim hetimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe vënien e fajtorëve përpara përgjegjësisë: Gjykatën për të Drejtat e Njeriut, krijuar më 21.01.1950, në Strasburg. Gjykata pas vitit 1998, në bazë të Protokollit nr. 11, është reformuar dhe që nga atëherë njihet si Gjykata e Re për të Drejtat e Njeriut dhe në këtë formë funksionon edhe sot (Instituti Gjyqësor i Kosovës, 2016 :12). Mekanizmat e mbrojtjes funksionojnë në dy mënyra: 1. Çdo Shtet Palë ka të drejtë të ankohet pranë Komisionit Evropian, nëse mendon se një Shtet tjetër Palë nuk i përmbush detyrimet e tij në bazë të Konventës. 2. Çdo individ mund t'i drejtohet drejtpërsëdrejti këtij Komisioni, me një ankesë kundrejt një Shteti që është Palë (*Shënim:* Shtet Palë është çdo shtet që ka bërë një deklaratë të posaçme, me anën e së cilës njeh kompetencën e Komisionit në këtë fushë; të gjithë Shtetet e kanë bërë një deklaratë të tillë). Komisioni Evropian ose Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut merr vendimin nëse e pranon çështjen për shqyrtim ose jo. Për herë të parë

individët mund t'i drejtohen një gjykate ndërkombëtare dhe i bën shtetet përgjegjëse për shkeljet e detyrimeve të tyre ndërkombëtare (Gruda, 2010: 53)

Shqipëria e ka ratifikuar Konventën me Ligjin Nr. 8317, datë 31.7.1996, dhe më pas edhe disa protokolle shtesë të saj. Nëpërmjet të njëjtit ligj, njihet Kompetenca e Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut, për të pranuar peticione nga çdo person, organizatë jo-qeveritare apo grup personash, që pretendojnë të jenë viktimat të një shkelje të të drejtave të garantuara në Konventën për “Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të tij” në Shqipëri.

Në Konventën Evropiane për “Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të tij”, paragrafët për arsimin formulohen në Kapitulli 14, nën titullin “E drejta për arsim”, Protokolli Nr. 1. neni 2, ku pohohet: “Asnjë personi nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e çdo funksionin që lidhet me arsimimin dhe mësimdhënien, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar atë lloj arsimi dhe edukimi që është në përputhje me bindjet e tyre filozofike dhe fetare”.

Në fjalinë e parë, neni parashikon se shteti nuk i mohon askujt të drejtën për arsim. Kjo do të thotë se shteti nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin nga një person të së drejtës për arsim, për shembull duke e ndaluar të shfrytëzojë mundësitë për arsim ofruar nga shteti. Fjala e dytë e nenit parashtron dy elemente të së drejtës për arsim, që më poshtë paraqiten bazuar në interpretimin e Gomien (2000):

1. Së pari, i jep kompetenca të plota shtetit të përcaktojë natyrën dhe fushën e veprimit të angazhimit të tij në arsim dhe mësimdhënie. Në përgjithësi, kjo do të thotë se shteti nuk ka asnjë detyrim të sigurojë disa lloj mundësish për arsim ose të garantojë që çdo individ të marrë arsimin që dëshiron.
2. Së dyti, u garanton të drejtën prindërve që t'u respektohen bindjet në lidhje me arsimin e fëmijëve të tyre.

E DREJTA PËR ARSIM DHE GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Prej shekujsh, arsimi, nga një përparësi për individin është shndërruar në një sipërmarrje të detyrueshme dhe gjithëpërfshirëse që duhet ndjekur nga shoqëria dhe mësuesit (Zogla, 2019: 83). Kultura për t'iu drejtuar gjykatave për çështje që kanë lidhje me arsimin dhe të drejtën për arsim ndryshon nga vendi në vend, por këtu është e rëndësishme të theksohet që në fillim se e drejta për arsim është pjesë e të drejtave të njeriut dhe duhet vlerësuar si e lidhur ngushtësisht me dinjitetin

njerëzor. Akoma, e drejta për arsim është shembulli më i mirë për të ilustruar pohimin se “klasifikimi i të drejtave nuk ka kufij statikë”: e drejta për arsim është e drejtë ekonomike, sociale dhe kulturore (Beiter, 2006: 47).

Më poshtë paraqiten disa raste, kur individë të veçantë ose në grupe i janë drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me të vetmin pretendim: shteti nuk u ka siguruar fëmijëve të tyre shkollimin e përshtatshëm, si dhe një rast kur paditësi i drejtohet Komitetit Evropian për të Drejtat Sociale. Rastet janë paraqitur në mënyrë kronologjike, së bashku me arsyetimin e bërë nga Gjykata dhe Komiteti, si dhe vendimet e tyre; si burim kryesor kanë shërbyer faqet zyrtare të institucioneve; materialet e gjetura janë përkthyer dhe përmbledhur për synimet e këtij artikulli dhe të gjithë librit në përgjithësi: nxitje dhe ndërgjegjësim për sa më shumë kulturë demokratike; kur ka qenë e mundur është pasqyruar edhe vëmendja që rasti ka gjetur në media.

1976: Kjeldsen, Busk Madsen dhe Pedersen vs shtetit të Danimarkës

Konteksti: Shteti i Danimarkës ka bërë pjesë të kurrikulës orën e edukimit seksual, orë e detyrueshme për t'u ndjekur nga të gjithë. Ky ndryshim në kurrikul është aprovuar sipas të gjitha procedurave të rregullta. Krahas riorganizimit të kurrikulës janë përshtatur edhe disa rregulla apo marrëveshje të caktuara:

Gjatë dhënies së kësaj ore mësimi: 1. nuk duhet të ketë pornografi; 2. mësuesi nuk mund ta zhvillojë këtë lëndë duke qenë vetëm me nxënësin; 3. mësuesi nuk mund të jap informacion për metoda të ndryshme të kryerjes së marrëdhënieve seksuale; 4. mësuesi duhet të ketë kujdes me fjalorin, duke mënjanuar përdorimin e fjalëve vulgare.

(Nathanaili, 2017: 57)

Të pakënaqur me këto kufizime, prindërit e disa fëmijëve të një shkolle fillore shtetërore, pretendojnë se fëmijët e tyre nuk ishin krejtësisht të mbrojtur dhe të sigurt gjatë zhvillimit të mësimi të “edukatës seksuale”. Prindërit hartojnë një peticion, ku kërkojnë që fëmijët e tyre të mos e ndjekin këtë orë mësimi, që refuzohet nga drejtoria e shkollës. Rrugëzgjidhja që gjejnë prindërit është largimi i fëmijëve nga shkolla dhe drejtimi në Gjykatën Evropiane.

Neni 76 (Kreu VIII) i Kushtetutës së Danimarkës shprehet se:

Të gjithë fëmijët e moshës shkollore kanë të drejtë mësimi falas në shkollat fillore. Prindërit ose kujdestarët duhet të marrin masat e duhura për fëmijët e tyre ose ata që kanë nën kujdestari të marrin mësimet ekuivalente me shkollën fillore të përgjithshme, një standard që nuk është i detyruar për t'u zbatuar kur fëmijët e tyre ose ata që kanë nën kujdestari ndjekin një shkollë publike.

Neni 2 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, shprehet:

Asnjë personi nuk mund t'i mohohet e drejta e për arsim. Shteti, në ushtrimin e çdo funksioni që lidhet me arsimin dhe mësimdhënien, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë lloj arsimi dhe edukimi në përputhje me bindjet e tyre filozofike dhe fetare.

Procesi: Pretenduesit argumentonin se qeveria daneze kishte shkelur nenin 2 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, duke refuzuar përjashtimin e fëmijëve të pretenduesve nga mësimet e detyrueshme të edukatës seksuale në shkollë.

Shteti argumentonte se neni 2 lidhet vetëm me mësimet fetare dhe jo me të gjitha format e mësimin, sikundër ishte rasti i mësimin të edukatës seksuale.

Rezultati i rastit: Më 7 dhjetor 1976, Gjykata shprehet se çdo mësimdhënie duhet të respektojë bindjet morale dhe fetare të prindërve, duke vazhduar se Shteti "duhet të tregojë kujdes që informacioni ose dijet e transmetuara dhe të përfshira në kurrikul të jenë të përcjella me objektivitet, në mënyrë kritike dhe pluraliste; shteti ndalohej të ndjekë synimin e çdo lloj indoktrinimi që mund të konsiderohet si mungesë respekti ndaj bindjeve fetare apo morale të prindërve". Për shembull, neni 2 mund të thuhet se është shkelur, nëse gjatë përcjelljes së lëndës së edukatës seksuale tek fëmijët, mësuesi e mbështet zhvillimin e saj duke manifestuar ndonjë lloj të veçantë sjelljeje seksuale apo e zhvillon në një moshë të ndryshme nga ajo e përcaktuar nga shkolla.

Sidoqoftë, mësimet për edukatën seksuale, të cilat legjislacioni i lejon të përcillen tek nxënësit, nuk kanë ndonjë sasi indoktrinomi apo mbrojtje të ndonjë lloji të veçantë sjelljeje seksuale. Për më tepër, prindërit kanë të drejtën të edukojnë fëmijët e tyre në shtëpi me ato bindje morale dhe fetare që mendojnë se janë më të mirat për ta. Për rrjedhojë, përcjellja e edukimit seksual në vetvete nuk përbën shkelje të nenit 2.

Arsyetim: Bindjet morale dhe filozofike të prindërve të përfshirë në këtë rast nuk janë në kundërshtim, në gjithçka, me ato të shkollës. Situata bëhet shumë më komplekse kur besimet fetare të prindërve janë në kundërshtim të plotë me ato që mësohen në shkolla, si për shembull kur fëmijët ndjekin shkolla fetare.

1982: Campbell dhe Cosans v. Mbretërisë së Bashkuar (European Court of Human Rights, 1982).

Dy mama skoceze, znj. Grace Campbell dhe znj. Jane Cosans, nga Mbretëria e Bashkuar i drejtohen Gjykatës Evropiane me pretendimin se ndëshkimi trupor që përdoret në shkollat ku mësojnë djemtë e tyre është në kundërshtim me nenin 3 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër torturës dhe trajtimeve ose ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese⁶.

Në fillim, Gjykata shqyrtoi argumentimin e qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, se funksionet që lidheshin me administrimin e brendshëm të shkollave nuk ishin funksione që lidheshin me “arsimimin dhe mësimdhënien”, sipas kuptimit të Nenit 2, Protokollit 1, duke argumentuar se:

Edukimi i fëmijëve është tërësia e mënyrave me të cilat në çdo shoqëri, të rriturit përpigjen t’u transmetojnë më të rinjve kulturën, bindjet dhe vlera të tjera, ndërsa mësimi ose shkollimi i referohet transmetimit të njohurive dhe zhvillimit intelektual...

Në një kuptim mund të thuhet se përdorimi i ndëshkimit fizik i përket administrimit të një shkolle, por në të njëjtën kohë kur përdoret, është pjesë përbërëse e procesit, me anën e të cilit shkollla kërkon të arrijë objektivin për të cilin është krijuar, duke përfshirë zhvillimin dhe formimin e karakterit dhe të kapacitetit mendor të nxënësve të saj.

(Gomien, 2000: 134)

Më pas Gjykata shqyrton natyrën e bindjeve filozofike të prindërve:

Duke pasur në konsideratë Konventën në tërësi, shprehja “bindje filozofike”, në kontekstin aktual, sipas mendimit të Gjykatës, ka kuptimin bindje të tilla që meritojnë respekt në një “shoqëri demokratike” ... dhe nuk janë të papajtueshme me dinjitetin njerëzor; krahas kësaj, ato nuk duhet të jenë në konflikt me të drejtën themelore për arsim të fëmijës, ku i gjithë neni 2 mbizotërohet nga fjalia e tij e parë... Pikëpamjet e aplikantëve kanë lidhje me një aspekt të rëndësishëm dhe me peshë të jetës dhe të sjelljes së njeriut, pikërisht me integritetin e personit, legjitimitetin ose mungesën e tij për të kryer ndëshkime fizike dhe evitimin e ankthit që shkakton rreziku i ndëshkimeve të tilla. Janë pikëpamje që i plotësojnë të gjitha kriteret e ndryshme të renditura më lart.

⁶ *Burimi*: United Nations, Human Rights, Office of the High Commission. “Convention against Torture and Other Cruel, Inhuman or Degrading Treatment or Punishment”

Më 25 shkurt 1982, Gjykata Evropiane arrin në përfundimin se Mbretëria e Bashkuar është në kundërshtim me Konventën Evropiane, duke mos respektuar kundërshtimet e prindërve ndaj ndëshkimeve njerëzore që jepeshin në shkollë. Në fakt, asnjëri nga djemtë nuk ishte ndëshkuar fizikisht dhe Gjykata nuk e pranoi deklaratën e ndëshkimit fizik, por arsyetoi se Mbretëria e Bashkuar kishte dështuar në respektimin e të drejtës së prindërve për arsimimin e fëmijëve të tyre, sepse në nenin 2 të protokollit 1 thuhet:

Asnjë personi nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e çdo funksioni që lidhet me arsimimin dhe mësimdhënien, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar atë lloj arsimi dhe edukimi që është në përputhje me bindjet e tyre filozofike dhe fetare.

Jeffrey Cosans, 15 vjeç, ishte përjashtuar nga shkolla sepse kishte refuzuar marrjen e ndëshkimit fizik. Gjykata gjeti se atij i ishte mohuar e drejta për të marrë arsimim. Ky Gjykim, si dhe vendime të tjera marrë nga Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut në favor të aplikimeve bërë nga prindërit dhe fëmijët e tyre në shkolla të ndryshme të Mbretërisë së Bashkuar, bënë që më 1987, në legjislacionin shkollor të këtij vendi të hiqet ndëshkimi trupor për të gjitha shkollat e sistemit publik dhe më shtator 1999 edhe nga shkollat private.

2016: Qeveria daneze dhe projektligji për mishin e derrit

Në vitin 2016, qeveria daneze prezantoi një ligj të ri që kërkon që të gjitha qendrat e kujdesit ditor të shërbejnë mish derri si pjesë e menysë së tyre, në mënyrë që të promovojnë kulturën ushqimore daneze dhe të kundërshtojnë perceptimin se myslimanët nuk janë të gatshëm të integrohen në shoqërinë daneze.

“Në Danimarkë” – shkruan Rick Noack më 20 janar 2016 për “The Washington Post” – “një vend ku ka më shumë derra se sa qenie njerëzore, mishi i derrit është shndërruar në element debati, por që vetëm debat nuk mund të quhet – një luftë kulturash, po! Këtë javë, Këshilli i qytetit Randers ka vendosur që gjithë institucionet publike, përfshirë mensat e kopshteve dhe ato të qendrave të kujdesit ditor për fëmijë, të kenë me detyrim mishin e derrit në meny. Sipas anëtarëve të Këshillit, vendimi është një përpjekje për të ruajtur kulturën dhe identitetin danez, sepse mishi i derrit konsumohet nga pjesa më e madhe e danezëve”.

Për organizatat e të drejtave të njeriut dhe grupet e komunitetit mysliman në vend, vendimi është një shkelje e lirisë fetare, pasi pengon fëmijët myslimanë të

shkojnë në ato qendra që nuk shërbejnë mish derri. Ndonëse ligji nuk shndërrohet në subjekt të ndonjë çështjeje gjyqësore, polemikat dhe kritikrat janë shumta, ku argumenti kryesor bazohet në diskriminim dhe përforcimin e stereotipave negative për myslimanët.

Në përgjigje të kritikave, qeveria daneze amendon ligjin dhe lejon qendrat e kujdesit ditor të shërbejnë alternativa vegjetarianë ndaj mishit të derrit, por çështja mbetet e diskutueshme dhe vazhdon të debatohet në shoqërinë daneze.

2017 Forumi i të Rinjve Evropianë dhe shfrytëzimi i stazhierëve në tregun e punës⁷

Në vitin 2017, Forumi Rinor Evropian ngre një padi kundër Belgjikës, në Komitetin Evropian për të Drejtat Sociale të Evropës, ku pretendon se Belgjika nuk bën sa duhet për të parandaluar shfrytëzimin e stazhierëve në tregun e punës. Ankesa u regjistrua më 11 maj 2017. Baza e ankesës: nenet 4§1 (e drejta për një shpërblim të drejtë) dhe 7§5 (e drejta e fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje) të Kartës Sociale Evropiane të Rishikuar. Sipas Forumit Rinor Evropian, dispozitat në ligjin belg mundësojnë stazhin e papaguar, ndërkohë që mungojnë dispozitat që synojnë ta kufizojnë këtë praktikë.

Rezultati i ankesës ishte, se u njoh zyrtarisht, që Belgjika kishte shkelur Kartën Sociale Evropiane me mungesat në ligje, që mundësonin kryerjen e praktikave të papaguara. Pas shqyrtimit të rastit, Komiteti rekomandon Belgjikën:

- të vazhdojë përpjekjet e deklaruara për të luftuar kundër praktikave të papaguara në bashkëpunim me partnerët socialë dhe aktorë të tjerë;
- në veçanti: të marrë të gjitha masat e nevojshme rregullatore dhe praktike për të siguruar që aktivitetet e inspektimit të punës të përshtaten me situatën e stazhierëve të rinj dhe të pafavorizuar; të adoptojë një qasje proaktive në inspektime, e cila nuk duhet të varet vetëm nga ankesat individuale të stazhierëve të rinj, me qëllim sigurimin e një mënyre efektive që stazhi të mos përdoret për të zëvendësuar punëtorët e rregullt;
- të deklarojë vendimet dhe veprimet e ndërmarra për respektimin e këtij rekomandimi në raportin e radhës për ndjekjen e vendimeve në ankesat kolektive.

⁷ Për më shumë: https://www.coe.int/en/web/european-social-charter/processed-complaints/-/asset_publisher/5GEFkJmH2bYG/content/no-150-2017-european-youth-forum-yfj-v-belgium. Gjetur më 2 nëntor 2024.

Zëvendëskryeministri dhe Ministri Federal i Ekonomisë dhe Punës të Belgjikës takon përfaqësuesit e Forumit Rinor Evropian dhe e vendos çështjen e praktikave të paguara në agjendën e Konferencës Ndërminstrore të Punës të datës 21 mars 2022, ku ndër të tjera u ra dakord:

- të eliminohen mungesat e mundshme në rregullore;
- të përmirësohet zbatueshmëria e rregulloreve dhe të kryhen inspektime më të synuara në këtë fushë;
- institucionet dhe administratat nën juridiksionin e tyre të mos përdorin ose publikojnë reklama për praktika të paguara;
- të zbatohet një fushatë ndërgjegjësuere që synon punëdhënësit nga njëra anë dhe praktikantët e rinj nga ana tjetër, me qëllim tërheqjen e vëmendjes ndaj rregulloreve dhe të drejtave të stazhierëve.

Ky rast shërbeu që Forumi i Rinisë Evropiane të hartojë “Kartën e Cilësisë për Stazhin dhe Praktikën Profesionale” (EYF), si një instrument në ndihmë të politikëbërësve për të zbatuar strategji dhe ndërmarrë nisma më të mira në përputhje me të drejtat e të rinjve dhe një mënyrë për të rinjtë të njohin më mirë të drejtat e tyre në vendin e punës.

2022 Çështja X dhe të tjerët kundër Shqipërisë⁸

Tetëmbëdhjetë shtetas shqiptarë me origjinë etnike rome dhe egjiptiane, të cilët përbëjnë gjashtë familje (“kërkuesit”), padisin qeverinë shqiptare në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut për diskriminim ndaj fëmijëve të tyre, me pretendimin se Qeveria Shqiptare nuk ka zbatuar masa të menjëhershme dhe të detajuara kundër segregimit/veçimit në një shkollë fillore, e cila frekuentohej pothuajse ekskluzivisht nga fëmijë të minoritetit rom dhe egjiptian. Kërkuesit jetojnë në Korçë, një qytet në juglindje të Shqipërisë me 76,000 banorë. Kërkuesit fëmijë ndiqnin të njëjtën shkollë. Kërkuesit përfaqësohen nga Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (“QEDR”), një organizatë joqeveritare, me vendndodhje në Bruksel, Belgjikë.

⁸ *Shënim:* Gjatë shkrimit të këtij artikulli u ftua një përfaqësues i një organizate shqiptare që është marrë me rastin për të bashkëpunuar në shtjellimin e fakteve, por për fat të keq pa përgjigje.

Fakte dhe kronologji: Gjetjet e Qeverisë në lidhje me shkollën “Naim Frashëri”

Sipas të dhënave të qeverisë lokale, gjatë vitit akademik 2018/19, në sistemin e detyruar arsimor të këtij qyteti u regjistruan rreth 1,200 fëmijë romë dhe egjiptianë. Gjatë viteve akademike 2012/19, nxënësit romë dhe egjiptianë në shkollën fillore “Naim Frashëri” në Korçë përbënin rreth 89 deri në 100% të nxënësve në shkollë.

- 2012:** Me synim rritjen e frekuentimit, qeveria fillon zbatimin e një programi me ndihmë ushqimore për fëmijët romë dhe egjiptianë në shkollën fillore “Naim Frashëri”, sipas këtij kushti: fëmijët që ndjekin shkollën, përfitojnë pako me ushqime.
- 2014,** **11 Shtator:** Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (“Komisioneri” ose “Komisioneri kundër Diskriminimit”), i rekomandon Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (“Ministria”) të mbante në konsideratë raportin midis nxënësve romë/egjiptianë dhe të tjerë në shkollë dhe të merrte masa për të shmangur krijimin e shkollave që ndiqeshin vetëm nga nxënësit e këtyre komuniteteve.
- 2015,** **3 korrik:** QEDR paraqet një ankesë pranë Avokatit të Popullit, një institucion i krijuar për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve ndaj autoriteteve publike, me pretendimin se mbi-përfaqësimi i nxënësve romë/egjiptianë në shkollën “Naim Frashëri” krijon veçim. Çështja merret në konsideratë, por opinioni i Ministrisë është se mbi-përfaqësimi në fjalë është pasojë e paqëllimshme e programit për ndihmë ushqimore.
- 2015,** **12 gusht:** Avokati i Popullit i rekomandon Ministrisë të marrë masa proaktive për t’i dhënë fund diskriminimit të nxënësve në fjalë, si dhe të krijojë një mekanizëm për monitorimin e zbatimit të masave kundër segregimit në të gjitha shkollat.
- 2015,** **22 shtator:** Pas një ankese të ngjashme nga QEDR-ja dhe nga një organizatë tjetër, së cilave Ministria iu përgjigj se mbi-përfaqësimi për të cilin drejtohej ankesa ishte i paqëllimshëm, Komisioneri kundër Diskriminimit nxjerr një vendim detyrues, ku konstaton se fëmijët romë dhe egjiptianë në shkollën “Naim Frashëri”, po vuanin diskriminim jo

të drejtpërdrejtë, për shkak të mbi-përfaqësimit të tyre në shkollë; Komisioneri konstaton se vendosja e nxënësve romë në një shkollë të posaçme i veçon dhe nuk lejon integrimin në aktivitetet sociale gjithëpërfshirëse. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë se Ministria ishte organi publik përgjegjës për pranimet në shkollë, Komisioneri thekson se sipas nenit 7(1) të ligjit për mbrojtjen ndaj diskriminimit, si veprimet edhe mosveprimet që kanë shkaktuar një shkelje të barazisë midis personave, mund të sjellin diskriminim. Së fundmi, Komisioneri thekson se në mbështetje të nenit 18(1) të ligjit për mbrojtjen ndaj diskriminimit, Këshilli i Ministrave dhe Ministria kanë detyrimin të marrin masa pozitive kundër diskriminimit lidhur me të drejtën për t'u arsimuar. Në lidhje me sa më sipër, Komisioneri urdhëron Ministrinë të marrë “masa të menjëhershme për përmirësimin e situatës dhe të ndryshojë raportin” midis nxënësve romë/egjiptianë dhe nxënësve të tjerë në shkollë.

- 2015,** **14 dhjetor:** Ministria informon Komisionerin se do të ndërmarrë një sërë masash kundër segregimit në shkollë, përfshirë zgjerimin e programit të ndihmës ushqimore për nxënësit e të gjitha komuniteteve edhe për katër shkolla të tjera në këtë zonë, si edhe bashkimin e shkollës “Naim Frashëri” me tri shkolla lokale.
- 2017,** **22 shkurt:** Qeveria zgjeron programin për mbështetjen ushqimore për të gjithë nxënësit e shkollës “Naim Frashëri” (vendim i Këshillit të Ministrave nr. 132 i po së njëjtës datë).
- 2017,** **14 prill:** Ministria informon QEDR-in se shkolla vijon të frekuentohet pothuajse ekskluzivisht nga nxënës të komunitetit rom dhe egjiptian. Në vijim, Ministria shpjegon se duke qenë se viti akademik ishte në vijim, nuk ishte momenti i duhur që të zbatohesh bashkimi i shkollave të ndryshme, por siguron QEDR-në, se në fillim të vitit të ri akademik, në shtator, segregimi në shkollë do të përfundonte. Gjithashtu, Ministria deklaroi se do t'i kërkonte autoriteteve kompetente të organizonin rinovimin e shkollës.
- 2018-2019:** Punimet për rinovim u realizuan gjatë vitit akademik 2018/19 dhe përfunduan në shtator 2019.
- 2019,** **6 nëntor:** Në vitin akademik 2019/20, nxënësit romë/egjiptianë përbëjnë 90% të nxënësve në shkollën “Naim Frashëri”.

2020, **25 shkurt:** Ministria informon Avokatin e Shtetit se përqindja e nxënësve romë/egjiptianë në shkollë është 60%; akoma, Ministria pohon se bashkimi i shkollës me shkollat e tjera pranë saj nuk ishte realizuar, për shkak të punimeve për rinovimin e shkollës.

Kërkuesit e kundërshtojnë shifrën e mësipërme dhe parashtojnë se në realitet, në shkollën “Naim Frashëri” fillimisht u regjistruan shumë nxënës, që nuk i përkisnin komunitet rom/egjiptian, por më pas ata ndoqën shkollat fqinje.

Zhvillime të tjera: Berat

2015, **16 dhjetor:** Komisioneri nxjerr një vendim, në të cilin konstatohet se shkolla fillore “Avdyl Avdia” në Berat ndiqet ekskluzivisht nga nxënës të komunitetit rom, fakt i cili përbënte diskriminim dhe ishte në kundërshtim me ligjin për mbrojtjen ndaj diskriminimit. Komisioneri i kërkon Ministrisë të marrë masa për transportin dhe frekuentimin e nxënësve të shkollës në një shkollë tjetër pranë shkollës “Avdyl Avdia”.

2017, **14 prill:** Përsëri QEDR kërkon të dhëna; Ministria pohon se shkolla “Avdyl Avdia” është mbyllur në mbështetje të vendimit të Komisionerit, dhe çështja e transportit po adresohet nga bashkia në fjalë.

Vendimi dhe arsyetimi i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

2022, 31 mars, Strasburg: Arsimimi i veçuar u mohon fëmijëve romë dhe atyre jo romë mundësinë për t'u njohur me njëri-tjetrin, dhe për të mësuar se si të jetojnë si qytetarë të barabartë, si dhe i përjashton fëmijët romë nga shoqëria e gjerë që në fillim të jetës së tyre, duke rritur rrezikun që ata të përfshihen në rrethin vicioz të marginalizimit.

Kërkuesit u ankuan në mbështetje të nenit 1 të protokollit nr. 12 të Konventës, të cilët ishin diskriminuar kundrejt së drejtës së tyre për një arsimim përfshirës si rezultat i moszbatimit nga ana e autoriteteve të masave kundër veçimit për

të adresuar mbipërfaqësimin e nxënësve romë/egjiptianë në shkollën “Naim Frashëri”. Neni 1 i protokollit nr. 12 i Konventës parashikon, si më poshtë:

- Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar në ligj do të garantohet pa diskriminim për asnjë nga arsyet, të tilla si: gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinioni politik ose ndonjë opinion tjetër, origjina kombëtare ose sociale, lidhja me një minoritet kombëtar, prona, lindja apo ndonjë status tjetër.
- Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

Protokolli nr. 12 i Konventës u ratifikua nga Shqipëria më 26 nëntor 2004 dhe hyri në fuqi për këtë vend më 1 prill 2005. Shtetet Kontraktuese duhet të parandalojnë ose të rregullojnë shkeljet e pretenduara kundër tyre përpara se këto pretendime të paraqiten në institucionet e Konventës. Thelbi i ankesave të kërkuësve kishte të bënte me dështimin e autoriteteve për t’i dhënë fund veçimit/segregimit të shkollës së tyre. Sipas kësaj situate, qeveria ka ofruar vetëm një mjet, që ofron mundësinë për kompensim financiar, por pa ndaluar vijueshmërinë e shkeljes së pretenduar, gjë e cila nuk mund të konsiderohet si efektive. Gjykata nuk mund të pranojë justifikimin e autoriteteve që bashkimi nuk u zbatua për shkak të rindërtimit të shkollës “Naim Frashëri”, pasi punimet e rindërtimit zgjatën vetëm për një periudhë të kufizuar kohe: në fund të vitit akademik 2019-2020, nxënësit romë/egjiptianë vijonin të përfaqësonin 90% të nxënësve të shkollave. Gjykata e gjykon të arsyeshme që të akordojë 4500 euro për secilën familje të kërkuësve për dëmin jopasuror.

VENDIM

- Neni 1 P12 – Ndalimi i diskriminimit – Moszbatimi i masave të menjëhershme dhe të detajuara kundër segregimit/veçimit në një shkollë fillore, e cila frekuentohet pothuajse ekskluzivisht nga fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian – Asnjë justifikim objektiv dhe i arsyeshëm
- Neni 46 – Masa individuale – Shtetit të paditur i kërkohet që të marrë masa për t’i dhënë fund diskriminimit

REFERENCA

- Beiteer, K. D. (2006). *The Protection of the Right to Education by International Law*. Leiden / Boston: Martinus Nijhoff Publishers.
- European Youth Forum (EYF). *European Quality Charter on Internships and Apprenticeships*. <https://tools.youthforum.org/policy-library/wp-content/uploads-/2022/10/220920-UI-CHARTER-A4.pdf>. Gjetur më 2 nëntor 2024.
- European Court of Human Rights (1982). *Case of Campbell and Cosans v. The United Kingdom*. Judgment. Strasbourg, 25 February 1982 [https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22itemid%22:\[%22001-57455%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22itemid%22:[%22001-57455%22]}) Gjetur më 15 shtator 2024.
- European Court of Human Rights (1982). *Case of Kjeldsen, Busk Madsen and Pedersen v. Denmark*. Judgment. Strasbourg, 7 December 1976.
- Gomien, D. (2000). “Udhëzues i shkurtër i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”. Këshilli i Evropës.
- Gruda, Z. (2010). *Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut*. Prishtinë.
- Günther, K. (2011). From a gubernative to a deliberative human rights policy definition, and further development of human rights as an act of collective self-determination. In *Science and technique of democracy. Definition and development of human rights and popular sovereignty in Europe*. Council of Europe Publishing (ff.35-46).
- Gjykata Kushtetuese. Çështja X dhe të tjerët kundër Shqipërisë (kërkesat nr. 73548/17 dhe 45521/19) https://www.google.com/search?q=%C3%87%C3%ABshtja+X+dhe+t%C3%AB+tjer%C3%ABt+kund%C3%ABr+Shqip%C3%ABris%C3%AB.&oq=%C3%87%C3%ABshtja+X+dhe+t%C3%AB+tjer%C3%ABt+kund%C3%ABr+Shqip%C3%ABris%C3%AB.&gs_lcrp=EgZjaHJvbWUyBggAEEUYOTIHCAEQIRifBdIBCTEzNDdqMGoxNagCC LA-CAQ&sourceid=chrome&ie=UTF-8 Gjetur më 21 tetor 2024
- Instituti Gjyqësor i Kosovës (2016). *Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar*. Prishtinë. <http://jus.igjk.rks-gov.net/767/1/Rendi%20juridik%20dhe%20n%C3%ABrk-omb%C3%ABtar.01.12.2016%20%28Repaired%29.pdf> Gjetur më 10 shtator 2024.
- Jauslin, C. (2024). Solidarity and Human Rights A difficult marriage with great potential. ESIL Reflections. Volume 13, Issue 10
- Nathanaili, V. (2017). *Reforma dhe Legjislacioni. Arsimi parauniversitar: çështje, praktika dhe politika. Rasti shqiptar*. Tiranë: Albanian University Press.

- Noack, R. (2016). In an effort to limit migrant influence, a Danish city wants its residents to eat pork. *Washington Post*, 20 janar 2016. <https://www.washingtonpost.com/news/worldviews/wp/2016/01/20/a-danish-city-wants-its-residents-to-eat-pork-to-defend-the-nation/?postshare=2631453314594895> Gjetur më 14 shtator 2024.
- Parlamenti i Danimarkës, Kushtetuta. <https://www.thedanishparliament.dk/-/media/sites/ft/pdf/publikationer/the-constitutional-act-of-denmark.pdf> Gjetur mw 19 shtator 2024.
- United Nations, Human Rights, office of the High Commission. "Convention against Torture and Other Cruel, Inhuman or Degrading Treatment or Punishment" <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-against-torture-and-other-cruel-inhuman-or-degrading>
- Zogla, I. (2019). Principles of Learner Learning-Centred Didactic in the Context of Technology-Enhanced Learning. Në Daniela, L. (ed.) *Didactics of Smart Pedagogy: Smart Pedagogy for Technology Enhanced Learning*. Springer.

BOJKOTI - RRUGËTIMI I NJË LËVIZJE QË PUSHTOI GJITHË BOTËN

Ka shumë mënyra për të bërë një luftë.

Colin C. Murphy: "Bojkoti" (2012)

ABSTRAKT

Në këtë artikull diskutohet bojkoti, duke u ndalur fillimisht në historinë e lindjes së tij, si një formë e re dhe jo-dhunë e protestës. Në pjesën e parë, në mënyrë kronologjike, analizohen tre raste bojkoteshe, bojkoti i shërbimit urban në Montgomery, Alabama, SHBA (1955), bojkoti i Lojërave Olimpikë Verore të Moskës (1980) dhe bojkoti i blerjes së qilimave indianë prodhuar nga puna e fëmijëve (1990), ndërmarrë në kundërpërgjigje të politikave veçuese dhe denigruese dhe cilësuar si pikë kthese në historinë e të drejtave të njeriut. Në pjesën e dytë, analizohet kultura e bojkotit në Shqipëri dhe më pas fokusi është në dy grupe bojkoteshe që iniciohen e organizohen më shpesh në Shqipërinë e pas viteve 1990: ato organizuar nga studentët dhe ato organizuar nga deputetët në Kuvend, këta të dytë, bëhen pjesë e bojkotit kryesisht kur forca politike që i ka ulur në karrige është në opozitë.

Fjalë çelës: bojkot, histori, protestë, Montgomery, Moskë, Indi, Tiranë.

1880 TERMI BOJKOT DHE LINDJA E NJË FORME TË RE PROTESTE¹

Për të kuptuar më mirë çfarë fshihet pas termit bojkot, na duhet të kthehemi pas në kohë, si dhe të zhvendosemi gjeografikisht. Në fund të viteve 1880, Kapiteni Çarls Kuningham Bojkot merr detyrën e administratorit të tokave të një pronari të madh, në veriperëndim të Irlandës, kontenë Mayo. Duket se Kapiten Bojkoti duhet të ketë qenë shumë i ashpër në shumë aspekte që kërkonte puna, duke u kërkuar me vrazhdësi qiramarrësve të tokave qiranë, si dhe duke zbatuar penalitete të ashpra në të kundërt, në një nga periudhat më të vështira për vendin: prodhimi ishte shumë i varfër. Lordi që kishte në pronësi tokat, që nuk dukej asnjëherë në fakt në zonë, si shumë aristokratë të tjerë të kohës, ishte shumë i pasur – zotëronte afro 17,000 hektarë - por nuk kishte pará. Praktika në atë kohë ishte që toka ndahej në copëza dhe u jepej me qira fermerëve të vegjël, konkretisht banorëve të varfër dhe pa tokë në zotërim. Ata jo vetëm punonin tokën, por jetonin edhe në shtëpitë që zotëroheshin nga i njëjti person. Pra, më shumë se fermerë të pavarur, ishin punëtorë bujqësie. Për fatin e tij të keq, kapiteni e merr detyrën në një periudhë shumë të vështirë marrëdhëniesh ndërmjet zotëruesve të tokës dhe atyre që e punonin atë.

40 vjet pas zisë së famshme të patates në Irlandë², që shkaktoi vdekjen e më shumë se një milion irlandezëve, vendi përjeton një luftë të ashpër e quajtur “lufta për tokën”, që përhapet me shpejtësi në gjithë zonën rurale të Irlandës, dhe shumë shpejt precipiton si një luftë ndërmjet klasës së pronarëve të tokës, zakonisht një shtresë anglo-irlandeze, dhe punëtorëve irlandezë të saj, që jetonin në kushte të tilla prej disa shekujsh. Konteja Mayo ishte një nga më problematiket. Akoma, shumë nga fermerët, në frikën e urisë dhe të varfërisë ekstreme, kishin braktisur punën dhe shumë toka kishin mbetur të shkreta. Nëse kushtet në përgjithësi ishin të këqija, në kontenë Mayo ishin më të këqijat. Këtu na duhet të shtojmë që pjesa më e madhe e këtyre administratorëve ishin ose britanikë, ose të shkolluar në Britani.

Në rastin e kapitenit Bojkot, ai ishte një ish-ushtar anglez, i besimit protestant, ndërsa irlandezët janë kryesisht katolikë. Ndasia fetare në Irlandë ka qenë gjithnjë burim konfliktesh. Historia vazhdon me vendimin për të shkëputur çdo

1 Minda, G. (1999). *Boycott in America: How Imagination and Ideology Shape the Legal Mind*. Southern Illinois University Press, ff. 18-32.

2 *Shënim*: Numri i viktimave të zisë së bukës së vitit 1840 që preku Irlandën, nuk mund të krahasohet me viktimat e asnjë zie buke që ka prekur ndonjë popullsi tjetër kudo në botë, në historinë e shkruar. Zia e bukës u shoqërua me një nivel të lartë emigracioni. Për Amartya Sen (2011: 189), gishti akuzues nuk mund të drejtohet tjetër veçse tek roli që kanë politikatat publike në parandalimin ose jo të zive të bukës dhe në faktorët socialë, politikë dhe kulturorë që i përcaktojnë këto politika.

komunikim me kapitenin Bojkot, si dhe të gjitha marrëdhëniet ekonomike e sociale me të. Një praktikë e tillë ishte përdorur edhe më parë në Irlandë, por asnjëherë kaq e organizuar, sa filloi të njihej si lëvizja e bojkotit të Kapitenit Bojkot. Kapiteni Bojkot fillon ta ndjejë izolimin. Askush nuk dëshiron të blejë produkte bujqësore prej tij. E gjithë beteja për tokën papritmas fokusohet tek një njeri. Për ta ndihmuar, qeveria i dërgon një garnizon ushtarësh, për të bërë atë punë që nuk e bënin më fermerët, por që rezultoi një shkatërrim total, me një kosto shumë herë më të lartë se sa ajo që kërkohej nga fermerët. Ngjarjet tërheqin mediat. Të gjithë ata që identifikoheshin si Kapiteni Bojkot, fjala simbolizonte rrezikun që mund të ndodhte kur në krye vendoseshin njerëz të “paqytetëruar”.

ÇFARË ËSHTË BOJKOTI?

Sipas fjalorit të Gjuhës Shqipe (Thomai *et al*, 2006: 100) bojkoti është:

ndërprerje e lidhjeve me organet shtetërore, me ndonjë organizatë etj., nuk u shërbej më; largohem nga një veprimtari a nuk marr pjesë kur jam i pakënaqur me të; i shmangem diçkaje.

Në këtë përkufizim është e rëndësishme të theksohet, se bojkoti është një formë proteste që nuk e përmban dhunën, ndërkohë që mund të shtohet se është i ngjashëm me strategjinë gandiane për mos-bashkëpunim të “Jo-Dhunës”, një strategji në fakt që e përdor edhe Nelson Mandela (shih: Mandela, 2023). Ndryshe, një metaforë që identifikon instrumentet që mund të përdorin grupe të ndryshëm për t’u mbrojtur nga akte diskriminuese. Në këtë analizë shtjellohen bojkoti i shërbimit urban në Montgomery, Albama, SHBA i vitit 1955, bojkoti i Lojërave Olimpikë Verore organizuar në Moskë i vitit 1980 dhe bojkoti i qilimave prodhuar në Indi, falë punës së fëmijëve të mitur, i vitit 1990, bazuar në një karakteristikë të përbashkët: kanë mundur të ndikojnë dhe ndryshojnë përgjithmonë qasje të menduari dhe praktika të vepruari ku shkeleshin në mënyrë flagrante të drejtat e njeriut.

1955: Bojkoti i shërbimit urban në Montgomery, Albama, SHBA³

1 dhjetori i vitit 1955 është një ditë e veçante për qytetin e Montgomerit, në Alabama, të ShBA-ve, sepse shënon bojkotonin e shërbimit urban. Deri atë ditë,

3 Për më shumë: Kenneth M. Hare (2005). *They Walked to Freedom 1955-1956: The Story of the Montgomery Bus Boycott*. Champaign, Illinois: Montgomery Adviser.

shërbimi urban – bëhet fjalë për përdorimin e autobusëve – ishte i segreguar. Thënë ndryshe, vendet në autobus ishin të ndarë dhe kishin hierarki: vendet e para ishin për të bardhët, ndërsa të fundit, ndarë me një shirit, ishin ato ku mund të uleshin të zinjë. Për më tepër, nëse të bardhët ishin më shumë se vendet në dispozicion për ta, të zinjë duhet të ngriheshin dhe të lironin ndenjës të tyre. Atë pasdite dhjetori, Rosa McCauley Parks, rrobaqepëse, dyzet e dy vjeç, e zezë, ishte ulur në një nga vendet e destinuara për të zinjë. Por në një stacion, pasi hipën një i bardhë dhe shoferi sheh që nuk ka vende bosh, i kërkon znj. Parks të çohet e t'i lirojë vendin. Refuzimi shoqërohet me arrestimin e saj. Veprime të tilla të guximshme kishin ndodhur edhe më parë, por arrestimi i znj. Parks shërbeu si shkëndijë për revolta, falë një pastori, Martin Luter King Junior. Vetëm një ditë më pas, më 5 dhjetor 1955, Martin Luter King Junior mbledh komunitetin dhe të gjithë bashkë vendosin të bojkotojnë shërbimin urban të autobusëve të qytetit. Bojkotin e mbështesin jo vetëm të zinjë. Edhe shumë të bardhë ishin kundër veçimit të të zinjve. Martin Luter King Junior zgjidhet presidenti i Shoqatës për Përmirësimin e Montgomerit. Lind lëvizja për të drejtat civile.

Historia e Rosa McCauley Parks, refuzimi i saj për t'i liruar vendin në autobus një të bardhë dhe kuraja e saj e jashtëzakonshme ndihmojnë ndryshimin përgjithmonë të shoqërisë amerikane (Hare, 2005, f. 16). Më 19 qershor 1956, gjykata federale e Montgomery-t merr vendimin që ndalon segregacionin, por pezullon ekzekutimin, në pritje të një apeli të Gjykatës Supreme të SHBA. Më 1 shkurt 1956, katër gra afro-amerikane, Aurelia S. Browder, Susie McDonald, Claudette Colvin, Mary Louise Smith, dhe Jeanatta Reese (kjo e fundit tërhiqet për shkak të presionit nga jashtë) kishin hedhur në gjyq krye-bashkiakun William A. Gayle, shefin e policisë së qytetit, disa përfaqësues të Bordit të Komisionerëve të “Montgomery City Lines, Inc.” dhe të Komisionit të Shërbimit Publik të Alabamas, si dhe dy shoferë autobusi, për keqtrajtim në linjat e autobusëve të qytetit.

Çështja njihet me emrin “Browder *v.* Gayle” (352 U.S. 903). Avokatët mbrojtës të katër grave janë Fred Grey dhe Charles D. Langford, të cilët vendosin të mos e përfshijnë Rosa Parks në këtë çështje, për të shmangur perceptimin se po mundoheshin ta mbronin nga akuza tjetër. Në fund të fundit, misioni i avokatëve ishte vetëm një: gjykata duhej të vendoste për kushtetutshmërinë e ligjeve që kërkonin segregacionin në autobus!

Për shkak se “Browder *v.* Gayle” kundërshtonte kushtetutshmërinë e një vendimi shtetëror, çështja u soll përpara një paneli prej tre gjyqtarësh të Gjykatës Supreme të SHBA-së. Më 5 qershor 1956, paneli vendos, me shumicë votash, se segregacioni në autobusët e shtetit të Alabamës është jo-kushtetues, duke përmendur “Brown *v.* Bordit të Arsimit” si precedent për vendimin. Martin

Luter King Junior duartroket fitoren, por bën thirrje për vazhdimin e bojkotit të autobusëve të Montgomerit deri në zbatimin e vendimit.

Më 17 dhjetor 1956, Gjykata Supreme hedh poshtë ankesat e qytetit dhe të shtetit për të rishqyrtuar vendimin e tyre; tre ditë më vonë vjen urdhri për autobusët e integruar në Montgomeri. Më 20 dhjetor 1956, Martin Luter King Junior dhe Shoqata për Përmirësimin e Montgomerit votojnë për t'i dhënë fund bojkotit 381-ditor të autobusëve të Montgomerit.

Më 21 dhjetor 1956 në autobusët e Montgomerit nuk ka më segregacion.

1980: Bojkoti i Lojërave Olimpikë Verore, organizuar në Moskë

Në vitin 1980, Shtetet e Bashkuara udhëhoqën një bojkot të Lojërave Olimpikë Verore në Moskë për të protestuar kundër pushtimit sovjetik të Afganistanit në fund të vitit 1979. Iniciativa ishte e Presidentit amerikan të kohës, Jimmy Carter. Sipas Sarantakes (2011: 97), SHBA nuk duhej të dukeshin të dobët në arenën ndërkombëtare. Bojkoti i Lojërave Olimpikë Verore ishte përgjigja e SHBA ndaj pushtimit sovjetik të Afganistanit. Në total, 65 vende refuzuan të merrnin pjesë në lojëra, ndërsa 80 vende dërguan atletë për të garuar. Niveli i konkurrencës vuajti dukshëm nga bojkoti. Skuadra sovjetike fitoi 80 medalje ari dhe gjithsej 195 medalje.

1990: Puna e fëmijëve në prodhimin e qilimave në Indi dhe bojkoti ndaj prodhimeve të tyre

India ka qenë gjithnjë e famshme në industrinë e prodhimit të qilimave dhe tapeteve. Por fuqia punëtore kryesore që përdorte ishin djem të mitur, të paushqyer, që uleshin në stola të vegjël përpara makinerive gjigande dhe endnin qilima me duar e këmbë. Duart e tyre ishin veçanërisht të vlefshme, sepse duke qenë të vogla e të imta, mund të punonin edhe me fije shumë të holla e të dendura. Të ardhurat ishin të jashtëzakonshme, derisa aktivistë të shoqërisë civile ngrenë problemin dhe ndërgjegjësojnë shoqërinë, veçanërisht atë perëndimore e amerikane, se si prodhoheshin.

Falë tryfnisë të këtyre grupeve, në fillim të viteve 1990, blerësit në këto vende bojkotojnë prodhimin. India detyrohet që në prodhimet e këtyre produkteve, të vendosë një etiketë të vogël, ku shkruhej se “Për prodhimin nuk kanë punuar fëmijë” (Harma, 2009: 163), ndërkohë që pranon monitorimin e vazhdueshëm të ndërmarrjeve prodhuese nga institucione kombëtare e ndërkombëtare.

KULTURA E BOJKOTIT NË SHQIPËRI

Bojkoti, si formë e protestës në Shqipëri është me një histori relativisht të shkurtër, që fillon në vitin 1990. Për herë të parë në historinë e Shqipërisë moderne, më 8 dhjetor 1990, studentët e Universitetit të Tiranës, universiteti më i rëndësishëm shtetëror në vend dhe i vetmi në Tiranë, vendosin të bojkotojnë studimet. Në këtë analizë trajtohen bojkoti i studentëve të Universitetit të Tiranës i vitit 1990, bojkoti i grupit parlamentar të Partisë Demokratike të seancës së parë të Kuvendit Popullor shumë-partiak i vitit 1991 dhe bojkoti i studentëve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, i vitit 2023. Nëse bojkotet në Shqipëri do i klasifikojmë bazuar në grupet që i kanë iniciuar, studentët dhe politika i karakterizojnë më së miri, me një element të përbashkët: asnjëri prej tyre nuk ka mundur të krijojë një masë kritike, në gjendje të lindë një lëvizje sociale mbarëkombëtare.

1990 Bojkoti i studentëve të Universitetit të Tiranës

8 dhjetor 1990 Një grup studentësh e pedagogësh të Universitetit të Tiranës – në atë kohë i vetmi universitet në Tiranë - nisin protestat paqësore në Qytetin “Studenti”. Fillimisht bojkotojnë mësimin. Të rinjtë, së bashku me shumë nga pedagogët e tyre, mbledhen në sallën e kinemasë së Qytetit “Studenti”. Shumë prej tyre ngujohen brenda ndërtesave të konvikteve. Kërkesat e para kishin lidhje me ndërprerjen e energjisë elektrike, kushtet e vështira ekonomike që po kalonte vendi në ato momente, si dhe kushtet tepër të vështira në konvikte e në shkolla. Policia reagon ndaj protestuesve duke përdorur edhe dhunë. Pas kësaj studentët shtojnë kërkesat. Tashmë kërkohet dënimi i dhunuesve të studentëve dhe lejimi i pluralizmit. Ngjarjet pasojnë njëra-tjetrën deri në rrëzimin e pushtetit monist.

1991 Bojkoti i grupit parlamentar të Partisë Demokratike të seancës së parë të Kuvendit Popullor shumë partiak

15 prill 1991 Seanca e parë e Kuvendit në Shqipëri planifikohet të mbledhet më 15 prill 1991, pasdite, por opozita, e përbërë nga deputetë të Partisë Demokratike dhe Omonia-s vendosin ta bojkotojnë, duke mos marrë pjesë në seancë. Opozita vendos të dërgojë vetëm një përfaqësues, Neritan Ceka, kryetar i grupit parlamentar të Partisë Demokratike, për të bërë një deklaratë në emër të grupit, nëpërmjet

së cilës kërkon “shtyrjen e mbledhjes së Kuvendit Popullor deri në përcaktimin e fajtorëve për vrasjen e 4 personave dhe plagosjen e 50 të tjerëve në qytetin e Shkodrës”. Ndërsa deputeti Ajli Alushani, duke folur në emër të 2/3 të deputetëve që merrnin pjesë në seancën e parë të këtij kuvendi, deklaroi:

“gjithsecili mund të vendosë vetë të bojkotojë apo të marrë pjesë në një mbledhje, por çështja është se kujt i shërben. Ne mendojmë që bojkotimi i punimeve të Kuvendit nga ana e deputetëve të Partisë Demokratike është një veto politike, që nuk i shërben dialogut demokratik. Çdo deputet vjen në Kuvend jo si i dërguar nga një parti, por si përfaqësues i zgjedhur nga populli... Ne jemi të bindur se pjesëmarrja e deputetëve të Partisë Demokratike në punimet e Kuvendit do të ishte edhe në dobi të sqarimit përfundimtar të ngjarjeve të Shkodrës, gjë që është kërkuar edhe nga të gjitha forcat politike dhe mbarë opinioni shoqëror. Ne i ftojmë deputetët e Partisë Demokratike që të vijnë të bashkëpunojmë bashkë, sepse kemi rrugë të gjatë për të bërë.”

Bojkoti zgjat vetëm një ditë. Deputetët e Partisë Demokratike marrin pjesë në seancën e ardhshme.

2023 Bojkoti i studentëve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë

E hëna e 2 tetorit, të vitit 2023, shënjon fillimin e vitit akademik 2023-2024, por për studentët e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, është e pazakontë: kanë vendosur të bojkotojnë studimet. Por historia fillon më herët!

16 qershor 2023 Studentët e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, prezantohen për herë të parë me faktin se duhet të qëndrojnë 3 vite në Shqipëri pas studimeve, dhe të punojnë “ku ka nevojë atdheu”, përndryshe nuk marrin diplomën e studimeve universitare, falë një deklarate për shtyp të ish-Ministres së Arsimit dhe Sportit, znj. Evis Kushi.

21 korrik 2023 Në Kuvendin e Shqipërisë, me 71 vota pro, 23 kundër dhe asnjë abstenim aprohet një ligj i ri, Ligji Nr. 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e Përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë”, që detyron studentët e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, i vetmi universitet publik i këtij lloji në Shqipëri, të nënshkruajnë një kontratë me shtetin me fillimin e vitit të ri akademik, për të mos u larguar për punë jashtë vendit,

pas përfundimit të studimeve, për një periudhë të caktuar kohore: jo më pak se 5 vite nga përfundimi i studimeve për studentët që do të regjistrohen në vit të parë; jo më pak se 3 vite nga përfundimi i studimeve për studentët e vitit të dytë deri në të katërt; jo më pak se 2 vite nga përfundimi i studimeve për studentët e vitit të pestë dhe të gjashtë. Akoma, studentët do të pajiseshin me diplomë vetëm pas plotësimit të këtij kushti. Autoriteti përgjegjës për hartimin e kontratës caktohet Universiteti i Mjekësisë, Tiranë. Nëse studentët nuk janë dakord me kushtin e mësipërm, alternativa e dytë është pagesa e tarifës së plotë të studimeve, llogaritur në vlerën 2300 euro/vit. Sipas Qeverisë, Ligji është masa e duhur për të siguruar shërbime shëndetësore për qytetarët.

Studentët qëndrojnë përpara Kuvendit në shenjë proteste deri pas mesnate dhe paralajmërojnë se do të bojkotojnë vitin e ardhshëm akademik.

2 tetor 2023 Fillon viti i ri akademik 2023-2024 për gjithë arsimin e lartë, privat dhe publik. Studentët e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë nuk janë në auditor. Kanë vendosur të bojkotojnë studimet.

12 tetor 2023 Të pakënaqur, sepse nuk kanë marrë asnjë përgjigje për kërkesat e tyre, studentët e mjekësisë bllokojnë hyrjen e Universitetit të Mjekësisë për të gjithë, studentë e pedagogë. Protestat fillojnë përpara Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Destinacioni i dytë është Ministria e Arsimit. Kërkesës së tyre për anulimin e ligjit, i shtohen edhe dy të reja: denoncimi se tarifa e llogaritur e shpenzimeve nuk është reale, por është shumë më pak se 2300 euro/vit, si edhe dorëheqja e zëvendësës së ministres së arsimit të kohës, znj. Albana Tole, që kishte deklaruar, në një komunikim për shtyp, se atyre studentëve që nuk u pëlqen ligji, le të braktisin studimet (alternativa e tretë). Ndërkohë, studentët pretendojnë se ligji i ri prek të Drejtat e Njeriut dhe paralajmërojnë se nëse qeveria nuk tërhiqet nga ligji, atëherë do të bojkotojnë vitin akademik.

20 tetor 2023 Studentët e dërgojnë ligjin në Gjykatë Kushtetuese. Avokat i studentëve është Semir Sali.

Tabelë 1: Skeda e kërkesës së studentëve, dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese

Nr.	Kërkues	Subjekte të Interesuara	Objekti
1	Një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë (jo më pak se 1/5) Anxhela Gjini, Alesia Cara, Diona Hoxha, Argisa Troka, Xhesika Xhebexhiu, Juri Taullau, Sindy Allamani, Isabela Tabaku, Dea Guri, Natali Bliu, Joel Plaku, Mikel Seferi, Reant Kullaj, ...	Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli Ministrave	“Shfuqizimi i nenit 4, pikat 1, shkronja “c”, 2, shkronja “b”, 3, shkronja “b” dhe nenit 5, fjalia e parë, të ligjit nr. 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”, si të papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pezullimi i ligjit nr. 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.”

Ligji pezullohet, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar.

30 tetor 2023 Universiteti i Mjekësisë pranon kërkesën e studentëve, se nuk do t’u jepet një kontratë për t’u firmosur, derisa Gjykata Kushtetuese të thotë fjalën përfundimtare nëse ligji që i detyron ata të qëndrojnë 5 vite në Shqipëri, është apo jo në shkelje të Kushtetueses. Studentët i japin fund bojkotit. Studentët i rikthehen studimeve.

21 dhjetor 2023 Zhvillohet seanca gjyqësore.

25 janar 2024 Gjykata Kushtetuese jep vendimin, që rrëzon pjesërisht ligjin e qeverisë. Pas shqyrtimit të çështjes, trupa gjyqësore me shumicë votash ka vendosur të shfuqizojë pjesë të formulimeve në nenin katër që lidhen me përcaktimin kohor të detyrimit të ushtrimit të profesionit në vendin tonë pas përfundimit të studimeve. Gjykata u shpreh se vendimi vjen pas analizimit të proporcionalitetit të masës shtetërore me të drejtat për arsim dhe punësim, që Kushtetua e Shqipërisë i njeh në nenet 49 dhe 57 të saj. *Në vendim, vlerësohet se:*

Dispozitat e kundërshtuara sjellin kufizim të të drejtave për arsim dhe punësim, të garantuara nga nenet 49 dhe 57 të Kushtetutës. Kufizimi është vendosur me ligj dhe për interes publik, i cili lidhet me detyrimin e shtetit për të garantuar kujdes shëndetësor ndaj shtetasve, të parashikuar nga neni 55 i Kushtetutës. Megjithatë gjatë procesit nuk u provua se kufizimi është proporcional në drejtim të afateve dhe kohëzgjatjes së shlyerjes së detyrimeve për punësim, pasi afati 5-vjeçar i parashikuar nga neni 4 i ligjit rezulton më i ashpër se sa nevoja për të përmbushur objektivin legjitim.

Gjithashtu edhe përcaktimi kohor për punësim të detyrueshëm për studentët në proces të studimeve, ashtu si afati 5 vjeçar është gjetur nga Gjykata si disproporcional. Kësisoj ka shfuqizor fjalët “3 (tre) vjet” në nenin 4, pika 2, shkronja “a”, “3-vjeçar” në nenin 4, pika 3, shkronja “b”, “2 (dy) vjet” në nenin 4, pika 3, shkronja “a”, “2-vjeçar” në nenin 4, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr. 60/2023.

Duke u nisur nga premisa që afati 5-vjeçar nuk është proporcional dhe duke marrë në konsideratë eksperiencën e vendeve të tjera, ku ky afat nuk tejkalon gjysmën e kohëzgjatjes së studimeve, u gjykua që të rishikohen edhe afatet e tjera 3-vjeçare dhe 2-vjeçare të përcaktuara në të njëjtin nen.

Gjykata ka argumentuar gjithashtu se ka zbrazëti ligjore në parashikime specifike lidhur me kriteret objektive të punësimit, trajtimit financiar dhe përllogaritjen e afateve në kohëzgjatjen e periudhës së punës së detyruar për studentët. Për shkak të shfuqizimit të dispozitive, Gjykata ka vlerësuar t'i caktojë kuvendit të miratojë të gjithë ndryshimet e nevojshme brenda një periudhe 3-mujore.

Gjykata i cakton Kuvendit detyrimin për të miratuar ndryshimet e nevojshme ligjore brenda tre muajve pas këtij vendimi.

Disa muaj pasi Gjykata Kushtetuese shfuqizoi pjesërisht ligjin për studentët e mjekësisë, qeveria reflekton ndryshimet në ligj. Argumenti i Gjykatës Kushtetuese se afati 5 vjetor është jo-proporcional, e shtyn qeverinë të propozojë që ky afat të ulet në 3 vite. Afati është ulur edhe për studentët e vitit të dytë e deri në atë të katërt, nga 3 vite që parashikonte ligji më parë, në 2 vite, dhe për studentët e vitit të pestë e të gjashtë, që ligji parashikonte dy vjet punësim të detyruar brenda Shqipërisë në një vit. Ligji i ri pretendon të zgjidhë edhe boshllëkun, që sipas Gjykatës Kushtetuese kishte ligji, për studentët që shteti nuk i punëson brenda vitit pas përfundimit të studimeve.

“Në rastet kur punësimi nuk realizohet brenda 3 (tre) muajve, për shkaqe që nuk varen nga mjeku, deri në krijimin e mundësisë për punësim në institucionet shëndetësore publike, për një periudhë deri në 9 (nëntë) muaj, mjekut i lind e drejta të trajtohet me 80% të pagës së mjekut të përgjithshëm në kujdesin parësor, për një periudhë jo më të gjatë se ky afat, ose të zgjedhë të punësohet në institucionet shëndetësore jo publike në vend, duke njoftuar ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe duke ruajtur të drejtën për punësim prioritar brenda periudhës 9 (nëntë) mujore në institucionet shëndetësore publike”- thuhet në projektligj.

REFERENCA

- Browder v. Gayle, 352 U.S. 903. <https://kinginstitute.stanford.edu/browder-v-gayle-352-us-903>. Gjetur më 28 korrik 2024.
- Council of Europe (2024). *Compass: Manual for Human Rights Education with Young People*. <https://www.coe.int/en/web/compass/home> Gjetur më 14 shtator 2024.
- Günther, K. (2011). From a gubernative to a deliberative human rights policy definition, and further development of human rights as an act of collective self-determination. In *Science and technique of democracy. Definition and development of human rights and popular sovereignty in Europe*. Council of Europe Publishing (ff.35-46).
- Harma, R.F. (2009). Global March Against Child Labour. In Hindman, H. (Ed.). *The World of Child Labor: An Historical and Regional Survey*. Routledge, ff. 163-168.
- Kenneth M. Hare (2005). *They Walked to Freedom 1955-1956: The Story of the Montgomery Bus Boycott*. Champaign, Illinois: Montgomery Adviser.
- Mandela, N. (2023). *Të ngjisësh malin. Mësime për jetën nga gjyshi im, Nelson Mandela*. Shqip: Nathanailli, V.; Prishtinë: Pema.
- Marzouki, M. M. (2015). Foreward. In Bitar, S. & Lowenthal, A. F. (Eds.). *Democratic Transitions: Conversations with World Leaders*. Baltimore: John Hopkins University Press.
- Minda, G. (1999). Boycott in America: How Imagination and Ideology Shape the Legal Mind. Southern Illinois University Press, ff. 18-32.
- Sarantakes, N. E. (2011) *Dropping the Torch: Jimmy Carter, the Olympic Boycott, and the Cold War*. Cambridge University Press.
- Sen, A. (2011). *Zhvillimi si liri*. Shqip: Nathanailli, V. dhe Verteniku, T.; Tiranë: UFO Press.
- Thomai, J., Samara, M., Haxhillazi, P., Shehu, H., Feka, Th., Meminsha V. & Goga, A. (2006). *Fjalor i Gjuhës Shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë.

PROTESTA SI SHPREHJE E TË DREJTAVE DHE SOLIDARITETIT

Një reflektim mbi nevojën për aktivizëm në Shqipëri

Demokracia sigurisht është një trashëgimi: fëmijët mësojnë të sillen dhe të veprojnë në përputhje me mënyrën se si janë rritur dhe edukuar.

Kam lexuar komente, analiza e argumente, por kam dëgjuar edhe shumë mendime nga miqtë e kolegët lidhur me arsyet përse duhet protestuar apo jo, protestë e planifikuar apo e paplanifikuar, protestë për pushtetin e filanit a filanes, protestë e partisë apo e njerëzve. Si qytetare dhe njeri i mirë shkolluar, ajo që më ka shqetësuar më shumë është kur kam dëgjuar njerëzit të thonë se në ditët e sotme ne nuk kemi arsye për të protestuar, thjesht ky vend nuk bëhet! Thirrëse dhe kontradiktore më është dukur!

Problemet e mëdha me të cilat përballen sot shqiptarët, që nga varfëria në shpirt e deri tek ajo në tryezë, nga ikja prej vetes deri tek ikja nga Shqipëria, nuk mund të zgjidhin vetveten pa e bërë publikun të vetëdijshëm se është një çështje apo disa që duhen zgjidhur, dhe që na përkasin të gjithëve, na ndihmon të hapim sytë e mendjen përtej “un-it”, dhe pa diskutim përtej ngjyrave e flamujve partiakë.

Që të të dëgjohet zëri dhe të flasësh për problemet e tua, duhet të dalësh nga zona e rehatisë!

Protestat na ndihmojnë të jemi bashkë, pa pasur nevojë që të identifikohemi me emër e figurë, jemi një! Njerëz, nga të gjitha prejardhjet, - sociale, ekonomike, krahinore, politike, - duhet të gjendemi së bashku, me një qëllim më të madh se thjesht vetja, karrigia që kemi, a partia ku jemi, me një qëllim njerëzor, bazuar në aksiomën se bashkimi bën fuqinë! Duke protestuar vetëm, shumë prej nesh janë gjendur të izoluar, të marginalizuar, të përjashtuar; duhet të mbështesim njëri-tjetrin për krijimin e mundësive për të jetuar, punuar, rritur fëmijët; duhet të besojmë se ky vend mund të bëhet.

Protestat bëhen për të na kujtuar se ne, njerëzit, jemi të fuqishëm dhe se zërat tanë janë çështje; se ne jemi të rëndësishëm dhe kemi aftësinë për të bërë ndikime të mëdha në Shqipërinë tonë; se jemi një grupim jo i parëndësishëm shqiptarësh me dallime të ndryshme, që ngrihemi së bashku; dhe të gjitha këto janë diçka e mirë për këtë vend, është frymëmarrje për demokracinë tonë të brishtë dhe frymëzuese e model për fëmijët e brezat që do të vinë.

Kam reflektuar! Se vetëm për shkak se dikush e sheh gotën gjysmë plot nga perspektiva e tij, nuk do të thotë se gjysma bosh nuk ekziston dhe se vetëm për shkak se kjo përvojë nuk është pjesë e realitetit tim, nuk do të thotë se nuk është pjesë e dikujt tjetër. Dhe si për t'i dhënë kuptim reflektimit tim them se mua kurrë nuk më ka munguar buka në tavolinë, por e di që ka me mijëra familje që nuk e kanë; unë kam pasur mundësi t'i paguaj dritat, por ka mijëra që nuk mundën e rrinë në terr; unë kam prindër pensionistë që mund t'i ndihmoj ndonëse pensioni nuk u del, por ka mijëra që nuk mundën të sigurojnë as bukën e jo më ilaçet; unë lexoj dëshmi suksesesh dhe shoh vanitetet fotosh e konferencash llamburitëse, por e di që fushata zgjedhore ka mbaruar dhe realiteti i zymtë është sërish mes nesh; ato pak para me të cilat u ble varfëria ku jemi... thjesht mbaruan!

Protesta është aftësia për të krijuar njohuri për padrejtësinë e jetës reale të tjetrit, përtej vetes. Protesta na bën mirë të gjithëve, ndonëse dikush mendon se nuk duhet të jetë pjesë e saj. Protestuesit janë një grup njerëzish me histori personale, jo domosdoshmërisht të këqija, por të gatshëm të bashkohen dhe të shkundin edhe indiferentin më të madh, të flasin me zë, figurë e numra edhe për ata që nuk mundën apo nuk deshën të votojnë, edhe për ata të cilëve heshtja u vlen më shumë; me shpresën se ndryshimi pozitiv duhet të jetë për të gjithë e t'i shërbejë të gjithëve.

Ngjarjet politike janë të paparashikueshme. Në një demokraci zgjedhore, protestat sigurojnë një zë themelor për grupet e pakicave. Edhe pse protestat mund të duken të pakuptimta për disa, i inkurajoj të gjithë të marrin një moment për të dëgjuar ç'thonë këta njerëz. Bëni një hap prapa dhe dëgjoni njerëzit! Jepuni atyre një shans para se t'i paragjykoni në revoltën e tyre! Teoricienët klasikë të qeverisë përfaqësuese e kanë pranuar se votimi universal dhe votimi i shumicës kërcënojnë të imponojnë "tiraninë e shumicës" dhe të anashkalojnë të drejtat e pakicave. Protestat janë një korrigjim jetik për sundimin e shumicës. Duke protestuar, ne ndryshojmë rendin e ditës dhe fillojmë një debat. Ata që janë në pushtet mund të përpiqen të na injorojnë, por nëse ka mjaft protestues, atëherë ata do të ndjejnë nevojën për të gjetur arsyet se përse të gjithë protestuesit qenkan gabuar. Sepse të zhvendosurit në një bulevard të gjerë do ta lërë pjesën tjetër të popullatës ta dijë se janë atje, janë edhe për ata dhe janë ngritur për atë që besojnë.

Këtu debati fillon dhe argumenti bëhet i mundur!

MIRIBANA HOTI
Kolegji Universitar LOGOS

RAJMONDA MENA
Kolegji Universitar LOGOS

Udhëhoqi: VALBONA NATHANAILI
Kolegji Universitar LOGOS

DHUNA KUNDËR GRAVE DHE QASJA E TEORISË FEMINISTE

Edhe nëse nuk dëshiron të jesh feministe, shoqëria shqiptare të detyron të bëhesh feministe – ke gjithmonë një arsye apo një shkak me të cilin nuk pajtohesh, një ngjarje me sfond diskriminimi bazuar në gjini për të cilën duhet të ngresh zërin, të reagosh, ta denoncosh! Por fatkeqësia më e madhe është kur këto beteja janë kundër vetë grave, që shpesh e inicojnë, mbështesin dhe ushqejnë këtë lloj diskriminimi!

Valbona Nathanaili: “Çfarë është demokracia” (2024)

ABSTRAKT

Në këtë artikull, synimi i parë është të bëhet një përshkrim i shkurtër i llojeve të dhunës që burrat ushtrojnë ndaj grave, si dhe një analizë e shkurtër e një sjellje të tillë; synimi i dytë është të jepet një përkufizim për feminizmin, si dhe të përshkruhen disa nga karakteristikat e kësaj lëvizje. Metodologjia e përdorur është cilësore dhe bazohet në studimin e literaturës. Nga konkluzionet, dhuna ndaj grave merr forma nga më të ndryshmet, por mund të klasifikohet në fizike, psikologjike dhe ekonomike; dhuna seksuale është, gjithashtu, e pranishme, por është më pak e raportuara; dhuna ndaj grave konsiderohet shpesh si çështje private dhe nuk raportohet. Pasojat e dhunës ndaj grave janë të mëdha dhe afatgjata.

Viktimat përjetojnë dëmtime fizike dhe emocionale të rënda, dhe kanë pengesa në zhvillimin e tyre social dhe ekonomik.

Fjalë çelës: gruaja, dhuna, teoria feministe

HYRJE

Në botën e sotme, lëvizja për të drejtat e grave dhe për barazi gjinore po merr një vëmendje gjithnjë e më të madhe. Gratë, në veçanti, po luajnë një rol të jashtëzakonshëm. Për dekada, gratë kanë luftuar për të fituar të drejtat e tyre. Megjithatë, edhe pse ka pasur përparime të konsiderueshme, ende ekzistojnë sfida të mëdha. Diskriminimi me bazë gjininë vazhdon të konsiderohet një problem serioz. Në një studim për gratë në Republikën e Shqipërisë në lidhje me punësimin pohohet, se përparimi në karrierë për të rejat dhe gratë vazhdon të mbetet i vështirë, me vetëm 30% të të anketuarave që shprehen se “kanë deri diku mundësi” të bëjnë karrierë apo të promovohen në vendin e tyre të punës, përkundrajt 51% të tyre që mendojnë të kundërtën (Shehu *et al*, 2022-2023).

Neni 1 i “Deklaratës për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave”, shpallur me rezolutën 48/104 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të datës 20 dhjetor 1993, e përkufizon dhunën kundër grave si “çdo akt të dhunës me bazë gjinore, që rezulton ose ka të ngjarë të rezultojë, në dëmtim fizik, seksual, psikologjik ose vuajtje, përfshirë kanosjet për akte të tilla, detyrimin ose heqjen arbitrare të lirisë, pavarësisht se ku ndodhin, në jetën publike ose private të tyre”. Gratë me aftësi të kufizuara, me të ardhura të pakta apo të pasigurta, si dhe gratë që jetojnë në zonat rurale janë më të prekurat nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi, ndërkohë që studimet tregojnë se statusi i emigrantit dhe i refugjatit i shtohet grupeve të viktimave, ndërkohë që të gjitha statistikatat tregojnë se shumica dërmuese e abuzuesve janë meshkuj (Coy, 2024: 13).

Duhet të theksohet që në fillim, se ndërkohë që vajzave dhe grave u mësojmë si të kenë kujdes nga të huajt, statistikatat tregojnë se dhuna dhe abuzimi kundër grave kryhen nga njerëz që ato i njohin, kryesisht të rrethit të ngushtë. Sipas Renzettit dhe Bergen (2005: 1), 54% e viktimave të dhunës raportojnë se janë abuzuar nga një person i rrethit të ngushtë – partneri, kushëri, i afërt ose një person i besuar i tyre - kundërt 45% që raportojnë një të huaj. Për fat të keq, në realitet shifrat në të dyja rastet janë shumë më të larta. Gratë që përjetojnë dhunë shpesh ndihen të turpëruara ose të frikësuara për të raportuar abuzimin nga frika e stigmatizimit

ose hakmarrjes. Sipas të dhënave të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, vetëm 7% e grave që kanë përjetuar dhunë nga partneri e raportojnë rastin në polici (OSBE, 2020: 14).

Dhuna kundër grave ka rrënjë të thella. Shoqëria ka një histori të gjatë patriarkale, në të cilën gratë janë mësuar vazhdimisht se si të binden dhe të pranojnë autoritetin (Arsovska: 10). Kultura tradicionale shqiptare, e ndikuar nga Kanuni, një kod zakonor i lashtë që rregullonte shumë aspekte të jetës sociale dhe familjare, kishte rregulla të rrepta për rolin e grave. Pra sfondi social ose paragjykimet që kemi, me ose pa dashje, ndikojnë mënyrën tonë të të arsyetuarit rreth përkatësisë në grup, pavarësisht nëse jetojmë në qytet a në fshat, jemi të rinj a të vjetër (Nathanaili, 2021: 54). Format më të zakonshme të dhunës ndaj grave në Shqipëri përfshijnë dhunën fizike, psikologjike dhe ekonomike. Dhuna seksuale është, gjithashtu, e pranishme, por është më pak e raportuara. Në një vëzhgim të vitit 2013 kryer nga Instituti Shqiptar i Statistikave, 59.4% e grave në Shqipëri raportojnë se kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës në shtëpi gjatë jetës së tyre. Sipas të njëjtit raport, dhuna në shtëpi konsiderohet si një “çështje e brendshme” dhe në përgjithësi ka tendencën të mos raportohet (Knowlton *et al*, 2021: 81).

DHUNA KUNDËR GRAVE: STATISTIKA DHE PASOJA

Në një reportazh për “Zërin e Amerikës”, më 6 prill 2022, gazetarja M. Picari shprehet:

Denoncimet për dhunë në familje, në 5 vitet e fundit, janë rritur me 21%, dhe sipas autoriteteve kjo tregon se ka qenë e fshehur. Gjatë dy viteve të pandemisë së COVID-19 ky fenomen u përkeqësua, gjë që çoi në rritjen e numrit të vrasjeve të grave dhe vajzave. Zyrtarët nënvizojnë se ka disa përmirësime ligjore me qëllim zbutjen e këtij fenomeni, ndërsa përfaqësues të shoqërisë civile thonë se ende mbetet shumë për të bërë.

Në vitin 2021, 12 gra dhe vajza humbën jetën nga dhuna, nga të cilat 10 nga dhuna në familje; në vitin 2020, 9 gra dhe vajza humbën jetën nga dhuna, nga të cilat 6 nga dhuna në familje (Picari, 2022).

Studimet tregojnë se në shumë raste, dhuna ndaj grave konsiderohet shpesh si çështje private dhe nuk raportohet (INSTAT, 2018). Për më tepër, një raport i Amnesty International (2010) vë në dukje se shumë gra nuk kërkojnë ndihmë për shkak të frikës nga stigmatizimi dhe mungesës së besimit në sistemin gjyqësor.

Pasojat e dhunës ndaj grave janë të mëdha dhe afatgjata. Viktimat përjetojnë dëmtime fizike dhe emocionale të rënda, dhe kanë pengesa në zhvillimin e tyre social dhe ekonomik. Ndërkohë, reagimi institucional ndaj dhunës ndaj grave ka shpesh qenë i kufizuar dhe i pakëndshëm. Sipas një studimi të kryer nga Campbell (2002), viktimat e dhunës janë më të prirura të përjetojnë depresion, ankth, dhe çrregullime të stresit post-traumatik.

Për të luftuar këtë problem janë zhvilluar politika dhe strategji të ndryshme. Megjithatë, efektiviteti i këtyre masave shpesh është i kufizuar nga zbatimi i dobët dhe mungesa e mbështetjes institucionale (Hajdari, 2016), ndërkohë që një raport i UN Women (2017) thekson nevojën për trajnime të vazhdueshme për zbatuesit e ligjit dhe ofruesit e shërbimeve për të trajtuar në mënyrë efektive çështjet e dhunës ndaj grave.

Varfëria dhe papunësia janë ndër faktorët kryesorë që kontribuojnë në dhunën ndaj grave në Shqipëri. Kur burrat ndihen të paafte për të përmbushur rolet tradicionale të “furnizuesit” për familjen e tyre, kjo mund të çojë në ndjenja frustrimi dhe agresioni që shpesh rezultojnë në dhunë ndaj grave. Sipas një raporti të INSTAT, rreth 30% e familjeve shqiptare jetojnë në varfëri, dhe papunësia mbetet e lartë, veçanërisht në zonat rurale.

TEORIA FEMINISTE

Feminizmi është lëvizja për t'i dhënë fund seksizmit, shfrytëzimit seksual dhe shtypjes e dhunës ndaj grave (Hooks, 2015: 1). Në përgjithësi njerëzit mendojnë se feminizmi është gjithnjë dhe gjithçka që kërkon barazinë e grave me burrave dhe një pjesë ndoshta po aq e madhe besojnë se feminizmi është anti-maskulizëm. Kjo është e gabuar!

Lëvizjet dhe shkrimet feministë fillojnë në vitet 1780, dhe kanë lidhje me debatet për revolucionet në Francë dhe Amerikë, por janë shumë më të organizuara në vitet 1850, ku në qendër është debati kundër skllavërisë dhe të drejtat politike për gratë e shtresës së mesme. Në fillimet e shekullit të njëzet, kjo lëvizje karakterizohet nga një mobilizim masiv dhe kërkon të drejtën për të votuar për të gjitha gratë, si dhe reformimin e legjislacionit civil, por vetëm në vitin 1950 gratë fitojnë të drejtën për të votuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 50 vjet më vonë pasi kjo e drejtë ishte njohur për të gjithë burrat.

Në vitet 1960, kjo lëvizje njihet përsëri një rritje të fuqishme, bazuar në tre faktorë (Ritzer, 2008: 220):

1. Një klimë e përgjithshme e të menduarit kritik që karakterizon këtë periudhë;
2. Zemërimi i grave aktiviste, të pranishme në një sërë protestash kundër luftës dhe për të drejtat civile, në të cilat u përballën direkt me qëndrimet raciste, seksiste dhe radikale të meshkujve;
3. Përvoja e hidhur dhe shpesh edhe tragjike e grave me paragjykimin dhe diskriminimin, ndërkohë që shtonin gjithmonë e më shumë numrin e tyre në radhët e krahëve të punës dhe në arsimin e lartë.

Teoria feministe është një nga qasjet më të rëndësishme për të analizuar dhunën ndaj grave. Ajo thekson se dhuna gjinore është një shprehje e përsëritur e pushtetit patriarkal mbi gratë dhe vajzat në shoqëri. Kjo teori shpjegon se normat, strukturat dhe institucionet e shoqërisë përforcojnë dhe mbështesin pabarazinë gjinore dhe ndikojnë në zhvillimin dhe normalizimin e dhunës ndaj grave.

Studimet tregojnë se edhe në kulturat më demokratike, gratë janë më pak efektive në promovimin e interesave të tyre dhe përballen me një risk më të lartë social se sa burrat kur përpiqen të negociojnë për sigurimin e burimeve që kanë lidhje me progresin në karrierë, si për shembull kompensimi për një punë më shumë që kanë kryer (Joseph, 2010: 324)

Teoria feministe e gjykon përdhunimin e grave si një zgjatim të sjelljeve normative mashkullore: shoqëria historikisht e ka barazuar mashkullin me pushtetin, dominimin, fuqinë dhe superioritetin, ndërsa femrën me dobësinë, pasivitetin, bindjen dhe inferioritetin. Një qasje e tillë e përgatit gruan të jetë viktimë “e ligjshme”, ndërsa mashkullin kriminelin potencial (Scully *et al*, 2005: f.17).

KONKLUSIONE

Format më të zakonshme të dhunës ndaj grave në Shqipëri përfshijnë dhunën fizike, psikologjike dhe ekonomike; dhuna seksuale është gjithashtu e pranishme, por është më pak e raportuara. Pasojat e dhunës ndaj grave janë të mëdha dhe afatgjata. Viktimat përjetojnë dëmtime fizike dhe emocionale të rënda, si dhe kanë pengesa në zhvillimin e tyre social dhe ekonomik. Viktimat e dhunës janë më të prirura të përjetojnë depresion, ankth, dhe çrregullime të stresit post-traumatik.

Dhuna ndaj grave është rezultat i një strukture sociale që favorizon pabarazinë gjinore dhe përforcon rolet tradicionale të gjinisë. Normat dhe stereotipet gjinore formojnë paragjyime dhe pabarazi gjinore në shoqëri, duke e bërë më të lehtë për

të ushtruar dhunë ndaj grave pa pasur pasoja sociale të rëndësishme. Dhuna është shprehje e kontrollit të burrave mbi gratë në një përpjekje për të ruajtur privilegjet e tyre në shoqëri, mjet për të ruajtur strukturën e pushtetit patriarkal dhe për të ndërtuar identitetin mashkullor dhe femëror në shoqëri.

Varfëria dhe papunësia janë ndër faktorët kryesorë që kontribuojnë në dhunën ndaj grave në Shqipëri.

REFERENCA

- Arsovska, J. (2006). Gender based subordination and trafficking of women in ethnic Albanian Context. The upward revaluation of the Kanun Morality. In *East European Human Smuggling and Trafficking. Gender, Migration and Money. Journal on Moving Communities*. Vol. 6 No 1. KOLOR. pp. 3-18.
- Coy, M. (2024). *Violence Against Women in the US: Theory, Research and Policy*. Routledge.
- Hooks, B. (2015). *Feminism Is for Everybody: Passionate Politics*. New York: Routledge.
- Joseph, S.N. Jr. (2010). Power and leadership. In Nohria, N. & Khurana, R. (eds). *Handbook of Leadership Theory and Practice. A Harvard Business School Centennial Colloquium*. Boston, Massachusetts: Harvard Business Press, ff. 305-334.
- Knowlton, M., Nevins, D. (2021). *Cultures of the World: Albania*. New York: Cavendish Square Publishing LLC.
- Nathanaili, V. (2021). Teatri dhe edukimi. Në Nathanaili, V., M., Nussbaum, M. & Fuller, S. (2021). *Edukimi liberal Si qasje dhe praktikë*. Tiranë: Fondacioni "Henrietta Leavitt".
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) (2020). *How to use survey data to prevent and combat violence against women and girls. Practical guide for decision makers, policymakers and non-governmental organizations on applying the OSCE-led survey on violence against women*. OSCE. https://www.osce.org/files/f/documents/8/a/463167_0.pdf Gjetur më 11 gusht 2024.
- Picari, M. (2022). *Shqipëri, dhuna ndaj grave sfidë për autoritetet dhe shoqërinë*. Washington: Zëri i Amerikës. <https://www.zeriamerikes.com/a/6517842.html> Gjetur më 30 qershor 2024.
- Renzetti, C.M., Bergen, R.K. (2005). The emergence of violence against woman as a social problem. In Renzetti, C. M., Bergen, R. K. (Eds.), *Violence Against Women*. Rowman & Littlefield Publishers, Inc. (pp. 1-14).

- Ritzer, G. (2008). *Sociological Theory*, seventh edition. Boston: McGraw Hill. Higher Education.
- Scully, D., Marolla, J. (2005). "Riding the Bull at Gilley's": Convicted Rapists Describe the rewards of Rape. In Renzetti, C. M., Bergen, R. K. (Eds.), *Violence Against Women*. Rowman & Littlefield Publishers, Inc. (pp. 15-30).
- Shehu, A., Danaj, E., Kocaqi, M. & Sulçe, V. (2023). *Studim për gratë në Republikën e Shqipërisë, 2022-2023*. Friedrich-Ebert-Stiftung. <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/20660.pdf> Gjetur më 30 qershor 2024.
- United Nations (1993). *Declaration on the Elimination of Violence against Women. Proclaimed by General Assembly resolution 48/104 of 20 December 1993*. https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/atrocities-crimes/Doc.21_declaration%20elimination%20vaw.pdf Gjetur më 30 qershor 2024.

NGA SHQIPËRIA NË ITALI: RËNIA DHE NGRITJA E NJË GRUAJE

ABSTRAKT

Në këtë artikull, trajtohet dhuna e përsëritur fizike dhe psikologjike brenda mjedisit familjar. Me ndihmën e një interviste gjysmë të strukturuar, jepen përvojat personale të një gruaje, viktimë e dhunës së bashkëshortit; martuar me mblesëri, me një djalë që jetonte në emigracion, në Itali, si dhe ndërveprimi i saj me institucionet mbështetëse shtetërore të vendit ku emigroi. Rasti synon të ilustrojë, në mënyrë konkrete, dinamikat komplekse të dhunës brenda familjes, si dhe apelon për sfidat me të cilat përballen viktimat në kërkimin e ndihmës dhe drejtësisë. Akoma, artikulli synon të nxisë veprime efektive për parandalimin dhe trajtimin e dhunës ndaj grave.

Fjalë çelës: dhunë, grua, pabarazi, pasoja, parandalimi.

HYRJE

Dhuna ndaj grave shfaqet në forma nga më të ndryshmet, si dhuna fizike, seksuale, psikologjike, ekonomike etj. Në periudha të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë, disa forma kanë qenë më të dukshme e të tjera jo, por në përgjithësi kanë qenë gjithnjë atje, pjesë e pandarë e historisë së rrugëtimit të gruas. Në ditët e sotme, ndryshimet demografike dhe teknologjike kanë çuar në lindjen e formave të reja

të dhunës, si ngacmimi në internet dhe me telefon, trafikimi ndërkombëtar i grave dhe dhuna ndaj tyre si punëtore jo lokale.

Rrënjët e dhunës ndaj grave qëndrojnë në marrëdhëniet historikisht të pabarabarta të fuqisë midis burrave dhe grave dhe diskriminimit të thellë ndaj grave si në sferën publike ashtu edhe në atë private.

Dhuna ndaj grave nuk kufizohet në një kulturë, rajon ose vend të veçantë, ose në grupe të veçanta të grave brenda një shoqërie. Manifestimet e ndryshme të kësaj dhune ndikohen nga faktorë si etnia, klasa, moshë, orientimi seksual, aftësia e kufizuar, kombësia dhe feja. Akoma, dukuria e tmerrshme e vdekshmërisë së lartë femërore (fetuseve dhe bebeve femra) në shumë pjesë të botës është një aspekt vulgar dhe i mprehtë i pabarazisë gjinore (Sen, 2011: f. 113-114).

Nga ana tjetër, kaq e fortë është kultura e shtypjes, sa shpesh gratë e drejtojnë gishtin tek vetja, duke bërë vetveten me faj. Në një raport të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE, 2020: f. 9) për përdorimin e të dhënave si instrument për parandalimin e dhunës kundër grave dhe vajzave, pohimit “Dhuna kundër grave dhe vajzave provokohet shpesh nga viktimat”, 64% e të intervistuarave, të moshës 18-74 vjeç i përgjigjen “Po”. Në të njëjtin dokument, dhuna kundër grave dhe vajzave, për 62% e të intervistuarave konsiderohet çështje private, që duhet menaxhuar brenda familjes, ndërkohë që vetëm 23% e tyre janë të informuara se çfarë duhet të bëjnë dhe ku të drejtohen në një rast dhune.

Statistikat tregojnë se në vende të ndryshme të botës ka pasur përparime të konsiderueshme në reduktimin e deri eliminimin e saj, që do të thotë se dhuna ndaj grave nuk është e pashmangshme, por kërkon vullnet politik. Aktualisht, dhuna ndaj grave është nxjerrë nga domeni privat dhe i është dhënë për shqyrtim publikut, përfshirë shtetit dhe strukturave të tij ekzekutive, kryesisht për shkak të punës së organizatave dhe lëvizjeve të grave në të gjithë botën. Sot, dhuna ndaj grave nuk trajtohet më si rezultat i akteve të rastësishme të keq-bërjes individuale, por vlerësohet shumë më e thellë, e rrënjësuar në marrëdhëniet strukturore të pabarazisë midis grave dhe burrave.

Instrumente të ndryshëm të politikave ndërkombëtare dhe rajonale detyrojnë shtetet të angazhohen seriozisht në ndëshkimin e dhunës ndaj grave.

NGA SHQIPËRIA NË ITALI: HISTORIA E E.S., E MBIJETUAR E DHUNËS FAMILJARE

Përshkrimi i rastit: E.S. mbërrin në Itali në vitin 2005, si bashkëshortja e ligjshme e një emigranti shqiptar nga Shqipëria. E.S. sapo kishte mbaruar shkollën e mesme të përgjithshme në një qytet në veri të Shqipërisë dhe jo vetëm pa asnjë histori pune, por edhe pa asnjë kualifikim të veçantë. Me zero të ardhura të tjera, përveç atyre që siguronte bashkëshorti, pavarësia financiare në vendin e ri ishte një çështje jashtë diskutimit. Njohuritë e italishtes, gjuhës së vendit ku do të jetonte, i kishte pothuaj të papërfillshme.

Metodologjia

Metoda e përdorur është cilësore, bazuar në një intervistë të strukturuar, me pyetje të hapura. Intervista është zhvilluar nga M.R., një person i afërt me të intervistuarën. Pyetjet u përgatitën më parë, ndërsa M.R. u trajnuar për zhvillimin e intervistës.

Intervista është zhvilluar në një mjedis të mbyllur, vetëm për vetëm. Raporti jetë-gjatë dhe i ngushtë ndërmjet tyre, baza e krijimit të besimit në qasjen e zgjedhur etnografike, ndihmoi cilësisht në zhvillimin e intervistës: e intervistuarja e përballoi emocionalisht përshkrimin e episodeve dramatike të jetës së saj, ndonëse iu bë e qartë që në fillim se mund të tërhiqej kur të dëshironte, nëse nuk ndihej mirë. Intervista përfshin dy faza: në fillim kërkohet një përshkrim narrativ i historisë së jetës së E.S. dhe më pas motivet për vendimet e marra. Të intervistuarës iu shpjegua që në fillim synimi i këtij botimi. Intervista u zhvillua në gjuhën shqipe. Intervista është zhvilluar në Shqipëri: E.S. ndodhej në vendlindje për t'i qëndruar afër mamasë së saj, në vijim të një problemi shëndetësor që kishte pasur.

Nisma për publikimin e kësaj historie është e vetë E.S., si një apel për vajzat, për të qenë më të kujdesshme në zgjedhjet që bëjnë. Janë bërë përpjekjet maksimale për të ruajtur identitetin e të intervistuarës, duke filluar nga inicialet dhe të dhënat që kanë të bëjnë me vendin ku jeton aktualisht, por sfida e ruajtjes së anonimitetit në raste të tilla është e madhe (Svašek & Domecka, 2012 : 112).

Aktualisht, E. S., 37 vjeç, jeton në një qytet të Italisë, me djalën e vetëm, që sipas saj, “Ai është arsyeja që jetoj dhe luftoj për jetën”.

Intervista e M. R. me E.S.

M. R.: Përshëndetje! Si ndihesh? Je gati të të intervistoj? Të lutem, nëse në ndonjë moment nuk do të mundesh, më thuaj ta ndërpresim që të pushosh pak.

E. S.: Patjetër, të kam premtuar se do flasim një ditë! Do mundohem të jem e fortë dhe të tregoj gjithçka për jetën time, nga momenti që u martova deri më sot.

M. R.: Faleminderit! Më trego pak për veten, familjen dhe mjedisin ku je rritur.

E. S.: Kam lindur në një fshat në veri të Shqipërisë dhe jam e datëlindjes 1987. Familja ime ishte e madhe: katër motra dhe dy vëllezër, dhe me dy prindër tejet fanatikë. Por që nuk i bëj dot me faj! Mentaliteti i krahinës dukej sikur u rridhte në dej. Të ardhurat ishin të pakta dhe mund të them që ishim të varfër, por mamaja luante një rol të jashtëzakonshëm. Dashuria e saj mbushte tavolinën dhe jetët tona përditë. Nëse ka diçka të bukur që na mësoi, mendoj se dashuria që duhej të ushqenim për njëri-tjetrin, për të gjithë anëtarët e familjes, ka qenë kryesorja. Gjithnjë na këshillonte dhe tregonte si ta ndihmonim njëri-tjetrin. Me çfarë të mundeshim! Babai kishte natyrë të rreptë... (*mendohet një çast dhe nuk flet*)... ndonëse fjala ‘i egër’ e përshkruan më mirë. Përpiqej të na falte dashuri, por jo në atë masë e mënyrë për të cilën ka nevojë një fëmijë. Gjithsesi, fëmijëria ime ka kaluar pa ndonjë traumë. Përpos të gjithave, kemi qenë të lumtur.

M. R.: Në çfarë viti je martuar?

E. S.: Më martuan pa dëshirën time, në vitin 2004. Në atë kohë isha vetëm 17 vjeç, një vajzë e re, minorene, me plot ëndrra për jetën siç çdo vajzë tjetër.

M. R.: Kur thua ‘*më martuan pa dëshirën time*’, çfarë kupton?

E. S.: Me mblesëri! Babait i kishin mbushur mendjen disa shokë të më fejonin me djalin e një të njohuri të tyre dhe ai pranoi, por pa e njohur djalin – unë jo e jo, por as ai. Nuk më pyeti kurrë nëse dëshiron të fejoresh apo jo. Prenë fjalën dhe përgatitën shtëpinë për ngjarjen e madhe. Dita kur djali erdhi në shtëpinë time, së bashku me prindërit e tij, sot mund ta quaj si një ditë të zezë për mua. Gjithsesi, atë ditë u prezantuam dhe menjëherë u lidh miqësia.

M. R.: Kur e pe djalin për herë të parë, të pëlqeu? Çfarë ndjeve?

- E. S.:** Me thënë të drejtën nuk më tërhoqi fare. Isha vajzë e ndrojtur dhe nuk guxoja ta shikoja gjatë, as babai nuk më la kohë ta njihja. Më tha se janë familje e mirë dhe duhet të pranosh, nuk dija çfarë të bëja, nuk mund ta kundërshtoja babain.
- M. R.:** Pranove po atë ditë? Menjëherë?
- E. S.:** Çfarë të bëja... nuk kisha zgjidhje tjetër.
- M. R.:** Më fol pak për fejesën dhe marrëdhënien që filluat të ndërtonit.
- E. S.:** Kur u bë fejesa qëndroi një javë në fshat, dhe po ato ditë bëmë celebrimin në komunë. Mora mbiemrin e tij, sepse ishte më e thjeshtë për të marrë letrat në Itali dhe ndërkohë aplikova edhe për pasaportën shqiptare. Ndenja një vit e fejuar, ndërkohë ai vazhdonte jetesën në Itali.
- M. R.:** Në periudhën që ishit të fejuar, komunikoni bashkë?
- E. S.:** Po, flisnim në telefon. Në fillim më dukej normal, kishte fjalë të mëdha për jetën. Në vitin 2005 më mori në Itali.
- M. R.:** Si ike në Itali?
- E. S.:** Letrat dolën shumë shpejt, brenda gjashtë muajsh, si bashkim familje. Isha 18 vjeç. U martuam në një ceremoni të vogël, sepse familja ime nuk kishte mundësi ekonomike. Udhëtimi për në Itali u bë me traget. Ai i pagoi të gjitha.
- M. R.:** Si nisi jeta me të atje?
- E. S.:** Në fillim gjithçka dukej mirë! Një jetë normale, edhe pse nuk kisha shumë ndjenja për të. Mundohesha të isha e dashur, ndërsa ai nuk më përkushtoj. Shpesh herë më bërtiste, për asgjë. Pa kaluar mirë viti i parë i jetës sonë të përbashkët, filloi të pinte alkool. Pothuaj në të njëjtën kohë filloi edhe dhunën ndaj meje. Më pas filluan edhe përplasjet e forta.
- M. R.:** Kush punonte nga ju të dy? Çfarë jete bënit?
- E. S.:** Ai punonte në ndërtim, ndërsa unë nuk punoja sepse nuk njihja gjuhën. Pas një viti të vështirë, lindi djali! Një djalë i bukur, që më erdhi si një engjëll! Ardhja e djalit e ndryshoi disi atmosferën. Sa herë shihja atë, ndihesha e lumtur. Por pas lindjes së djalit, shoqëria e ish-burrit tim u zgjerua me disa njerëz të dyshimtë, për të cilët mësova se përdornin lëndë narkotike. Gjendja në familje fillon të rëndohet gjithnjë e më shumë.
- M. R.:** Çfarë ndodhi më pas?
- E. S.:** Ai filloi mos të sillte të ardhura në shtëpi, ndonëse kishim nevojë më shumë se kurrë. Djali kishte shpenzimet e veta, por ai as që interesohej për të, sepse vinte i dehur dhe vetëm ziheshin. Tashmë çdo natë!

M. R.: Si ja bëje ti për vete dhe djalin?

E. S.: Për fat kisha një vëlla në Itali. Ai shpesh më ndihmonte me ushqimet e qiranë e shtëpisë. Ish-burri im filloi mos ta paguajë qiranë, por i zoti i shtëpisë për hatër të djalit që i vinte keq na linte nga 4 - 5 muaj falas. Pastaj na nxirrte se s'kishte çfarë të bënte! "Më vjen shumë keq" - më thoshte – "por nuk kam mundësi t'iu mbaj më shumë". Mblidhja plaçkat dhe me djalin në krah kërkoi shtëpi tjetër. Paguanim në rregull vetëm muajin e parë, pastaj 2-3 muaj u lutesha të zotëve të shtëpisë të qëndronim, me premtimin se do t'i paguajmë me pak vonesë sepse nuk kemi mundësi, derisa mërzhiteshin nga pritja dhe na nxirrnin jashtë. Historia fillonte më pas nga e para. Brenda një viti mund të kem ndërruar katër shtëpi.

M. R.: Po më vonë?

E. S.: Gjendja filloi të përkeqësohej çdo ditë e më shumë. Ai filloi edhe bixhozin. I kishte kapur gjithë të këqijat. Unë dhunohesha çdo ditë. Kur djali mbushi dy vjeç, e dërgova në çerdhe, ndërsa unë fillova të punoj si sanitare në një hotel. Paguhesha mirë, sepse punoja edhe jashtë orarit. Mendoja vetëm për djalin, që mos të mbetej pa ushqim, si e si t'i krijoja ca kushte të mira jetese, si çdo fëmijë.

M. R.: Ai nuk sillte asgjë në shtëpi?

E. S.: Jo që nuk sillte, por filloi të më merrte para. Më merrte kartën e bankës me dhunë dhe shkonte e i prishte gjithë paratë e punës sime. Në darkë vinte përsëri në shtëpi dhe më dhunonte mua.

M. R.: Përse nuk e denoncoje?

E. S.: Më bënte presion, më bënte shantazh me jetën e djalit dhe më thyente kartat e telefonit që mos të merrja karabinierët. Shpesh herë më përplaste nëpër shtëpi. I thoja të lutem më jep telefonin të marr ambulancën, se nuk mund të lëviz, dhe më thoshte jo, se kishte frikë mos e denoncoja.

M. R.: Djali filloi ta kuptonte gjendjen?

E. S.: Ashtu kaluan disa vite deri sa djali u bë 10 vjeç. Filloi ta kuptonte gjendjen. Më pyeste shpesh herë, përse babi vepron kështu me ne, përse të dhunon ty, por kurrë nuk ja tregojë punët e pista të tij. Nuk doja të ndjehej keq, por ai kuptonte tashmë gjithçka. Shikonte gjendjen e të atit çdo natë, i dehur, i droguar, i dobësuar... që përplaste çdo gjë në shtëpi. Djali strukej në një qoshe dhe qante kur shikonte skenat. Rrinte gjithmonë si i trembur dhe më thoshte ikim te daja, të ikim nga ky njeri. Djali më mbante në jetë kur më thoshte "Unë nuk do bëhem si babi!".

Djali ka kaluar shumë trauma, si pasojë na u desh që unë dhe djali të kuroheshim dhe të frekuentonim për shumë kohë psikologët.

M. R.: Si u larguat prej tij?

E. S.: Një ditë të bukur, që e quaj ditën më të bukur të jetës, kur ai ishte larg me punë, mora djalin dhe me trenin e parë u largova për në një qytet tjetër, për tek vëllai. Rugës ktheja kokën se më dukej se e kisha nga pas, si hije. Vetëm kur arrita tek vëllai bëra denoncim. Shteti italian më mori menjëherë në mbrojtje. Shkuan dhe e kapën. Për fat të keq nuk kisha mbajtur prova, por prova më e madhe ishte djali. I besuan djalit dhe ai ua tregoi të gjitha. Autoritetet morën masa që mos të na afrohej, i dogjën dokumentet italiane dhe është gjithmonë nën mbikëqyrjen e shtetit. Shteti italian na ndihmoi me jetesën, na siguroi një shtëpi dhe një punë për mua. Djalin e futën menjëherë në shkollë dhe e përfshinë në shumë aktivitete falas, që ai të harronte të shkuarën.

M. R.: Si ndjehesh tani?

E. S.: Plagët në trup më janë shëruar, por trauma psikologjike vazhdon. Po kurohem, sepse nuk mund ta harroj të shkuarën. Përdor vazhdimisht *ksanas*, një ilaç kundër depresionit – as nuk fle dhe as nuk qetësohem dot pa të, sepse më duket sikur nga çasti në çast do më bie të fikët.

M. R.: E ke marrë pasaportën italiane?

E. S.: Jo nuk e kam marrë akoma.

M. R.: Kujt i detyrohesh një falënderim?

E. S.: Një falënderim i madh i shkon ZOTIT, djalit (që ishte burim force për mua), motrës, vëllait dhe padyshim shtetit italian.


SITUATA E DHUNËS NË FAMILJE NË SHTETIN ITALIAN

Në Itali, ofrohen shërbime dhe mbështetje të ndryshme për gratë viktime të dhunës për t'i ndihmuar të dalin nga situata të rrezikshme dhe t'u ofrojnë mbrojtje dhe ndihmë, si “Qendrat kundër dhunës”, “Shtëpitë e strehimit”, “Numrat e urgjencës”, “Shërbimet e asistencës ligjore”, “Programet e riintegritit social dhe ekonomik” etj.

GREVIO (akronimet janë nga anglishtja, për *Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence*) është organi i ekspertëve të

pavarur përgjegjës për monitorimin e zbatimit nga palët e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), i cili monitoron zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Monitorimi bëhet mbi bazën e një pyetëso, hartuar nga GREVIO, që plotësohet nga autoritetet e vendit përkatës.

Nga raporti i monitorimit të shtetit italian (GREVIO, 2024: 75), në vitin 2022, 26,131 gra janë ndihmuar nga qendrat sociale për të dalë nga dhuna në familje, një shifër që ka pësuar rritje krahasuar me dy vite më parë: në vitin 2020 kanë kërkuar ndihmë 15,837 gra, ndërsa në vitin 2021 kanë kërkuar ndihmë 19,592 gra (shih Figurën 1).



Figurë 1: Numri i grave, ndihmuar nga qendrat sociale për të dalë nga dhuna në familje. Itali: periudha 2020-2022.

Për këto gra, vendimi për të nisur një rrugëdalje nga dhuna ka kërkuar disa vite:

- 41.3 % e grave e kanë kërkuar ndihmën më shumë se pesë vjet më vonë nga episodet e para të dhunës;
- 33.5 % e kanë kërkuar ndihmën nga një deri në pesë vjet;
- 13.5 kanë kërkuar ndihmën nga gjashtë muaj në një vit
- 7.1 për qind të grave koha e kaluar nga dhuna e pësuar tek fillimi i bashkëpunimit me një qendër ka qenë më pak se gjashtë muaj.

Përpara se të bashkëpunojnë me një qendër, 43.5 % e grave iu drejtuan të afërmeve për ndihmë, 31.9 % shkuan në Polici dhe 28.4 % në një spital; 17.7% e grave

e nisën rrugën e daljes nga dhuna në situata emergjente, pra në një situatë të rrezikshme për sigurinë e tyre. Prej tyre, 75% kishin përjetuar dhunë për më shumë se një vit dhe 38.3% për më shumë se pesë vjet.

Ivone dhe Negri, bazuar në një raport të vitit 2018 të GREVIO, veçojnë situatën e grave që kanë migruar në Itali dhe nënvizojnë mungesën e një ndërhyrje të përshtatshme në emër të tyre, për të përforcuar një problem më të përgjithshëm, mungesën e investimeve kulturore dhe financiare në vend, pra jo thjesht kriminalizim.

KONKLUSIONE

Dhuna ndaj grave është shkelje e të drejtave të njeriut, e rrënjosur në marrëdhëniet e fuqisë historikisht të pabarabarta midis burrave dhe grave dhe diskriminimit sistematik kundër grave, që depërton në sferën private dhe publike. Konteksti nga lindin është shumë i gjerë, duke filluar nga tradita patriarkale dhe deri tek normat dhe praktikat socio-kulturore që përjetësojnë diskriminimin me bazë gjinore dhe pabarazitë ekonomike.

Në rastin e E.S., qyteti ku ka lindur dhe është rritur është i njohur për largimin e të rinjve - pjesa më e madhe kanë migruar në shumë nga vendet evropiane, ku kryeson Anglia – si një zgjidhje ndaj mundësive tejet të kufizuara, të ardhurave të pakta dhe dëshirës për të ndihmuar familjen. Lëvizja bazohet në nisma personale dhe realizohet falë njohjeve apo mekanizmave të tjerë, por në çdo rast të pakontrolluara nga shteti. Synimi është vetëm ikja dhe asnjëherë kthimi. Ikja e të rinjve ka marrë vëmendjen e politikës, por ende pa zgjidhje. Zakonisht janë meshkujt që ikin të parët dhe më pas kërkojnë edhe nuse në Shqipëri, që për familjen e vajzës, këto lloj martesash janë një lloj shpëtimi. Në vendimin e martesës, në pjesën më të madhe të rasteve, është familja që vendos – vajzat nuk kanë zë - por nuk mund të thuhet se nuk kanë dëshirë. Ideja e ikjes në një vend të huaj, të zhvilluar, të pasur, me shumë mundësi, ku më tunduesja duket pavarësia nga prindër shpesh tejet konservatorë dhe të mbyllur, duket shumë tërheqëse.

E.S., edhe pse e divorcuar dhe me mbështetje nga shteti italian, vazhdon të kurohet kundër depresionit.

REFERENCA

- Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence (GREVIO) (2024). *Albania: Progress in efforts to stop violence against women*. Council of Europe. <https://rm.coe.int/grevio-inf-2024-4-state-report-italy-first-thematic-evaluation/1680b0cc5a> Gjetur më 16 tetor 2024.
- Ivone, V., Negri, S. (2019). *Domestic violence against women. International, European and Italian Perspectives*. Milano: Proprietà Letteraria Riservata.
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) (2020). *How to use survey data to prevent and combat violence against women and girls. Practical guide for decision makers, policymakers and non-governmental organizations on applying the OSCE-led survey on violence against women*. OSCE. https://www.osce.org/files/f/documents/8/a/463167_0.pdf Gjetur më 11 gusht 2024.
- Sen, A. (2011). *Zhvillimi si liri*. Tiranë: Albanian University Press.
- Svašek, M. & Domecka, M. (2012) The Autobiographical Narrative Interview: A Potential Arena of Emotional Remembering, performance and reflection. In Skinner, J. (Ed.). *The Interview: An Ethnographic Approach*. Bloomsbury, pp. 107-126.

KAPITULLI III

ÇFARË ËSHTË DEMOKRACIA?

Demokracia dhe tranzicioni

Zgjedhjet e para shumë-partiake dhe Shqipëria

Valbona Nathanaili

Demokracia

Zgjedhjet e para shumë-partiake në Shqipëri pas përmbysjes së komunizmit

Rrugëtim

Pesë muajt e parë të vitit 1991

Zgjedhjet e përgjithshme të 31 marsit 1991

Tranzicioni dhe Shqipëria

Referenca

Pushteti i shumicës ose i popullit ose demokracia

Vladimir Myrtezai

Këtu, në Shqipëri...

Andi Knuti

Referenca

Qytetarët prodhojnë demokracinë që prodhon qytetarët

Edgar Morine / Përktheu nga frëngjishtja: Blerta HYSKA

E ardhmja e demokracisë

Referenca

Në vend të epilogut: për një shoqëri që respekton të drejtat e fëmijëve

Ghassan Khalili / Përktheu nga anglishtja: Valbona Nathanaili

“Qendrat për të drejtat e fëmijëve” në institucionet e arsimit të lartë
Promovimi i të drejtave të fëmijëve
Qasja bazuar në kërkimin shkencor
Përfshirja e të drejtave të fëmijëve në kurrikul
Konkluzione

DEMOKRACIA DHE TRANZICIONI

Zgjedhjet e para shumë-partiake dhe Shqipëria

Mundësitë sociale kontribuojnë direkt në zgjerimin e aftësive njerëzore dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Amartya Sen: “Zhvillimi si liri” (2011)

DEMOKRACIA

Në ditët më të errëta të Luftës së Dytë Botërore, kur vetë e ardhmja e Amerikës ishte në rrezik, Bordi i Propagandës së Luftës së Qeverisë Federale të ShBA-së i kërkon shkrimtarit E. B. Uhait të formulojë një përgjigje të shkurtër për pyetjen “Çfarë është demokracia?”. Përgjigjja e tij ishte modeste, por frymëzuese. Ai shkroi:

Sigurisht që Bordi e di çfarë është demokracia! Është vija që përcakton kufirin e së drejtës. Është “mos”, në mos shtyj. Është e çara nga hyn drita në një dhomë të errët; është ulja e hundës së një fodulli. Demokracia është dyshimi i vazhdueshëm, që më shumë se gjysma e popullsisë ka të drejtë më shumë se gjysmën e kohës. Është ndjesia e privatisë në dhomën e votimit, e përkatësisë në një bibliotekë, e të qenët i gjallë në çdo vend ku gjendesh. Demokracia është letra që i shkruan kryeredaktorit. Demokracia është mundësia për ta gjuajtur topin dhe fituar lojën. Është ideja që nuk është hedhur poshtë akoma, është kënga, fjalët e së cilës nuk janë shkruar keq. Është mustarda në një *hot dog* dhe kremi në një kafe të racionuar. Demokracia është kërkesa e një Bordi Luftime, në mes të mëngjesit dhe në mes të luftës, që kërkon të dijë se çfarë është demokracia.

(E. B. White)

Demokracia është sistemi politik që përgjithësisht vlerësohet si më i afti të sigurojë barazi politike, të mbrojtë lirinë dhe interesat e qytetarëve, të promovojë vetë-

zhvillimin moral dhe një vendimmarrje efektive që merr në konsideratë interesat e të gjithëve (Giddens, Sutton, 2014: 204). Ndërsa regjimi politik, në dallim nga sistemi politik, është mënyra se si janë të organizuara pushtetet dhe sesi ato ushtrohen në një sistem politik të dhënë (Bufi, 2015).

Barazia, qytetaria, ndjesia e lirisë dhe e synimeve të përbashkëta që portretizon E. B. Uhait përbëjnë thelbin e demokracisë amerikane të mesit të shekullit të njëzetë (Levitsky, S. *et al*, 2018), por deri më sot vetëm në Athinën e lashtë dhe në SHBA demokracia ka mundur të jetojë për më shumë 200 vjet (Kogan, 1991: 2). Në fakt, jo të pakta kanë qenë problematikat edhe në Athinën e kohës së demokracisë. Për Forsdyke (2005: 278), ostracizimi, ndryshe procesi i votimit, nëpërmjet të cilit vendosej nëse një person i caktuar ishte pasuruar apo jo në mënyrë të paligjshme, apo nëse me veprimet apo mosveprimet kishte dëmtuar vendin, ishte ngritur në institucion dhe ishte një mënyrë relativisht e moderuar e ekzilit të kohës së tiranisë. Elitat politike të qyteteve të ndryshme të Greqisë, në luftë për pushtet dhe influencë, në mënyrë të vazhdueshme dëbonin kundërshtarët nga qytetet e tyre, veçanërisht kur kuptonin se po fitonin shumë kontroll dhe influencë, por demokracia athinase arriti ta transformojë këtë traditë të hershme, për të përforcuar dallimin ndërmjet ushtrimit të drejtë dhe të padrejtë të pushtetit.

Aktualisht, 70% e popullsisë botërore jeton ose nën një regjim jo demokratik, ose në një vend ku demokracia është në regresion (Dhopte, 2023). Ndërsa në një anketim zhvilluar nga Qendra për Edukim Qytetar, vetëm 30% e amerikanëve të lindur në vitin 1980 besojnë se është e rëndësishme të jetosh në demokraci (Stenner, 2024).

Shumë nga përpjekjet e qeveritarëve në shkatërrimin e demokracisë janë “ligjore”, në kuptimin që kanë miratimin e ligjit, ose pranohen nga gjykatat. Për më tepër, shpesh promovohen edhe si përpjekje në funksion të *përmirësimit* të demokracisë pra, që e bëjnë sistemin gjyqësor më efikas, luftojnë korrupsionin dhe ndihmojnë në transparencën e procesit elektorale. Gazetat vazhdojnë të botohen, por janë në pronësi, ose nën thundrën e vetëcensurimit. Qytetarët vazhdojnë ta kritikojnë qeverinë, por shpesh e gjejnë veten në vështirësi ligjore, a përballen me taksa të pashpjegueshme. Një situatë e tillë e shpie publikun në shtegun e gabuar. Njerëzit nuk e kuptojnë menjëherë çfarë po ndodh. Shumë vazhdojnë të besojnë se po jetojnë nën një regjim demokratik. Në vitin 2011, kur një sondazh i barometrit latino-amerikan të vëzhgimit u kërkoj venezuelasve të vlerësonin vendin e tyre në një shkallë nga 1 (aspak demokratik) në 10 (plotësisht demokratik), 51% e aty që u përgjigjën i dhanë vendit të tyre një notë nga 8 e lart.

(Levitsky et al, 2018)

ZGJEDHJET E PARA SHUMË-PARTIAKE NË SHQIPËRI PAS PËRMBYSJES SË KOMUNIZMIT

Rrugëtim

Në Shqipëri, në periudhën e regjimit komunist, ka qenë normë mbajtja e zgjedhjeve elektorale çdo katër vjet. Sipas Fjalorit Enciklopedik Shqiptar (1985: 181), zgjedhjet ishin me votim të përgjithshëm, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë, ku vetë deputeti cilësohet si ‘përfaqësuesi i popullit’, që ushtron detyrën në “organin më të lartë shtetëror në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë”. Kandidatët propozoheshin nga Fronti Demokratik: “Fronti Demokratik propozon kandidatët për deputetë dhe organizon e udhëheq fushatën e zgjedhjeve për në Kuvendin Popullor” (Fjalorit Enciklopedik Shqiptar, 1985: 293).¹ Pjesëmarrja në votime, megjithëse ishte ligjrisht e lirë, në fakt ishte e detyrueshme. Gara ishte kush do të votonte i pari! Kutitë e votimit hapeshin që në mëngjes herët; në drekë kishin votuar të gjithë anëtarët e Frontit Demokratik. Ata që nuk ishin anëtarë të Frontit Demokratik, thënë ndryshe ata që kishin statusin e armikut të popullit, nuk lejoheshin të votonin: lufta ndaj “armiqve të popullit” përfshinte edhe përjashtimin social! Nëse e gjykojmë atë lloj votimi me termat e sotëm, mund të thuhet se ka këto elementë: i drejtpërdrejtë, me një raund, me sistem të pastër mazhoritar, pa kandidatë rivalë.

Data zyrtare e përmbysjes së diktaturës komuniste në Shqipëri është ajo e “Ditës Kombëtare të Rinisë”, 8 dhjetori, caktuar si e tillë nga Kuvendi i Shqipërisë, në kujtim të “Lëvizjes Studentore”,² që nisi më 8 dhjetor 1990 dhe shënjon pikënisjen e një sërë ngjarjesh të rëndësishme për historinë e vendit, por që të gjitha mund të përmbliidhen me një fjalë të vetme: Shqipëria nuk është më vend komunist.

1 *Shënim:* Sipas Fjalorit Enciklopedik Shqiptar, botim i vitit 1985 i Akademisë së Shkencave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (faqe 293), Fronti Demokratik është “organizata më e gjerë e masave që bën pjesë në sistemin e diktaturës së proletariats, mbështetja më e fuqishme politike e Partisë dhe e Pushtetit Popullor”.

2 *Shënim:* Ligj nr.10226, datë 4.2.2010, për një shtesë dhe ndryshim në Ligjin Nr. 7651, datë 21.12.1992 “Për festat zyrtare e ditët përkujtimore”, të ndryshuar. Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi: Në ligjin nr. 7651, datë 21.12.1992 “Për festat zyrtare e ditët përkujtimore”, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë: Neni 1 / Në nenin 1 bëhen ndryshimet e mëposhtme: 1. Pas shkronjës “g” shtohet shkronja “gj” me këtë përmbajtje: “gj) 8 dhjetori – Dita Kombëtare e Rinisë” (Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr. 13, Datë. 25/02/2010)

Pesë muajt e parë të vitit 1991

Pluralizmi politik në Shqipëri dekretohet më 17 dhjetor 1990 (Dekreti Nr. 7442), por vendi është pothuaj në kolaps. Pesë muajt e parë të vitit 1991 janë të mbushur me ngjarje të jashtëzakonshme, që në mënyrë kronologjike mund të përmbledhen si më poshtë:

Janar 16, 1991: Sindikatat e Pavarura fillojnë një grevë të përgjithshme, e cila paralizon transportin urban dhe më pas shtrihet edhe në miniera. Sipas Ramiz Alisë, vendi është në prag të anarshisë: “Pa e ekzagjeruar jemi në prag të anarshisë, e cila nuk ka dyshim do të sjellë konsekuenca tepër të rënda në planin ekonomik, por tepër të rënda edhe në planin politik, sepse anarshia kurrë nuk ka pasur të mira” (Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave/ Report TV).

Shkurt 1991: Në portin e Durrësit, bëhet përpjekja e parë për një eksod masiv, por pengohet nga forcat e rendit. Pasojat janë shumë të hidhura: plagosen 35 policë, digjen disa dyqane dhe thyhen shumë vitrina. Ngjarje të tilla dhune do të ndodhnin edhe në Korçë, Kavajë, Shkodër, Elbasan etj.

Shkurt 1991: Studentët e Universitetit të Tiranës nisën grevën e urisë me kërkesën për heqjen e emrit të Enver Hoxhës Universitetit të Tiranës; poshtë dritareve të godinës ku ishin ngujuar studentët, bënin roje qytetarët e Tiranës.

Shkurt 7, 1991: Sali Berisha jep një intervistë në “Zërin e Amerikës”, duke thënë se në vend “ekziston mundësia e një grushti shteti”.

Shkurt 20, 1991: Një turmë e madhe manifestuesish i drejtohen sheshit “Skënderbej” dhe rrëzojnë statujën e Enver Hoxhës

Shkurt 22, 1991: Bie qeveria Çarçani dhe zëvendësohet me një kabinet ekspertësh; kryeministër është Fatos Nano; është rënë dakord që kjo qeveri do të jetë e përkohshme.

Mars 1991: Në portet e Vlorës, Durrësit dhe Shëngjinit mbi 25 000 njerëz rrëmbejnë anijet dhe largohen drejt Italisë. Forcat e policisë nuk janë në gjendje t’i mbajnë!

Mars 31, 1991: Mbahen zgjedhjet e para shumë partiake. Zgjedhjet ishin planifikuar të mbaheshin më 20 shkurt 1991, por pas legalizimit të pluralizmit politik, ligjit zgjedhor iu bënë ndryshime, për t’i hapur rrugë konkurrimit të formacioneve të reja politike opozitare (Bufi, 2016).

Maj 3, 1991: Fatos Nano ngarkohet për të krijuar qeverinë e re. Kryeministri i ri fton opozitën të krijojnë së bashku një qeveri koalicioni, por kundërshtohet nga Sali Berisha.

Maj 12, 1991: Qeveria Fatos Nano fiton votëbesimin.

Maj 16, 1991: Bashkimi i Sindikatave të Shqipërisë, shpall një grevë të përgjithshme; Bashkimi i Sindikatave të Shqipërisë është një organizëm i ri, krijuar me rënien e komunizmit dhe dallohet si një organizatë antikomuniste; epiqendra e grevës është miniera e qymyrgurit në Valias, por gradualisht shtrihet në të gjithë vendin, duke përfshirë edhe sektorë të tjerë, si transportin dhe arsimin.

Maj 26, 1991: Minatorët e Valiasit futen në galeri dhe shpallin grevë urie.

Sipas Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, deputetët e dalë nga këto zgjedhje janë 250³ dhe përfaqësojnë Partinë e Punës (sot Partia Socialiste), Partinë Demokratike, OMONIA-n dhe Komitetin e Veteranëve.

Zgjedhjet e përgjithshme të 31 marsit 1991

Zgjedhjet e para shumë partiake të 31 marsit 1991 u zhvilluan sipas sistemit mazhoritar, trashëguar nga regjimi komunist, që favorizonte Partinë e Punës, që kishte ende në dorë frenat e pushtetit, mbajtur për 47 vjet me radhë (Tabela 1). Dy partitë e sapokrijuara, Partia Demokratike dhe OMONIA, patën shumë pak kohë për t'u organizuar, ndërkohë që u mungonte përvoja për organizimin e fushatave zgjedhore dhe të vetë procesit zgjedhor. Partia Demokratike e përqendron fushatën në dy drejtime kryesore: antikomunizmi, dhe premtimi për një ekonomi tregu, që do të lulëzonte në mënyrë të menjëhershme. Zëdhënës i kësaj të dytës bëhet Gramoz Pashko, me të famshmin “Çeku i bardhë”.

3 *Shënim:* Në këtë numër përfshihen edhe disa ndryshime bërë gjatë kësaj legjislatore, si rast vdekje ose heqje imuniteti, të cilët janë zëvendësuar me emra të rinj. <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/LigjvenesitNeVite.pdf> Gjetur më 13 gusht 2024.

Tabelë 1: Lista e partive politike përfaqësuese në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë (periudha 15 prill 1991-23 korrik 1997)

Nga data 24 maj 1944 - 13 nëntor 1990	Legjislatura I: 15 prill 1991 - 4 shkurt 1992	Legjislatura II: 4 prill 1992 - 1 korrik 1996	Legjislatura III: 1 korrik 1996 - 23 korrik 1997
1. Partia e Punës (PP) ⁴	1. Partia e Punës (PP): 161 vende 2. Partia Demokratike (PD): 75 vende 3. Komiteti i Veteranëve: 1 vend 4. Omonia: 5 vende	1. Partia Socialiste (ish-PP) 2. Partia Demokratike (PD) 3. Partia Social- Demokrate (PSD) 4. Partia për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (PBDNJ) 5. Partia Republikane (PR)	1. Partia Socialiste (ish- PP) 2. Partia Demokratike (PD) 3. Partia për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (PBDNJ) 4. Partia Republikane (PR)

Pa dalë rezultatet zyrtare, numërimi tregon se Partia e Punës ka fituar zgjedhjet.⁵ Më 1 prill dega e PD-së në Shkodër organizon një miting proteste kundër manipulimit të rezultatit zgjedhor nga PP, megjithëse në Shkodër të gjithë kandidatët e saj për deputetë kishin fituar. Protesta vazhdon edhe të nesërmen, më 2 prill. Demonstruesit i vërsulen godinës së Komitetit të PPSH-së, duke u përleshur me forcat e policisë, ku vriten 4 djem të rinj, nga të cilët njëri ishte aktivist i njohur i PD. Protestat shtrihen në të gjithë vendin

Legjislatura e parë fillon më 15 prill 1991 dhe zgjat për më pak se një vit, deri më 4 shkurt 1992. Kryeministër zgjidhet Fatos Nano. Partia Demokratike e kundërshton rezultatin. Berisha deklaron se zgjedhjet nuk ishin humbje për PD-në, pasi ajo kishte vetëm tre muaj që ishte formuar.

Përballë presioneve, në fillim të qershorit, qeveria e re jep dorëheqjen. Në korrik, pas një debati të hidhur midis njëri-tjetrit, anëtarët e PPSH-së, heqin dorë nga stalinizmi, marksizmi dhe leninizmi dhe e ndryshojnë emrin e partisë së tyre, duke

4 *Shënim:* Fillimisht njihet me emrin Partia Komuniste e Shqipërisë. Në Kongresin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, që zhvillon punimet në Tiranë, më 8-22 nëntor 1948, vendoset ndërrimi i emrit: nga Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSH) në Partia e Punës e Shqipërisë (PPSH). (Burimi: Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë, 1981: f. 245. Tiranë: Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste të PPSH-së.)

5 *Shënim:* Në zgjedhjet e këtij viti, kam qenë anëtare e Komisionit të Qendrës së Votimit që ishte vendosur në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Tiranë. Një mirënjohje për të gjithë anëtarët, për qytetarinë e treguar ato ditë të vështira, kur dukej se normat ishin gjëja e fundit për të cilat mund të flisje! Në kutitë e votimit që numëruam ne, Partia e Punës kishte humbur.

e quajtur Partia Socialiste e Shqipërisë (Kaltsounis, 2013: 29). Presidenti Alia jep dorëheqjen dhe i hap rrugë formimit të një koalicioni qeverisës nën udhëheqjen e kryeministrit, Ylli Bufit. Parlamenti voton që të bëhen zgjedhje të reja të përgjithshme jo më vonë se qershori i 1992-shit me pjesëmarrjen e shumë partive politike.

Kur u përsëritën zgjedhjet në vitin 1992, Partia Demokratike fiton me një shumicë dërrmuese. Kjo nënkupton fundin e sundimit të pandërprerë të komunizmit në Shqipëri që nga viti 1944 dhe fillimin e tranzicionit të vendit drejt kapitalizmit dhe demokracisë.

TRANZICIONI DHE SHQIPËRIA

Në teorinë marksiste, kapitalizmi është faza finale e zhvillimit të shoqërisë përpara kalimit në komunizëm, ky i fundit në gjendje t'i japë fund pabarazive të mëdha shoqërore. Ndonëse askush nuk e mbron më komunizmin, aq më pak "komunizmin" e ndërtuar në Evropën Lindore në kohën e kampit socialist, kjo nuk e zbeh rëndësinë e analizës së këtij regjimi, veçanërisht kur ka qenë në pushtet për afro 50 vjet.

Në regjimin komunist që ka sunduar në Shqipëri në periudhën 1944-1990, marrëdhënia shoqëri-shtet ka vetëm një kahe: nga shteti në shoqëri, ku shteti është ai që konfiguron moralin, grupet, klasat dhe elitat e shoqërisë. Në këtë mision që i vendos vetes, shteti komunist është shumë i kujdesshëm dhe nuk gabon kurrë. Presioni që ushtron është konstant. Kjo marrëdhënie shkatërron, vit pas viti, besimin e publikut tek shteti, dhe bashkë me të edhe shumë nga vlerat morale të tij.

Në rrjedhojë, nëse demokracia është një projekt moral që e ndërmerr një shoqëri për të krijuar një shtet demokratik (Sadiki, 2013:4), në Shqipëri, në vitet 1990, shoqëria kishte domosdoshmërinë për të ndryshuar regjimin, por nuk kishte moralin për të hartuar projektin e një shteti demokratik. Një vend pa traditë demokratike edhe përpara vendosjes së regjimit komunist, me një popullsi të varfër, të izoluar dhe të ndrydhur nga frika e internimit, burgut, torturës apo mos-ekzistencës shoqërore, ku pjesa më e madhe e njihte demokracinë nga sloganet e Frontit Demokratik, pa dizidencë politike – e cila në rastin më të mirë, mund të etiketohet vetëm sporadike dhe e paorganizuar – dhe pa lëvizje sindikale apo grupe liberale, udhëhequr për afro gjysmë shekulli nga një person, një-partiak, është i papërgatitur për një projekt të tillë. Një vend kur për një kohë të gjatë ka munguar fjala e lirë dhe shoqëria civile, ku nuk ka ekzistuar media e pavarur, ndërkohë që

sistemi i informimit ka qenë tërësisht i kontrolluar dhe i censuruar, ku gjithçka ka qenë e politizuar, përfshirë arsimin, ka nevojë për tranzicion.

Teorikisht, tranzicion quhet periudha e kalimit nga një pushtet në një tjetër; është periudha *ndërmjet* e kalimit të çelësave të pushtetit nga një dorë në një tjetër. Tranzicioni demokratik është një periudhë ndryshimesh institucionale, në të cilën normat demokratike imponohen si kriter legjitimues i sjelljes së aktorëve kryesorë të shoqërisë.

Tranzicioni i Shqipërisë nga regjimi diktatorial komunist në demokracinë e tregut të lirë ka qenë i stërzgatur, i komplikuar, i vështirë, ekonomikisht i egër dhe politikisht i pamoralshëm. Sipas Bufit (2016), do të ishte, pa dyshim, edhe një proces relativisht i gjatë. Edhe sot, për më shumë se 30 vjet pas përmbyesjes së regjimit komunist, shumë procese demokratike janë ende në diskutim. Për Schmidt (2015: 39), në një vend demokratik institucionet janë të orientuara nga qytetari, dhe vetë qytetari ka mundësinë të ushtrojë ndikim në politikat publike. I njëjti autor (*Ibid*), pohon se çelësi i suksesit të një demokracie përcaktohet nga tre faktorë: ndarja e pushtetit, transparenca dhe aftësia vetëkorrigjuese e tij.


Duke qenë se në Shqipëri demokracia identifikohet vetëm me institucione burokratike dhe jo me qasje demokratike të të ushtruarit të pushtetit, më korrekte është të vazhdojmë të flasim për tranzicionin në kohën e tashme dhe për demokracinë në kohën e ardhme. Ndërkohë që nuk mund të flitet për transparencë dhe aq më pak për aftësi vetëkorrigjuese. Politikanë pa skrupuj zëvendësojnë të njëjtët politikanë pa skrupuj, në gjendje të mobilizojnë dhe vënë në lëvizje çdo lloj mekanizmi për të mos ikur nga pushteti dhe për të thithur, për interesat e tyre financiare, çdo mundësi që u kalon nëpër duar, nga tenderët e postet për gjithë fisin deri tek gradat e titujt akademikë.

Tranzicioni në Shqipëri ka kaluar në disa faza. Në këtë artikull, si fazë e parë përcaktohet periudha 1992-1997, karakteristikat e së cilës analizohen në dy aspekte: social dhe politik. Në aspektin social, tranzicioni i kësaj faze ka dy karakteristika:

1. ndryshimi i pozicionit social të shtresës së të persekutuarve, përfaqësuar nga ish-kulakët (kryesisht shtresa që mbarimi i Luftës së Dytë Botërore e gjeti të pasur), dhe gjithë ata që u përndoqën nga sistemi për arsye nga më të ndryshmet, nga idetë që mund të kishin deri në hatër mbetje personale
2. lëvizja demografike e lirë, thënë ndryshe zhvendosja masive e popullsisë nga zonat e humbura drejt qytetit dhe, kur ishte e mundur, edhe përtej kufijve territorialë.

Të dyja llojet e lëvizjes demografike ndodhën pothuaj njëkohësisht. Për fat të mirë, 30 vjet pas këtyre lëvizjeve, shoqëria shqiptare ka fituar pjekurinë e duhur dhe është bërë më e hapur. Nga ana tjetër, për shkak të një bumi në turizëm, bazuar kryesisht në projekte individuale, kemi zhvendosje drejt zonave që më parë konsideroheshin si larg hartës së zhvillimit, pra në kahun e kundërt, por pa marrë ende përmasat e një lëvizje demografike.

Karakteristikë kryesore e tranzicionit shqiptar në aspektin politik, në këtë fazë, është formimi i partive të reja, me program dhe ligjërim krejt të ndryshëm nga Partia e Punës, që mbledhin rreth vetes njerëz me sfond social dhe kulturor po aq të ndryshëm (shih Fig. 1). Në këto Parti, që identifikohen kryesisht si të djathta dhe të qendrës, por asnjëherë të majta, kërkojnë strehë njerëzit idealistë, që kanë besim tek ndryshimi, tek reformat, tek vendi. Në vitet e para të jetës së tyre arrijnë t'ia dalin - shndërrohen në stacionin e njerëzve të rinj dhe të mençur. Nga ana tjetër, nuk mund të merrje një post të rëndësishëm në administratën publike pa kaluar më parë nga filtrat e drejtuesve të këtyre partive.



Figurë 1. Numri i partive politike përfaqësuese në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas legjislaturave (24 maj 1944 – 23 korrik 1997)

Këto Parti fituan besimin e publikut, ndiqeshin, dëgjoheshin dhe filluan edhe të votohen. Por mungesa e kulturës së demokracisë e shndërroi angazhimin e tyre nga vlerë për vendin në barrë të rëndë, fillimisht financiare dhe më pas edhe morale. Periudha e tranzicionit përkon me lindjen, rritjen dhe rënien e këtyre organizimeve. Aktualisht kanë humbur mbështetjen popullore dhe janë shndërruar në agjenci punësimi dhe favoresh personale.

Nëse është e vërtetë se mund të themi se kemi dalë nga tranzicioni, pasojat e kësaj periudhe amorge vazhdojnë të ndjehen në të gjithë aspektet e jetës së vendit.

REFERENCA

- Bufi, Y. (2016). *Në fillimet e tranzicionit*. Tiranë: UET Press.
- Deibel, Z. (2019). *Racial Segregation: Plessy v. Ferguson*. New York: Cavendish Square Publishing, LLC.
- Dewey, J. (1903). *Democracy and education*. Chicago: University of Chicago Press.
- Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Report TV. <https://shqiptarja.com/video/32-vjet-me-pare-greva-e-pare-e-pergjithshme-ne-vend-levizja-e-minatoreve-tronditi-eliten-politike-cfare-thoshte-ramiz-alia-ne-vitin-1991> Gjetur mw 21 tetor 2024.
- Forsdyke, S. (2005). *Exile, Ostracism, and Democracy: The Politics of Expulsion in Ancient Greece*. Princeton University Press.
- Giddens, A., Sutton, P.W (2014). *Essential Concepts in Sociology*. Cambridge: Polity Press.
- Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste të PPSH-së (1981). *Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë*. Tiranë: 8 nëntori, botimi i dytë.
- Jitendra Dhopte (2023). *Erosion of Democracy: How to save a dying Democracy?*
- Kagan, D. (1991). *Pericles of Athens and the birth of Democracy*. New York: The Free Press.
- Kaltsounis, T. (2013). *Demokratizimi i Shqipërisë. Demokracia nga brenda*. Përkthyen nga anglishtja Milika Dharmo, Valbona Nathanaili. Tiranë: UET Press.
- Levitsky, S. & Ziblatt, D. (2018) *Si vdesin demokracitë*. Përktheu në shqip: Valbona Nathanaili. Prishtinë: Pema.
- Sadiki, L. (2013). The Void of Power and the Power of Void. Arab Societies' negotiation of democratic *faragh*. In Sadiki, L., Wimmen, H. & Zubaidi, L. Al. (Eds.). *Democratic Transition in the Middle East: Unmaking Power*. New York: Routledge.

- Schmidt, M.G. (2015). Public Policy in autocracies and democracies. Në Croissant, A., Kailitz, S., Koellner, P. & Wurster, S. (Eds.). *Comparing autocracies in the early Twenty-first Century: Vol 2: The performance and persistence of autocracies*. London and New York: Routledge, ff. 39-56.
- Sen, A. (2011). *Zhvillimi si liri*. Shqip: Nathanaili, V. dhe Verteniku, T.; Tiranë: UFO Press.
- Stenner, D. (2024). Fjala e mbajtur në ceremoninë e hapjes, në konferencën “Teacher education research in Europe: trends, challenges, practices and perspectives”, ATEE Spring Conference 2024, organizuar nga Dipartimento di Scienze Umane e Sociali, University of Bergamo, CQIIA – Centro per la Qualità dell’Insegnamento, dell’Innovazione didattica e dell’Apprendimento, University of Bergamo, ATEE – Association for Teacher Education in Europe.

PUSHTETI I SHUMICËS OSE I POPULLIT OSE DEMOKRACIA

Demokracia bazohet mbi kontrollin e aparatit të pushtetit nga të kontrolluarit, dhe nëpërmjet kësaj pakëson nënshtrimin (që shkaktohet kur një pushtet nuk pëson reagimin e atyre që ai nënshtron); në këtë kuptim, demokracia është më tepër sesa një regjim politik; është rigjenerim i vazhdueshëm i një marrëdhënieje dyshe, komplekse dhe retroaktive: qytetarët prodhojnë demokracinë që prodhon qytetarët.

Edgar Morine: “Shtatë dijet e nevojshme për edukimin e së ardhmes” (1999)

Fjala ‘demokraci’ rrjedh nga ‘demos’ - ‘popull’ dhe ‘cratos’ - ‘pushtet’. Teorikisht, kur flasim për demokracinë, nënkuptojmë se një grup njerëzish kanë besimin e shumicës të udhëheqin e të marrin vendime në emër të saj. Por termi i përdorur shpesh ka konotacione interpretuese, se nga çfarë lloj kohe buron dhe si u përdor nga njerëzimi si kahje përmbysëse në rastin e revolucioneve dhe konotacion krejt tjetër në kohën kur lulëzojnë dhe udhëheqin elitat në shoqëri.

Apo në rastin ku vetë ky pushtet kriptohet dhe sjell zhvillime të sforcuara nga shkaqe të ndryshme që sjell vetë termi në këto sisteme. Prandaj kemi një rrjedhë të përpjekura të njerëzimit në një monolog frymëmarrjeje jo gjithherë si një vlerë e shtuar e tij por si një antagonizëm që së shumti u përlesh me kuptimin dhe moskuptimin e vet historik.

Në kohërat e lashta në grupimet e para të shtet-formimit funksiononin bashkësitë në formë elitash që më vonë u përkthyen në një organ kolegial siç ishin kuvendet apo qendrat ku mbaheshin ligjëratat e elitave që herë në një mostikë të lartë e herë më vonë në një elokuencë pushtetesh nga poshtë lart shprehnin të gjitha aftësitë justifikuese të politik-bërjes në sisteme të përafërta, që në një

farë mënyre i drejtoheshin një vullneti të shumicës brenda elitave që jepnin udhë rregullave dhe ligjësi në një shoqëri. Pra në kohërat e lashta qeveria zgjidhej nga elitat e shoqërisë duke ia ngarkuar atyre që kishin virtytet e duhura për ta mbajtur barrën e qeverisjes.

Ndërsa sot njihet dhe si diktatura e shumicës, sepse shumica në kohën e sotme, veçanërisht të medias, udhëhiqet nga dëshirat dhe opinionet klishe. Në të vërtetë, njerëzit që dinë dhe janë të kulturuar janë në pakicë.

Çfarë ndodh konkretisht, sot, në shoqërinë shqiptare? Njerëzit ende janë të prirur jo drejt një baraspeshe konkurruese por orientohen emocionalisht dhe shpesh edhe nga faktorë të ngushtë, interesi të vogël, duke mos kuptuar se një shoqëri vitalizohet nga konkurrenca e lirë e ideve dhe prirjeve për një zhvillim në favor të shoqërisë dhe jo në lloj pragmatizmi të ngushtë interesi qoftë dhe vetjak që e çon shoqërinë dita më ditë në një kënetë e krizë vlerash. Një mendje-hapur duhet të vijë në shoqëri si kontribut i lartë konkurrues për ta lëvizur shoqërinë e shpërgjukur dhe renditur në një rend të ri vlerash jo vetëm brenda saj por në një rreth të pakufizuar nga shumë nocione penguese.

Shoqëritë kanë nevojë të kryejnë metabolizmin e tyre ciklik në raport me elitat, me mendjet që e tejkalojnë urinë e përditshme të turmës apo të popullit, si një cikël që risillet në formë rrethi, por në një stad më të lartë seç ndodhej më parë.

Vini re me historinë më të afërt tonën. Dolëm nga një sistem diktatorial e mono-partiak në një sistem të pluralizmit politik dhe të lirisë së shprehjes.

Sot mbas gati tre dekadave gjendemi nga njëherë si një popull që nuk diti të menaxhojë lirinë e vet se për shkak të zhvillimeve të shpejta jo të gjithë kryen metabolizmin e duhur kulturor dhe politik dhe për këtë shkak liria kushton është e rëndë dhe shpesh për shkaqe konkurrence të risillet si diktat që duhet tejkaluar me çdo çmim por jo gjithherë ndodh. Shoqëritë kanë konvulsionet e tyre dhe ciklet që e vejnë një komb e një shtet në një rend të përparuar dhe të integrueshëm.

Në asnjë lloj materieje nuk kemi një demokraci të kulluar në vlerë as në art nuk ndodh pasi që e gjithë historian a tregon se çdo materie zhvillohet mbi shpatullat e mbivendosjes së njëra tjetrës herë si rrethciklim e herë si antagonizëm përjashtues por gjithsecila zhvillohet dhe lë gjurmën e vet në kohë që në formë lineare ngritërgjimin e shkaqeve të kundërta që në shumë raste përmbajnë në vetvete radhën. Lineare të historisë së shkruar.

Njerëzimin e udhëheqin herë elitat e herë individë për shkak të gjenisë e talentit të tyre apo për shkak se janë të parakohshëm në kohët që lindin dhe sjellin zhvillimin e shoqërisë. Vetë shoqëria ka aftësinë të eksperimentohet në një dyluftim të pashmangshëm të mohimit dhe pohimit të saj.

KËTU, NË SHQIPËRI...

Në historinë e njerëzimit, pak periudha mund të krahasohen me madhësinë dhe arritjet e shekullit V p.e.s. të athinasve nën udhëheqjen e Perikliut!

Donald Kagan: "Pericles of Athens and the Birth of Democracy" (1991:3)

"Këtu, në Athinë, ne bëjmë këtë: qeveria jonë favorizon shumicën në vend të pakicës, dhe për këtë arsye quhet demokraci.

Këtu, në Athinë, ne bëjmë këtë: ligjet sigurojnë drejtësi të barabartë për të gjithë në mosmarrëveshjet e tyre private, por kurrë nuk i shpërfillim meritat e përsosmërisë. Kur një qytetar dallohet, atëherë ai thirret, në përparësi ndaj të tjerëve, për t'i shërbyer shtetit, por jo si akt privilegji, por si shpërblim për meritat - varfëria nuk është pengesë për këtë.

Këtu, në Athinë, ne bëjmë këtë: liria që gëzojmë shtrihet edhe në jetën e përditshme; ne nuk jemi dyshues ndaj njëri-tjetrit dhe nuk e shqetësojmë kurrë fqinjin, nëse fqinjit i pëlqen të jetojë sipas mënyrës së tij. Jemi të lirë! Të lirë të jetojmë ashtu si duam, ndërkohë që gjithmonë jemi të gatshëm të përballemi me çdo rrezik. Një qytetar athinas nuk i neglizhon çështjet publike kur ka çështje private, dhe mbi të gjitha nuk merret me punët publike si arsye për të zgjidhur çështjet e tij private.

Këtu, në Athinë, ne bëjmë këtë: jemi mësuar të respektojmë gjyqtarët, ndërkohë që jemi mësuar të respektojmë edhe ligjet, dhe të mos harrojmë kurrë se duhet të mbrojmë të dëmtuarit. Jemi mësuar, gjithashtu, të respektojmë ato ligje të pashkruara që qëndrojnë në ndjenjën universale të asaj që është e drejtë dhe çfarë është arsyeja e shëndoshë.

Këtu në Athinë ne bëjmë këtë: Ne nuk e konsiderojmë të padëmshëm një njeri që nuk është i interesuar për shtetin, por të padobishëm; dhe megjithëse të paktë janë në gjendje t'i japin jetë një politike, të gjithë këtu në Athinë jemi në

gjendje ta gjykojmë atë. Ne nuk e konsiderojmë diskutimin si pengesë në rrugën e demokracisë. Ne besojmë se lumturia është fryt i lirisë, por liria është vetëm fryt i vlerës...”

Sa më sipër është fjalimi drejtuar athinasve, në vitin 461 p.e.s nga Perikliu, personifikimi i udhëheqësit të atij sistemi politik që të gjithë e njohim me emrin “DEMOKRACI”.

Pasi lexon këtë fjalim me të drejtë shumëkush mund të pyes: A ishte vërtetë e përsosur demokracia në Athinë? Kur dëgjojmë sot për “shtete demokratike”, “qeveri demokratike”, “sistem demokratik”, do të thotë që në këta shtete përjetohet tabloja e sipër përshkruar?

Jo!

Por i vetëdijshëm që kjo “jo” ngjan aspak demokratike, për ta bërë sa më shumë të tillë, do tentoj argumentin. Nuk dua të jem as absolutist, as totalitar dhe aq më pak diktator!

Demokracia në Athinë, që nëse do e përfshinim në katalogimet bashkëkohore do bënte pjesë tek modelet me demokraci direkte, nuk ishte ajo e përshkruar më sipër dhe shkaqet për të pohuar diçka të tillë janë të shumta, por duke qenë se analiza do kërkonte një libër më vete, shumë sipërfaqësisht po përpiqem të përgjigjem mundësisht përmes shembujve më domethënës.

Akoma, demokracia në Athinë nuk ishte ajo e përshkruar më sipër pasi fatkeqësisht mjaftuan veç 62 vite që ky sistem kaq i përsosur në letër dhe në fjalimet e Perikliut, të manifestonte dobësitë e mëdha që e karakterizonin teksa shumica e athinasve vendoste në mënyrë shumë “Demokratike” të madhin e të mëdhenjve, babain e filozofisë, Sokratin. Por si u arrit deri në këtë rezultat tragjik? Mbase përgjigjen mund ta gjejmë në një shembull të shkëlqyer që filozofi i madh merrte për të ilustruar mendimin e tij, me një anije që e gjendur në mes të një stuhie në rrezik të mbytej, në një rast të tillë pyeste filozofi, ka më vlerë vendimi i shumicës së pasagjerëve apo vendimi i kapitenit të anijes? Le të tentojmë tani të kapemi pas kësaj pyetje që përgjigjen e ka të nënkuptuar, për t’u katapultuar në të tashmen, në shpresën për t’u dhënë shpjegimet e mundshme pyetjeve të ngritura në fillim të këtij shkrimi.

Demokracitë moderne nuk diskutohet që ngjajnë pak ose aspak me atë athinase. Së pari, për faktin se përjashtuar atë që njihet si modeli zviceran, ku vihet re një formë e zbehtë e demokracisë direkte, në gjithë rastet e tjera kemi të bëjmë me demokracinë përfaqësuese, në të cilën, përjashtuar një ditë në katër apo pesë vite kur vendos populli, pjesa tjetër është gati një lotari. Kjo dhe për faktin se

gjithmonë dhe më shumë sistemi elektoral i aplikuar është ai proporcional me lista të mbyllura, atëherë fat të mbarë, pasi dhe atëherë në 4 a 5 vite që ti vendos, nuk është aq qartë se për çfarë dhe në favor të kujt ke vendosur, pra të thuash që kemi të bëjmë me pushtet të popullit nevojitet që dashamirësia, por pse jo dhe fantazia të jenë në nivele të kënaqshme.

Por unë nuk jam çmendur ende - për fat të mirë - që pasi të citoj fjalimin brilant të të madhit Perikli të përmbys gjithçka duke e pikturuar demokracinë si diçka jo e mirë për shoqërinë. Bota vazhdimisht ka nxjerrë mendje të shkëlqyera dhe një prej tyre do thërras në ndihmë këtë çast, për të dalë nga ky bataku ku u futa, bëhet fjalë për Winston Churchill që me mënyrën e tij tërësisht pragmatiste dhe aspak të mitizuar, bëri “mbrojtjen” më të saktë të mundshme të demokracisë kur u shpreh se:

Shumë forma të qeverisjes janë provuar dhe do sprovohen në këtë botë të mëkatit dhe të mjerimit. Askush nuk pretendon se demokracia është e përsosur apo gjithëpërfshirëse. Në të vërtetë është thënë se demokracia është forma më e keqe e qeverisjes, përveç të gjitha atyre formave të tjera që janë provuar ndër kohëra.

REFERENCA

Kagan, D. (1991). *Pericles of Athens and the Birth of Democracy*. New York: Free Press.

EDGAR MORINE

United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization

Përktheu nga frëngjishtja: Blerta HYSKA

QYTETARËT PRODHOJNË DEMOKRACINË QË PRODHON QYTETARËT

Demokracia nuk është e thjeshtë për t'u përkufizuar. Sovraniteti i popullit qytetar përmban në të njëjtën kohë vetëkufizimin e këtij sovraniteti nëpërmjet bindjes ndaj ligjeve dhe transferimin e sovranitetit tek të zgjedhurit. Demokracia përmban në të njëjtën kohë vetëkufizimin e veprimeve të shtetit nëpërmjet ndarjes së pushteteve, garantimit të të drejtave individuale dhe mbrojtjes së jetës private. Demokracia ka sigurisht nevojë për konsensusin e shumicës së qytetarëve dhe për respektimin e rregullave demokratike. Por, bashkë me konsensusin, ka nevojë për antagonizëm dhe diversitet.

Përvoja me totalitarizmat ka nxjerrë në pah një karakter kyç të demokracisë: lidhjen e saj vitale me diversitetin. Demokracia supozon dhe ushqen diversitetin e interesave si edhe diversitetin e ideve. Respektimi i diversitetit do të thotë, që demokracia nuk mund të identifikohet me diktaturën e shumicës mbi pakicat; ajo duhet të përmbajë të drejtat e minoriteteve dhe protestuesve ndaj ekzistencës dhe shprehjes, ajo duhet të lejojë shprehjen e ideve heretike dhe devijante. Ashtu siç duhet të mbrojmë larminë e llojeve për të shpëtuar biosferën, ashtu duhet të mbrojmë edhe larminë e ideve dhe opinionëve, të burimeve të informacionit (shtypi, media) për të shpëtuar demokracinë.

Në të njëjtën kohë, demokracia ka nevojë për konflikt idesh dhe opinionesh; ato i japin jetë dhe produktivitet. Por vitaliteti dhe produktiviteti i konflikteve mund të zhvillohen vetëm në bindjen ndaj rregullit demokratik, i cili i rregullon antagonizmat duke zëvendësuar betejat fizike me beteja idesh; ku

rregulli vendos nëpërmjet debateve dhe zgjedhjeve, fituesin e përkohshëm të ideve në konflikt, i cili, në këmbim, ka përgjegjësi të japë llogari për zbatimin e ideve të tij.

Pra, duke kërkuar në të njëjtën kohë konsensusin, larminë dhe konfliktualitetin, demokracia është një sistem kompleks organizimi dhe qytetërimi politik, që ushqen dhe ushqehet nga autonomia e shpirtit të individëve, nga liria e tyre e opinionit dhe shprehjes, nga qytetaria e tyre, që ushqen dhe ushqehet nga ideali Liri, Barazi dhe Vëllazërim, një sistem që përmban një konfliktualitet krijues ndërmjet këtyre termave të pandashëm.

Demokracia është një sistem politik kompleks në kuptimin që ajo jeton prej pluralitetit, konkurrencës dhe antagonizmit, duke qenë në të njëjtën kohë një komunitet. Demokracia është bashkim i bashkimit me ndarjen; ajo toleron dhe ushqehet në mënyrë endemike, ndonjëherë edhe në formë shpërthyes nga konflikte që i japin më shumë jetë. Demokracia jeton nga pluraliteti, madje edhe në majat e shtetit (ndarje e pushteteve ekzekutiv, legjislativ, gjyqësor) dhe duhet të mirëmbajë këtë pluralitet për të mirëmbajtur veten.

Demokracia mundëson marrëdhënien e pasur dhe komplekse individ - shoqëri ku individët dhe shoqëria mund të ndihmojnë, të zhvillojnë, të rregullojnë, të kontrollojnë njëri-tjetrin. Demokracia bazohet mbi kontrollin e aparatit të pushtetit nga të kontrolluarit, dhe nëpërmjet kësaj pakëson nënshtrimin (që shkaktohet kur një pushtet nuk pëson reagimin e atyre që ai nënshtron); në këtë kuptim, demokracia është më tepër sesa një regjim politik; është rigjenerim i vazhdueshëm i një marrëdhënieje dyshe, komplekse dhe retroaktive: qytetarët prodhojnë demokracinë që prodhon qytetarët.

Në dallim nga shoqëritë demokratike, që funksionojnë falë lirive individuale dhe përgjegjshmërisë së individëve, shoqëritë autoritare ose totalitare kolonizojnë individët që janë subjekte të tyre, në kuptimin “të nënshtruar”; në demokraci, individi është qytetar, subjekt në kuptimin autonom të termit, njeri, që nga njëra anë shpreh dëshirat dhe interesat e tij, dhe nga ana tjetër, është përgjegjës dhe solidar me qytetin e tij.

Demokratizimi i shoqërive perëndimore ka qenë një proces i gjatë dhe është zhvilluar në mënyrë të çrregullt në disa fusha, si: arritja e barazisë grua burrë në çift, në punë, aksesit në karrierat publike. Socializmi perëndimor nuk ka arritur të demokratizojë organizimin ekonomik/social të shoqërive tona. Ndërmarrjet mbeten sisteme autoritare hierarkike, të demokratizuara shumë pak vetëm në bazë, ku veprojnë këshillat dhe sindikatat. Është e sigurt, se ka kufizim të demokracisë në vendet ose në organizatat ku efikasiteti bazohet mbi bindjen, si ushtria.

Por disa ndërmarrje kanë zbuluar, se mund të arrihet efikasiteti, edhe nëpërmjet iniciativës dhe përgjegjësisë së individëve ose grupeve. Gjithsesi, demokracitë tona kanë mangësi dhe të meta. Për shembull, qytetarët nuk pyeten për alternativat në fushën e transportit (TGV, avionë, autostrada etj.). Por nuk është fjala vetëm për mosrealizimet demokratike. Ka edhe procese regresive demokratike, që prirën t'u heqin qytetarëve të drejtën e marrjes së vendimeve të mëdha demokratike (me pretekstin se këto vendime janë shumë të “ndërlikuara” dhe duhet të merren nga “ekspertët”), të cungojnë kompetencat e tyre, të kërcënojnë diversitetin, të degradojnë liritë civile. Këto procese regresioni shkaktohen nga shkalla e lartë e kompleksitetit të problemeve dhe nga mënyra cinguese e trajtimit të tyre. Politika copëzohet në fusha të ndryshme dhe, mundësia për t'i rrokur të gjitha, zvogëlohet ose zhduket përfundimisht. Në të njëjtën kohë, kemi ç'politizim të politikës që shkrihet në administratë, në teknikë (ekspertiza) në ekonomi, në mendimin kuantifikues (sondazhe, statistika).

E ARDHMJA E DEMOKRACISË

Demokracitë e shekullit XXI do të përballen gjithnjë e më shumë me një problem gjigandesk, të lindur nga zhvillimi i një makine të madhe, ku lidhen ngushtë shkenca, teknika, dhe burokracia. Kjo makinë e madhe nuk prodhon vetëm dije dhe ndriçim mendjesh, ajo prodhon edhe injorancë dhe verbim. Zhvillimet disiplinore të shkencave nuk sollën vetëm avantazhet e ndarjes së punës; sollën edhe problemet e mbispecializimit, të izolimit dhe copëzimit të dijes. Kjo e fundit u bë gjithnjë e më shumë ezoterike, (e mundshme vetëm për specialistët) dhe anonime (e përqendruar nëpër banka të dhënash dhe e përdorur nga instanca anonime, ku i pari është shteti). Po ashtu, dija teknike u rezervohet ekspertëve, kompetenca e të cilëve, në një fushë të mbyllur, shoqërohet me mungesë të kompetencës, nëse kjo fushë ndikohet nga jashtë ose ndryshohet nga një ngjarje e re.

Në kushte të tilla, qytetari humbet të drejtën për dije. Ai ka të drejtën të përftojë një dije të specializuar duke kryer studime *ad hoc*, por nuk ka mundësinë e një këndvështrimi të përgjithshëm dhe të saktë. Për shembull, qytetari nuk ka asnjë mundësi të kontrollojë ose të japë mendim për armën bërthamore. Përdorimi i saj vendoset vetëm nga kryetari i shtetit, pa u konsultuar me asnjë instancë të rregullt demokratike. Sa më shumë politika bëhet teknike, aq më shumë regres pëson kompetenca demokratike.

Problemi nuk ngrihet vetëm për luftën ose krizën. Por edhe në jetën e përditshme: zhvillimi i tekno-burokracisë ka vendosur mbretërimin e ekspertëve në të gjitha fushat, që deri atëherë, vareshin nga diskutimet dhe vendimet politike. Më në thellësi, po rritet hendeku midis një tekno-shkence ezoterike, shumë të specializuar dhe qytetarëve, po rëndohet dualiteti ndërmjet njohësve - njohja e të cilëve është e copëzuar, e paafte të kontekstualizojë dhe globalizojë – dhe injorantëve, domethënë bashkësisë së qytetarëve. Në këtë mënyrë, krijohet një frakturë e re sociale ndërmjet “klasës së re” dhe qytetarëve. I njëjti proces po ndodh, edhe në aksesin ndaj teknologjive të reja të komunikimit, ndërmjet vendeve të pasura dhe të varfra.

Qytetarët i kanë larguar nga fushat politike, të cilat janë zaptuar gjithnjë e më shumë nga “ekspertët” dhe dominimi i “klasës së re” po pengon demokratizimin e dijeve. Në këto kushte, thjeshtimi i politikës tek teknikja dhe ekonomikja, thjeshtimi i ekonomikes të rritja, humbja e pikave orientuese dhe e horizonteve, e gjithë kjo shkakton dobësimin e civizmit, arratisjen dhe mbylljen në jetën private, ndryshimin e vendeve ndërmjet apatisë dhe revoltave të dhunshme. Pra, edhe pse vazhdojnë institucionet demokratike, jeta demokratike po venitet.

Në këto kushte, para shoqërive të ashtuquajtura demokratike, shtrohet nevoja për të rigjeneruar demokracinë, ndërsa në një pjesë të madhe të botës shtrohet problemi i vendosjes së demokracisë. Planeti kërkon të gjejme një mundësi të re demokratike planetare.

REFERENCA

Morine, E. (2015) *Shtatë dijet e nevojshme për edukimin e së ardhmes*. Përktheu në shqip Blerta Hyska. Tiranë: UET Press.

DR. GHASSAN KHALILI

UNICEF (*United Nations International Children's Emergency Fund*) Greqi

Përktheu nga anglishtja: Valbona NATHANAILI

NË VEND TË EPILOGUT: PËR NJË SHOQËRI QË RESPEKTON TË DREJTAT E FËMIJËVE

“QENDRAT PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE” NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

“Qendrat për të drejtat e fëmijëve” themeluar pranë universiteteve janë një instrument shumë i mirë për të promovuar demokracinë në shoqëri. Qendrat mbështeten në një qasje që inkurajon universitetet të jenë më energjikë dhe më përfshirës në lidhje me të drejtat e fëmijëve, ndërkohë që u mundësojnë të përhapin dijet përtej mureve të tyre. Në këtë mënyrë, universitetet shndërrohen në një institucion social, një institucion që promovon vlerat e të drejtave të fëmijëve dhe të drejtave të njeriut dhe ndikon shoqërinë.

“Qendrat për të drejtat e fëmijëve” themeluar pranë universiteteve mbështeten në tre shtylla strategjike: 1. Promovimi i të Drejtave të Fëmijëve; 2. Qasja bazuar në kërkimin shkencor; 3. Përfshirja e të drejtave të fëmijëve në kurrikul.

PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Shtylla e parë strategjike e “Qendrave për të drejtat e fëmijëve” është promovimi i të drejtave të fëmijëve, që do të thotë koordinim ndërmjet shkollave, bashkive dhe drejtuesve të komuniteteve me njëri-tjetrin, për t’u siguruar se fëmijët në shkollë

i njohin të drejtat e tyre, dhe se mësuesit dhe drejtuesit e menaxherët e shkollave janë krejtësisht të ndërgjegjshëm për të drejtat e fëmijëve. Kjo do të thotë se çdo shkollë është gati të përqafojë një kulturë më të fuqishme për të drejtat e fëmijëve dhe të zbatojë të drejtën e pjesëmarrjes, një nga katër parimet e përgjithshme të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Kjo është arsyeja pse “Qendrat për të drejtat e fëmijëve” kanë një rol vendimtar në promovimin dhe shpërndarjen e të drejtave, si dhe në trajnimin e mësuesve dhe drejtuesve të shkollave në respektimin e këtyre të drejtave.

QASJA BAZUAR NË KËRKIMIN SHKENCOR

Shtylla e dytë strategjike e “Qendrave për të drejtat e fëmijëve” është qasja bazuar në kërkimin shkencor. Të dhënat e gjeneruara nga universitetet për situatën e fëmijëve sigurojnë qeverinë dhe parlamentin të marrin vendime dhe hartojnë një kuadër ligjor bazuar në njohuritë e ofruara nga qendrat për të drejtat e fëmijëve në universitete. Akoma, duke qenë se këto qendra kanë shtrirje rajonale - kjo do të thotë se janë themeluar në zona të ndryshme të një vendi të caktuar - sa herë që Parlamentit do t’i duhet informacion, qendrat do të mund ta furnizojnë me të dhëna të detajuara, që pasqyrojnë në mënyrë të qartë situatën e fëmijëve në atë zonë.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për qeverinë! Sa herë që t’i lindë nevoja të marrë një vendim që lidhet me fëmijët, qendrat për të drejtat e fëmijëve janë të gatshme të ofrojnë informacionin e duhur, në gjendje t’i mundësojë qeverisë të marrë vendime të informuara. Kjo është në përputhje me një jetë të shëndetshme demokratike, sepse informacioni do të bazohet në zërat e fëmijëve për qasjen ndaj komunitetit dhe realitetit që siguron ai, në kohë reale dhe në formën e një informacioni shumë të saktë.

PËRFSHIRJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË KURRIKUL

Shtylla e tretë strategjike e “Qendrave për të drejtat e fëmijëve” është përfshirja e të drejtave të fëmijëve në kurrikulën universitare. Duke vepruar në këtë mënyrë, kemi mundësinë të sigurohemi se profesionistët e ardhshëm janë të ndërgjegjshëm për të drejtat e fëmijëve. Të përgatisësh një mësues me qasjen bazuar në të drejtat e fëmijëve me mbarimin e programit të studimit të universitet është thelbësore për

të drejtat e fëmijëve; të kesh një punonjës social që është i armatosur me qasjen bazuar në të drejtat e fëmijëve është thelbësore për të arritur më të mirën në interes të fëmijës përmes praktikës së punonjësit social; të kesh një gjykatës që njeh të drejtat e fëmijëve është thelbësore për t'u siguruar se vendimet tradicionale do të merren në interesin më të mirë të fëmijës.

Përfshirja e të drejtave të fëmijëve në kurrikulën universitare është jashtëzakonisht e rëndësishme, sepse është një mënyrë shumë e mirë për të njohur një nga parimet e përgjithshme të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, sikundër është mosdiskriminimi, një parim që ka shërbyer për përsosjen e nenit 2 të saj; për të kuptuar se cilat janë interesat më të mira të fëmijës, të cilat ne i gjejmë një nenin 3 të konventës; për t'u ndërgjegjësuar për të drejtat për të jetuar, për mbijetesë dhe zhvillim, të cilat ne i gjejmë në nenin 6; për të mbështetur dhe iniciuar të drejtën e pjesëmarrjes të fëmijëve, që e gjejmë në nenin 12 të konventës, mbështetur nga nenet 13 dhe 17. Kurset universitare që kanë të përfshirë të drejtat e fëmijëve janë një pikë referimi për forcimin e kulturës demokratike në universitet, që do t'i ndihmojë studentët të kuptojnë më mirë praktikat demokratike, si dhe të ndërgjegjësohen se praktikat demokratike, që të jenë të qëndrueshme në shoqëri, kanë nevojë të nisin të mësohen e ushtrohen që në fëmijëri.

E drejta e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe e drejta për të shprehur pikëpamjet e tyre është e sanksionuar në nene të ndryshme të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (nenet 12, 15, 31). Është në thelb një e drejtë dhe një proces në të cilin fëmijët shihen si kontribues aktivë dhe jo si marrës pasivë të mbrojtjes dhe kujdesit të të rriturve. Pjesëmarrja efektive e fëmijëve dhe të rinjve është shumë më tepër sesa thjesht konsultim me fëmijët dhe të rinjtë: ajo nënkupton angazhimin për të njohur fëmijët dhe të rinjtë si qytetarë aktivë dhe për t'u ofruar atyre mbështetjen e duhur për të zhvilluar aftësitë e nevojshme për të marrë pjesë në çështjet sociale, kulturore, ekonomike dhe jetën politike. Në këtë kontekst, pjesëmarrja aktive e fëmijëve dhe të rinjve promovohet nga UNICEF si një strategji kyçe në të gjitha fazat e programeve të organizatës.

KONKLUSIONE

“Qendrat për të drejtat e fëmijëve” kanë një rol të rëndësishëm në promovimin e të drejtave të fëmijëve në shkolla, në qytete dhe në fshatra. I gjithë procesi është i dyanshëm, që do të thotë se nga njëra anë fëmijët bëhen mbajtës të të drejtave dhe, nga ana tjetër, bartësit e detyrës ndërgjegjësohen plotësisht për të drejtat e fëmijëve.

Ky ndërveprim ndërmjet bartësve të të drejtave dhe bartësve të detyrës krijon një dinamikë të re të demokracisë, e cila pasohet me praktika më të shëndetshme demokratike në shoqëri dhe me një të ardhme më të ndritur. E njëjta gjë vlen edhe për kërkimet shkencore që kryhen nga “Qendrat për të drejtat e fëmijëve”, që forcojnë kulturën e të dëgjuarit të zërit të fëmijëve, ndërkohë që nëpërmjet shtyllës së tretë, përfshirja e të drejtave të fëmijëve në kurrikulat e universiteteve, sigurohemi që profesionistët të promovojnë dhe zbatojnë parimet e të drejtave të fëmijëve.

“Qendrat për të drejtat e fëmijëve” në universitete, mbështetur nga të gjithë fakultetet përkatëse, përbëjnë një mundësi të vlefshme për të forcuar hapjen e tyre ndaj shoqërisë, si dhe për të qenë më energjikë jo vetëm në analizën e fenomeneve që e shqetësojnë këtë shoqëri, por edhe në përhapjen e njohurive përtej mureve të kampusit. Universitetet janë në pozitë unike për të shpërndarë njohuri për të drejtat e fëmijëve përtej dhomave tradicionale të mësimi të studentëve, si dhe të ndihmojnë në krijimin e një kulture më të fortë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në shoqëri.

Libra të tjerë nga Valbona Nathanaili (autor i vetëm dhe bashkautor)

- (2021, maj) *Edukimi Liberal, si qasje dhe praktikë* (Së bashku me Martha Nussbaum dhe Steve Fuller) Tiranë: Fondacioni “Henrietta Leavitt”, ISBN 978-9928-4543-6-2
- (2016, mars) *Rruga e mundimshme e shkollës shqipe* Tiranë: UET Press. ISBN 978-9928-1906-8-0
- (2015, maj) *Arsim para-universitar 2015+*. (Së bashku me Tomi Treska, Ylljet Aliçka, Edi Puka, Mateo Spaho). Tiranë: UET Press.
- (2014, shtator) *Ambasadorët tanë. Pikëtakime të diplomacisë me krijimtarinë*. Tiranë: UET Press. ISBN 978-9928-1900-6-2
- (2013, dhjetor) *Arsim dhe pabarazi. Sfidat e perceptimit ndryshe*. Tiranë: UET Press. ISBN 978-9928-4193-3-0
- (2013, tetor) *Fizika 11 (si lëndë me zgjedhje)*. Për mësuesit e fizikës së klasës së 11-të. Tiranë: PEGI.
- (2011, dhjetor) *Reforma dhe legjislacioni (arsimi para-universitar). Çështje, praktika & politika. Rasti shqiptar*. Tiranë: AU Press.
- (2010) *Albania Rock: Dokumenta politikë, zona europiane e arsimit të lartë*. Tiranë: AU Press.

Libra, përpiluar nga Valbona Nathanaili

- (2024, nëntor) *Çfarë është demokracia?* Antologji. Tiranë: Kolegji Universitar “LOGOS”
- (2019, nëntor) *Komercializimi i shkollimit*. Antologji. Elbasan: Fondacioni “Henrietta Leavitt”, ISBN 978-9928-4543-3-1

Libra përkthyer nga Valbona Nathanaili (punë vetëm ose në grup)

- (2024) *Si ia dalin fëmijët. Grinta, kureshtja dhe fuqia e padukshme e karakterit* Autor: Paul Tough. Prishtinë: Pema.
- (2023) *11 mësimet për jetën nga Nelson Mandela*. Autor: Ndaba Mandela. Prishtinë: Pema, ISBN 978-9951-846-19-6
- (2022) *Zgjedhja. Të përqafosh të pamundurën*. Autor: Edith Eger. Prishtinë: Pema, ISBN 978-9951-817-42-4
- (2021, shtator) *Maradona: Dora e Zotit*. Autor: Jimmy Burns. Tiranë: "H. Leavitt" Foundation, ISBN 978-9928-4543-7-9
- (2020) *Elementi, si ta gjesh pasionin për të ndryshuar gjithçka*. Autor Ken Robinson. Prishtinë: Pema, ISBN 978-9951-721-99-8
- (2020, nëntor) *Çfarë është jeta*. Autor: Erwin Shrodinger. Tiranë: "H. Leavitt" Foundation, ISBN 978-9928-4543-4-8
- (2019) *Një dëshirë për Krishtlindje* Tiranë: "H. Leavitt" Foundation, ISBN 978-0028-4543-1-7
- (2019, mars) *Pesë pengjet më të mëdha të jetës. Transformimi që pëson jeta nga ikja e njerëzve të dashur*. Autor Bronnie Ware. Tiranë: "H. Leavitt" Foundation, ISBN 978-9928-4543-0-0
- (2018) *Si vdesin demokracitë*. Autorë: Steven Levitsky & Daniel Ziblatt. Prishtinë: Pema, ISBN
- (2018) *Konfuci nga zemra. Mençuria e lashtësisë për botën e sotme*. Autor: Yu Dan. Tiranë: Minerva ISBN 978-9928-4440-8-0
- (2018) *Rregulloni krevatin: Gjëra të vogla që mund t'ju ndryshojnë jetën... dhe ndoshta botën*. Autor: William H. McRaven (U.S. Navy Retired). Tiranë: Minerva, ISBN 978-9928-4440-6-6
- (2017) *Mendësia*. Autor Carol Dweck. "Pema", Kosovë, ISBN 978-9951-72-145-5
- (2017) *Ngritja dhe rënia e kombeve: Forcat e ndryshimit në botën pas-krizë*. Ruchir Sharma. Prishtinë: "Pema", Kosovë, ISBN 978-9951-72-139-4
- (2016) *Fjalimet TED*. Chris Anderson. Prishtinë: "Pema", Kosovë, ISBN 978-9951-72-121-9
- (2013, korrik) *Demokratizimi i Shqipërisë. Demokracia nga brenda*. (Së bashku me Milika Dhamo). Autor: Theodore Kaltsounis. Tiranë: UET Press, ISBN 978-99956-36-90-7
- (2013, prill) *Pasojat e modernitetit*. (Së bashku me Fatos Tarifa & Bleriana Bino). Autor: Anthonny Giddens. Tiranë: UET Press, ISBN 978-99956-39-67-9.
- (2011, nëntor) *Drejtori i shkollës i shek XXI. Çështje aktuale të lidërshit dhe të politikës*. Autorë: Pierce & Stapleton. Tiranë: UFO Press, ISBN 978-9928-127-02-0.

- (2011, prill) *Reforma shkollore nga brenda jashtë. Politikat, praktikat dhe performanca*. Autor: Richard F. Elmore. Botimi origjinal nga Harvard Press. Tiranë: U.F.O Press, ISBN 978-99956-19-71-8
- (2011, shkurt) *Zhvillimi si liri* (së bashku me Tritan Verteniku). Autor: Amartya K. Sen. Tiranë: U.F.O Press, ISBN 978-99956-19-74-9
- (2008) *Portokalli fluturues rrëfen historitë e tij*. Autorë: Johan Galtung & Andreas Galtung. Tiranë: U.F.O Press, ISBN 978-99956-19-09-1
- (2008, janar) *Vizatimi me laps*. Autor: Thomas Wang. Tiranë: U.F.O Press.
- (2008, janar) *Etika në media, çështje dhe raste* (së bashku me Viola Gjylbegu & Bledi Lami). Autorë: Philip Patterson, Lee Wilkins. Botimi original nga McGraw Hills. Tiranë: U.F.O Press, ISBN 978-99956-19-31-2
- (2005) *Epidemiologjia* (së bashku me Lauren Muhametaj). Autor: Leon Gordis. Botimi original nga Elsevier. Tiranë: U.F.O Press, ISBN 978-99956-19-30-5
- (2005) *Transendencë & Transformim*. Autor: Johan Galtung. Tiranë: U.F.O Press, ISBN 978-99943-951-9-4

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Çfarë është demokracia? : antologji / përpiluar
nga Valbona Nathanaili. - Tiranë : Kolegji Universitar Logos,
2024. 116 f. ; 16.5 x 24 cm.

Bibliogr..

ISBN 9789928482921

1.Pushteti (Shkenca shoqërore) 2.Demokracia 3.

Të drejtat e njeriut

321 .01 (082)

“Qendrat për të drejtat e fëmijëve” në universitete, mbështetur nga të gjithë fakultetet përkatëse, përbëjnë një mundësi të vlefshme për të forcuar hapjen e tyre ndaj shoqërisë, si dhe për të qenë më energjikë jo vetëm në analizën e fenomeneve që e shqetësojnë këtë shoqëri, por edhe në përhapjen e njohurive përtej mureve të kampusit. Universitetet janë në pozitë unike për të shpërndarë njohuri për të drejtat e fëmijëve përtej dhomave tradicionale të mësimit të studentëve, si dhe të ndihmojnë në krijimin e një kulture më të fortë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në shoqëri.

Ghassan Khalili
UNICEF, Greqi

Njerëzit ende janë të prirur jo drejt një baraspeshe konkurruese por orientohen emocionalisht dhe shpesh edhe nga faktorë të ngushtë, interesi të vogël, duke mos kuptuar se një shoqëri vitalizohet nga konkurrenca e lirë e ideve dhe prirjeve për një zhvillim në favor të shoqërisë dhe jo në një lloj pragmatizmi të ngushtë interesi qoftë dhe vetjak që e çon shoqërinë dita më ditë në një kënetë e krizë vlerash.

Vladimir Myrtezai
Universiteti i Arteve

Problemet e mëdha me të cilat përballen sot shqiptarët, që nga varfëria në shpirt e deri tek ajo në tryezë, nga ikja prej vetes deri tek ikja nga Shqipëria, nuk mund të zgjidhin vetveten pa e bërë publikun të vetëdijshëm se është një çështje apo disa që duhen zgjidhur, dhe që na përkasin të gjithëve, na ndihmon të hapim sytë e mendjen përtej “un-it”, dhe pa diskutim përtej ngjyrave e flamujve partiakë.

Nevila Sokoli Xhindi
Qendra për Studime Krahësuese dhe Ndërkombëtare

Edhe nëse nuk dëshiron të jesh feministe, shoqëria shqiptare të detyron të bëhesh feministe – ke gjithmonë një arsye apo një shkak me të cilin nuk pajtohesh, një ngjarje me sfond diskriminimi bazuar në gjini për të cilën duhet të ngresh zërin, të reagosh, ta denoncosh! Por fatkeqësia më e madhe është kur këto beteja janë kundër vetë grave, që shpesh e inicojnë, mbështesin dhe ushqejnë këtë lloj diskriminimi!

Valbona Nathanaili
Kolegji Universitar “LOGOS”



Kolegji Universitar LOGOS
e-mail: info@kulogos.edu.al

